otpbank

RAPORTI VJETOR 2024



info@otpbank.al
www.otpbank.al

PËRMBAJTJA

Fjala e CEO 01-02

Qeverisja e Korporatës 03-13

Funksioni i Përputhshmërisë dhe PPT/PFT 14-16

Rezultatet Financiare 17-18

Bankingu i Segmenteve 19-23
Bankingu i Korporatave

Bankingu Retail 24-30

Tregjet Globale 31-33

Menaxhimi i Riskut Në OTP Bank Albania Sh.a 34-38

Projekte të Rëndësishme 39-41

Divizioni Digjital 42-44

Siguria Bankare 45-47

Departamenti i Burimeve Njerëzore 48-55

Përgjegjësia Sociale e Korporatës 56-72

Përvoja e Klientit 73-75

Informacion i Detajuar 76-184

FJALA E CEO



Bledar Shella

Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit të Menaxhimit

I dashur Lexues,

Viti 2024 ka qenë një tjetër vit historik për Bankën OTP Albania – një vit i karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer financiare, aktivitet tregtar dhe rritje e qëndrueshme, të cilat përbëjnë më të mirat në historinë tonë, që prej hyrjes në tregun bankar shqiptar. Përmes angazhimit tonë të pandërprerë për ekselencë dhe orientim të qartë ndaj klientit, gjatë vitit që lamë pas kemi arritur rezultatet më të mira në historinë e bankës, ndërkohë që kemi ofruar vlerë të qëndrueshme për klientët, ekonominë e vendit dhe partnerët tanë.

Banka OTP Albania e mbylli vitin 2024 me një fitim neto prej gati 5 miliardë lekësh, një rritje prej rreth 10.5% krahasuar me një vit më parë, dhe me një kthim mbi kapitalin (ROE) mbi 20%. Ky rezultat pasqyron jo vetëm disiplinën tonë financiare, por edhe besimin e thellë që klientët tanë kanë tek ne.

Portofoli i kredive u rrit me 16.4%, ndërsa depozitat kapërcyen shifrën e 151 miliardë lekëve, duke konfirmuar rolin tonë si partner financiar i besueshëm në misionin për zhvillimin e Shqipërisë. Njëkohësisht, zgjerimi i portofolit të kredive për sipërmarrjen shqiptare na ka lejuar të jemi gjithnjë e më shumë një partner real i këtij zhvillimi ekonomik dhe punësimit në vend.

Gjatë këtij viti, u vlerësuam për të tretin vit radhazi si **Banka më e Mirë në Shqipëri** nga The Banker. Ky çmim nuk është thjesht një arritje – por një dëshmi e strategjisë sonë afatgjatë, përkushtimit të njerëzve tanë dhe kulturës sonë.

Gjatë vitit 2024, ne kemi thelluar më tej transformimin tonë digjital, duke investuar në përmirësimin e përvojës së klientëve tanë kudo – nga degët e modernizuara e deri te platformat tona digjitale. Shërbimet online janë bërë më të aksesueshme, më të shpejta dhe më të sigurta. Kemi ndërtuar një arkitekturë të re teknologjike që na mundëson të ofrojmë produkte më fleksibël, shërbime më të personalizuara dhe ndërveprim më të thjeshtë me klientin.

Por më shumë se çdo numër apo statistikë, suksesi ynë ndërtohet mbi njerëzit tanë – një ekip i motivuar, me dije të thelluara, etikë të lartë dhe shpirt bashkëpunimi. Gjatë gjithë vitit, kolegët tanë kanë treguar përkushtim të jashtëzakonshëm në çdo sfidë, duke e kthyer çdo mundësi në një histori suksesi për klientët dhe për bankën.

Po ashtu, mbajtëm të fortë angazhimin tonë si një korporatë e përgjegjshme në kuadrin social. Misioni ynë për të ndikuar pozitivisht në komunitetin ku veprojmë u konkretizua përmes mbështetjes së projekteve në edukim, shëndetësi, përfshirje sociale, ruajtje të trashëgimisë kulturore dhe mbrojtje të mjedisit. Në këtë drejtim, jemi të vetëdijshëm se roli ynë nuk është thjesht financiar – ai është gjithashtu social dhe njerëzor.

Duke ecur përpara, me krenari themi se viti 2024 ka rishkruar standardet dhe ka çuar pritshmëritë tona në një nivel të ri, duke vendosur një pikë referimi të re për përsosmërinë. Si një nga aktorët kryesorë në tregun bankar shqiptar, OTP Bank Albania ka dëshmuar se suksesi nuk matet vetëm me rritje, por edhe me eficiencë – një vlerë që na ka bërë të dallohemi si banka më eficiente në vend, duke kombinuar performancën e lartë me përkujdesjen ndaj klientit dhe vendimmarrjen e zgjuar.

Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi.

Me respekt,

Bledar SHELLA
Drejtor i Përgjithshëm
Banka OTP Albania




QEVERISJA E KORPORATËS

Qeverisja e Korporatës së Bankës OTP Albania sh.a reflekton angazhimin tonë për një biznes afatgjatë, të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm.

Struktura organizative dhe baza rregullatore në Bankën OTP reflektojnë një komunikim transparent dhe shkëmbim informacioni të vazhdueshëm, mes menaxhimit dhe organeve qeverisëse.

Ne besojmë se Qeverisja e Korporatës, veçanërisht roli, dinamikat dhe mekanizmat e bashkëpunimit të organeve Drejtuese dhe komiteteve raportuese, krijojnë vlerë jo vetëm për aksionarët, por për të gjitha palët e interesuara.



AKSIONARI I BANKËS OTP ALBANIA

Struktura aksionare e Bankës OTP Albania sh.a, nuk pësoi ndryshime përgjatë vitit 2024. Kapitali aksionar zotërohet 100% nga Grupi Hungarez OTP Bank.

Kapitali përbëhet nga aksione të zakonshme si vijon:

Kapitali	6.740.900.000
Kapitali i shlyer	6.740.900.000
Numri i aksioneve	67.409
Vlera nominale	100.000

Statuti i njeh aksionerit të drejta vote dhe dividendi, në proporcion me pjesëmarrjen në kapital. Transferimi i aksioneve nuk është i kushtëzuar nga të drejta parablerje. Transferimi i pjesëmarrjeve influencuese në kuptim të Ligjit Për Bankat, është i kushtëzuar nga miratimet e autoriteteve rregullatore.

MBI GRUPIN OTP

Grupi OTP është një nga grupet bankare me rritjen më të shpejtë dhe një nga grupet bankare lider në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore, me rentabilitet të jashtëzakonshëm dhe një pozicion të qëndrueshëm kapitali dhe likuiditeti. Me afro 40,000 punonjës në 11 vende të rajonit të EQL dhe Azisë Qëndrore, Grupi ofron shërbime financiare universale për 17 milionë klientë. Si konsoliduesi më aktiv në sektorin bankar të rajonit të Evropës Qëndrore dhe Lindore, Grupi ka blerë dhe integruar me sukses 25 banka, që nga fillimi i viteve 2000. Grupi OTP ka selinë në Hungari dhe ka një strukturë pronësie të larmishme dhe transparente. Grupi Bankar është i listuar në bursën e Budapestit që nga viti 1995.

MBLEDHJET E AKSIONERIT TË VETËM

Përgjatë vitit 2024, Asambleja e Aksionarit të Vetëm në Bankën OTP Albania është mbledhur dy herë: krahas mbledhjes së zakonshme vjetore për miratimin e pasqyrave të vitit financiar 2023, Asambleja e Aksionarit u mblodh edhe një herë tjetër për miratimin e zgjatjes së mandatit të Z. Ilir Ciko, anëtar i Këshillit Drejtues.

KËSHILLI DREJTUES

Misioni dhe Vlerat

Misioni i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania ka në fokus drejtimin strategjik, mbikëqyrjen e përgjegjshme dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator, për të siguruar stabilitetin financiar të bankës, mbrojtjen e klientëve dhe krijim e vlerës së qëndrueshme për aksionarët dhe palët e interesuara.



ANËTARËSIA

Këshilli Drejtues i Bankës OTP Albania është i përbërë nga shtatë anëtarë, katër prej të cilëve janë të pavarur. Kryetar i Këshillit Drejtues vijon të jetë Z. Gábor Kolics me një eksperiencë të gjatë bankare dhe pjesë e organeve drejtuese dhe vendimmarrëse të kompanisë mëmë. Krahas mbledhjeve të Këshillit Drejtues, Z.Kolics ka realizuar mbledhje me drejtuesit e lartë të Bankës, me qëllim përforcimin e ekspertizës në fusha të caktuara dhe sigurimin e një drejtimi dhe vendimmarrje të përshtatshme dhe të përgjegjshme. Zëvendës Kryetare e Këshillit Drejtues është Znj. Orsolya Kovacs. Anëtarësia e Këshillit Drejtues është përzgjedhur me kujdes të veçantë, duke respektuar kriteret e pavarësisë dhe ekspertizës profesionale.

Anëtarësia e Këshillit Drejtues 2024:

Mr. Gábor Kolics
Kryetar

Mr. Ilir Ciko
Anëtar

Ms. Orsolya Csilla Kovács
Zv.Kryetar

Mr. Stavri Pashko
Anëtar

Mr. Janos Veres
Anëtar

Mr. Örs Levente Szilágyi
Anëtar

Mr. Armand Duka
Anëtar

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues ka pasur një aktivitet intensiv vendimarrje, ka realizuar 3 (tre) mbledhje fizike dhe 23 (njëzet e tre) me qarkullim dokumentacioni.



KOMITETI I KONTROLLIT

Misioni dhe Vlerat

Misioni i Komitetit të Kontrollit është krijuar për të ndihmuar Këshillin Drejtues në përmbushjen e funksioneve të tij mbikëqyrëse në lidhje me: Integritetin e raportimit financiar, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, performancën e funksionit të auditit të brendshëm, efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Anëtarësia

Komiteti i Kontrollit në Bankën OTP Albania është i përbërë nga 3 anëtarë, 2 prej të cilëve janë të pavarur. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht edhe anëtar në Këshillin Drejtues. Përgjatë vitit 2024, nuk ka pasur ndryshime në përbërjen e Komitetit të Kontrollit në Bankë.

Anëtarësia e Komitetit të Kontrollit 2024:

Mr. Stavri Pashko
Kryetar

Mrs. Jitka Pantuckova
Anëtare

Mr. Zoltan Molnar
Anëtar

Mbledhjet e Komitetit të Kontrollit

Gjatë vitit 2024, Komiteti i Kontrollit është mbledhur 3 herë me prezencë fizike dhe 3 herë me qarkullim dokumentacioni. Gjatë këtyre mbledhjeve janë shqyrtuar dhe diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, aktivitetin e auditimit të brendshëm, pasqyrat financiare, si dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Mbledhjet janë zhvilluar në mënyrë efektive, me pjesëmarrje të plotë të anëtarëve dhe me dokumentim të rregullt të vendimmarrjeve. Komiteti ka siguruar që funksionet e tij mbikëqyrëse të ushtrohen në përputhje me kërkesat rregullatore dhe politikat e brendshme të Bankës. Aspektet financiare dhe ato të kontrollit ishin në linjë me aktet nënligjore dhe pritshmëritë e grupit mëmë.

KOMITETI I RISKUT

Misioni dhe Vlerat

Komiteti i Riskut është krijuar si pjesë e strukturës së qeverisjes së bankës, në përgjigje të zgjerimit të aktivitetit të institucionit dhe në përputhje me zhvillimet në kuadrin rregullator në vend. Ky komitet vepron si organ këshillues dhe raportues, pranë Këshillit Drejtues. Misioni i tij është të mbikëqyrë dhe vlerësojë kuadrin e menaxhimit të rreziqeve në të gjithë nivelet e bankës, duke siguruar që identifikimi, vlerësimi, monitorimi dhe zbutja e rreziqeve të ndjekin praktikat më të mira dhe të jenë në përputhje me kërkesat ligjore e rregullatore.

Anëtarësia

Komiteti i Riskut në Bankën OTP Albania është i përbërë nga 3 anëtarë. Kryetari i Komitetit të Riskut është anëtar i Këshillit Drejtues dhe raporton në Këshill mbi rezultatet, ecurinë dhe gjetjet e Komitetit.

Anëtarësia e Komitetit të Kontrollit 2024:

Z. Örs Levente Szilágyi Kryetar	**Mrs. Ágnes Szamosfalvy** Anëtare	**Mr. Ilir Ciko** Anëtar

Mbledhjet e Komitetit të Riskut

Duke qenë se Komiteti i Riskut është një strukturë e re e krijuar në Bankë, me përbërje dhe procedura të punës të formalizuara në qershor të vitit 2024, gjatë këtij viti janë zhvilluar dy mbledhje me pjesëmarrje fizike të anëtarëve. Në përputhje me mandatin e tij, Komiteti ka fokusuar veprimtarinë në: Rishikimin periodik të strategjisë së riskut dhe politikave përkatëse; Monitorimin e ekspozimit të bankës ndaj rreziqeve kryesore, përfshirë rrezikun kreditor, operacional, të likuiditetit, tregut dhe të përputhshmërisë; Vlerësimin e efektivitetit të sistemeve dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut; Sigurimin që raportimet ndaj Këshillit Drejtues të jenë të qarta, të sakta dhe të dorëzohen në kohë.
Komiteti synon të garantojë një mbikëqyrje të strukturuar dhe të pavarur mbi kuadrin e menaxhimit të rrezikut në Bankë, në përputhje me rritjen e shkallës së kompleksitetit të aktivitetit dhe zhvillimet në kuadrin rregullator.

Komitetet e Brendshme

Krahas Komiteteve raportuese në Këshill Drejtues, Banka OTP Albania ka një strukturë të gjerë komitetesh të brendshme, të cilat përbëjnë një mekanizëm thelbësor në mbështetje të vendimmarrjes, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm. Me një numër që shkon deri në njëzet komitete, ky rrjet institucional garanton një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar ndaj menaxhimit të të gjithë aspekteve të aktivitetit bankar. Komitetet funksionojnë me parime profesionalizmi, transparence dhe bashkëpunimi ndërfunksional, duke ndihmuar menaxhimin e lartë në marrjen e vendimeve të informuara, në ruajtjen e integritetit të proceseve dhe në forcimin e qeverisjes së brendshme. Kjo strukturë përfaqëson një vlerë të shtuar për bankën, duke reflektuar angazhimin e saj për efikasitet, kontroll të qëndrueshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm institucional.

BIOGRAFITË E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Z. Gábor Kolics

Z. Gábor Kolics, shtetas Hungarez, është i diplomuar nga Universiteti i Shkencave Ekonomike për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ekonomiks. Z. Kolics punon në industrinë bankare që prej vitit 2004, vit në të cilin është bashkuar me Grupin OTP si Analist i Riskut.

Prej vitit 2019, Z. Gábor Kolics është drejtor menaxhues i Drejtorisë së Blerjeve dhe Integrimit të Grupit, përgjegjës për ekzekutimin e projekteve të Merger & Acquisition dhe integrimit të OTP Group, si dhe funksionin e kontrollit, raportimit dhe planifikimit në Divizionin e Bankave Tregtare.

Në dhjetor 2022, Z. Kolics është Kryetar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Znj. Orsolya Csilla Kovács

Znj. Orsolya Csilla Kovács, shtetase Hungareze, është diplomuar në Universitetin Corvinus të Budapestit në profilin Menaxhim dhe Organizim. Znj. Kovács punon në industrinë bankare që nga viti 2006, vit në të cilin është bashkuar me OTP Group si analiste financiare.
Që nga viti 2022, znj. Orsolya Kovács është Drejtore e Departamentit të Analizës Strategjike, përgjegjëse për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike në OTP Group. Prej vitit 2022, znj. Kovács është anëtare e Bordit Mbikëqyrës të OTP Home, një filial i OTP Group për ofrimin e ekosistemit të pasurive të paluajtshme në internet të OTP Group.

Znj. Kovács është anëtare e Këshillit Drejtues të Bankës OTP Albania që nga viti 2023.

Z. Armand Duka

Z. Armand Duka, shtetas Shqiptar, është diplomuar në Universitetin e Tiranës (Shqipëri), Dega e Ekonomisë për Industri, në vitin 1986. Z. Duka ka filluar karrierën në profesionin e Ekonomistit në Parkun e Mallrave në Burrel në vitet 1986-1990. Gjatë viteve 1990-1991, z. Duka ka ushtruar profesionin e tij si ekonomist në parkun e mallrave të eksportit, në Durrës.
Duke filluar nga viti 1993, Z. Armand Duka është sipërmarrës në sektorë të tjerë privatë, zotërues dhe aksionar në disa biznese të mirënjohura, ku rikonfirmon kështu aftësitë e tij shumë të mira menaxhuese dhe drejtuese. Z. Armand Duka është zgjedhur President i Federatës Shqiptare të Futbollit në vitin 2002, post të cilin e mban edhe aktualisht.

Duke filluar nga tetori, 2019, z. Armand Duka është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Dr. János Veres

Dr. János Veres, një shtetas Hungarez, është diplomuar në Inxhinieri në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Debrecenit (Hungari) dhe ka kryer studimet e doktoraturës për Ekonomi në Universitetin Karl Marx, Budapest (Hungari).
Dr. Veres ka një përvojë 32 vjeçare në sektorët publikë dhe privatë. Nga viti 1997 deri ne vitin 2002, Dr. Veres ka qenë Kryetar i Dhomës së Tregtisë për rajonin Szabolcs-Szatmár-Bereg. Përgjatë viteve Dr. Veres ka zhvilluar një karrierë në politikë ku ia vlen të përmenden pozicionet si: Sekretar i Shtetit në Ministrinë e Financave (2003-2004), Sekretari i Shtetit në Zyrën e Kryeministrit (2004-2005) dhe Ministrër i Financave (2005-2009).

Duke filluar nga Mars, 2019 Dr. Veres është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Z. Stavri Pashko

Z. Stavri Pashko, shtetas shqiptar, është i diplomuar në Universitetin e Torinos për Shkenca Strategjike dhe ka një diplomë MBA në Udhëheqje për Qëndrueshmëri. Me mbi 17 vjet përvojë në industri, Z. Pashko e ka nisur eksperiencën e tij tek ProCredit Bank Albania dhe ish-Societe Generale Albania, duke vijuar më pas në kompani ndërkombëtare si Telia Company, Volvo Group dhe Volvo Cars.
Aktualisht, Z. Pashko është një Zhvillues i Biznesit të Qëndrueshmërisë në Volvo Cars, i fokusuar në sigurimin e pajtueshmërisë me qëndrueshmërinë dhe integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë në operacionet e biznesit global.

Nga Prill 2023, Z. Pashko mban pozicionin e Kryetarit të Komitetit të Kontrollit dhe anëtar i Këshillit Drejtues në Bankën OTP Albania.

Z. Ilir Ciko

Z. Ilir Ciko, shtetas shqiptar, i diplomuar nga Universiteti i Harvardit me një Master në Administrim Publik dhe nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Nebraskës, me një Master në Menaxhim Biznesi.
Z. Ciko ka përvojë të konsiderueshme dhe angazhim afatgjatë në menaxhimin e institucioneve dhe ekipeve private e publike, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të mëdha dhe buxheteve. Përvoja e tij 27 vjeçare përfshin kërkime dhe konsulenca të ndryshme zhvillimi për organizata ndërkombëtare, kontribut si ekspert në administratën publike, duke përfshirë pozicionin e zëvendësministrit të ekonomisë (2003-2005) dhe aktivitet të vazhdueshëm akademik që nga viti 2004 si pedagog në Universitetin e New York në Tiranë dhe aktualisht në Institutin Kanadez të Teknologjisë.

Në vitin 2023, Z. Ciko është zgjedhur anatër i Këshillit Drejtues në Bankën OTP Albania dhe prej vitit 2024 ai është edhe anëtar në Komitetin e Riskut në bankë.

Z. Örs Levente Szilágyi

Z. Örs Levente Szilágyi, shtetas hungarez, është diplomuar në Universitetin Corvinus të Budapestit me fokus drejtimin e analizës së investimeve dhe menaxhimit të rrezikut (2007). Ai zotëron gjithashtu një diplomë të përbashkët MBA në Administrim Biznesi nga Mastriht School of Management dhe SEED Hungary (2020).
Z. Szilágyi ka punuar në industrinë bankare që nga viti 2007 në fushën e menaxhimit të rrezikut. Karriera e tij ka filluar si zhvillues i modeleve të riskut dhe që prej vitit 2010 ka drejtuar departamente të ndryshme të rrezikut në sektorin bankar hungarez. Z. Szilágyi u bashkua me OTP Group në vitin 2016 si Drejtor i Departamentit të Përgjithshëm të Analizës dhe Modelimit, rol të cilin e mban dhe sot.

Z. Szilágyi është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania që nga viti 2023 dhe kryetar i Komitetit të Riskut nga muaji Qershor 2024.

Znj. Jitka Pantucková

Anëtare e Komitetit të Kontrollit
Mandati aktual - 06.03.2023 – 06.03.2027

Znj. Jitka Pantucková, shtetase çeke, është diplomuar për Ekonomi Ndërkombëtare nga Shkolla e Ekonomisë në Pragë (Republika Çeke) dhe ka një PhD nga Instituti i Ekonomisë të Akademisë Çekosllovake të Shkencave (Republika Çeke).
Znj Pantucková e filloi karrierën e saj në vitin 1973, si redaktore në Agjencinë e Shtypit Çekosllovak. Në mars të vitit 1991 u propozua Drejtore e Departamentit të Territorit të Investiční a Poštovní Banka, a.s (IPB).
Në tetor 1992 u emërua Drejtore e Departamentit të Bankave Korrespondente dhe të Biznesit Ndërkombëtar. Në qershor të vitit 1998 u caktua Drejtore e ekipit të veçantë të IPB-së për Euro dhe BE-në.
Në qershor të vitit 2000 IPB, A.Ş. kaloi nën sipërmarrjen e ČSOB, a.s. dhe Znj Pantucková u emërua Drejtore e Ekipit të veçantë të projektit të CSOB-së për Euro dhe BE-në. Ajo ishte Drejtore Ekzekutive dhe Anëtare e Komitetit Drejtues përgjegjëse për Operacionet pranë Komercni Banka, a.s. nga viti 2002 deri në vitin 2009.
Në prill 2004 ajo u përzgjodh si "Menaxheri i Vitit 2003" në Republikën Çeke. Nga muaji janar 2010 deri në muajin janar të vitit 2015, ajo ka qenë anëtare e Ohridska Banka, Societe Generale AD në Ohër dhe
Presidente e Këshillit Drejtues.
Ndërsa nga qershori 2010 deri në janar 2015, ajo ka kryesuar Komitetin e Kontrollit të Bankës Societe Generale Montenegro. Nga muaji korrik 2015 deri në mars 2019, ajo ka qenë kryetare e Këshillit Drejtues të Bankës Societe Generale Albania dhe nga muaji shtator 2015 deri në mars 2019 ajo ka kryesuar gjithashtu edhe Komitetin e Kontrollit.

Znj. Pantucková kontribuon si anëtare në Komitetin e Kontrollit të Bankës OTP Albania.
team for the Euro and the EU.

Z. Zoltan Molnar

Anëtar i Komitetit të Kontrollit
Mandati aktual - 09.06.2023 – 09.06.2027

Z. Zoltan Molnar është diplomuar në profilin Financë-Bankë nga Universiteti Corvinus i Budapestit (Hungari) dhe ka një diplomë MBA nga Shkolla e Menaxhimit të Mastrihtit (Holandë).
Z. Molnar e ka filluar karrierën e tij në 2007 në Ernst & Young Hungary, në ekipin Këshillues të Transaksioneve. Ai ka qënë i përfshirë në disa projekte të kujdesit financiar, financave të korporatave dhe M&A në rajonin e EQL. Z. Molnar ka marrë kualifikimin ACCA dhe ka kryer angazhime audituese. Ai gjithashtu ka kryer disa misione në Gjermani dhe më vonë është transferuar në Kuvajt, Lindjen e Mesme.
Prej vitit 2015, Z. Molnar ka punuar në OTP Bank Hungari në Departamentin e Bashkimeve dhe Blerjeve duke ekzekutuar projekte në të gjithë rajonin e EQL.

Z. Molnar ka marrë rolin e Anëtarit të Bordit të Drejtorëve në Vojvodanska banka AD midis shtatorit 2019 dhe prillit 2021. Që nga qershori 2021, ai është Kryetar i Bordit të Drejtorëve në OTP Osiguranje AD një kompani sigurimesh dhe prej qershorit, 2023 anëtar në Komitetin e Kontrollit të Bankës OTP Albania.

MENAXHIMI I RREZIKUT

Gjatë aktivitetit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme ligjore, të tilla si rreziku i mos përputhshmërisë me kuadrin rregullator ose detyrimet kontraktore, rreziku ndaj padive të mundshme, si dhe rreziqe që rrjedhin nga aktiviteti kryesor. Struktura ligjore e Bankës i ka menaxhuar këto rreziqe në një mënyrë të kujdesshme nëpërmjet procedurës së monitorimit të kuadrit rregullator, miratimit të marrëveshjeve para procesit të nënshkrimit të tyre, si dhe mbrojtjes aktive të interesave të bankës në seancat gjyqësore. Sa i përket aktivitetit kryesor, Divizioni i Riskut dhe struktura ligjore bashkëpunojnë për të zbutur risqet ligjore të kreditimit që burojnë nga proceset e brendshëm apo varësitë nga palët e treta. Gjatë vitit 2024 nuk ka patur ngjarje madhore që kanë ndikuar ose rrezikojnë të ndikojnë në treguesit financiare të bankës.



FUNKSIONI I PËRPUTHSHMËRISË & PPT/PFT

Edhe gjatë vitit 2024, Departamenti Përputhshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave qëndroi në pararojë të angazhimit tonë për të mbajtur standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe përputhshmërisë rregullatore. Ndërsa sektori financiar u zhvillua në përgjigje të presionit ekonomik global, inovacionit teknologjik dhe rreziqeve gjithnjë e më komplekse, banka jonë mbajti një qasje proaktive të bazuar në rrezik për përputhshmërinë dhe parandalimin e krimeve financiare. Ne jemi krenarë të raportojmë përparime të rëndësishme në disa fusha kyçe, që forcojnë reputacionin e OTP Bank Albania si një institucion financiar i besueshëm dhe i përgjegjshëm.

Navigimi i Ndryshimeve: Bashkimi, Integrimi dhe Inovacioni

Viti 2024 shënoi gjithashtu një vit të transformimit strategjik, duke përfshirë integrimin e sistemeve dhe proceseve pas përfundimit të procesit teknik dhe përfundimtar të bashkimit me ish Alpha Bank Albania sh.a. Ky tranzicion paraqiti një sfidë të konsiderueshme për përputhshmërinë dhe PPP, veçanërisht në harmonizimin e politikave dhe migrimin e të dhënave. Një nga arritjet kryesore të vitit 2024 ishte përditësimi i suksesshëm i sistemit tonë të monitorimit të transaksioneve, në kuadër të luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Platforma e re ofron performancë të përmirësuar, funksionalitete më të mira dhe një mjedis më miqësor për përdoruesit. Konfigurimi dhe parametrizimi i përmirësuar i skenarëve lejon mundësi më të mëdha për zbulimin e indikatorëve të dyshimtë dhe një eficiencë më të lartë, në reduktimin e treguesve fals pozitivë.

Për më tepër, përfunduam fazën e parë të projektit të Bankës për digjitalizimin e dosjeve të klientëve për një pjesë të portofolit tonë dhe po punojmë intensivisht për të nisur fazën që do të sigurojë digjitalizimin e plotë të dosjeve KYC, të klientëve aktivë.

Automatizimi i plotë i proceseve, së bashku me përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit mbetet një prioritet kyç për periudhën e ardhshme. Këto përpjekje synojnë të sigurojnë zbutjen efektive të rreziqeve dhe të mundësojnë një përgjigje të shpejtë ndaj rreziqeve të reja të përputhshmërisë dhe krimeve financiare.

Forcimi i Integritetit dhe Përputhshmërisë, me Sanksionet në OTP Bank Albania

Për të forcuar më tej qeverisjen rreth çështjeve të etikës, në vitin 2024 u krijua zyrtarisht Komiteti i Etikës. Ky organ i brendshëm është përgjegjës për promovimin e kulturës etike, mbikëqyrjen e përputhshmërisë me rregullat etike dhe operacionet etike brenda Bankës, në përputhje me parimet dhe format e sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës së Bankës. Kjo strukturë vlerëson dhe merr vendime për çështje të përgjithshme ose raste specifike që lidhen me përmirësimin e sjelljes etike në Bankë.

Duke njohur rëndësinë e një procesi të sigurt dhe të besueshëm sinjalizimi, në vitin 2024 u lançua Platforma e Sinjalizimit në nivel Grupi, e aksesueshme përmes faqes zyrtare të OTP Bank Albania. Kjo platformë ofron një kanal anonim për raportimin e shkeljeve etike.

Gjithashtu, funksioni i Përputhshmërisë forcoi përputhshmërinë e proceseve për t'u përshtatur me një mjedis gjithnjë e më kompleks të sanksioneve ndërkombëtare. Banka siguroi përputhshmëri të plotë me regjimet e sanksioneve të OKB-së, BE-së, SHBA-së dhe MB-së përmes përmirësimit të kontrolleve të brendshme dhe proceseve të vigjilencës së duhur. Masat kryesore përfshinin përditësimin e kuadrit rregullator, përfundimin e një vlerësimi të plotë të rrezikut të sanksioneve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve për respektimin e kërkesave përkatëse.

Ngritja e Standardeve të Përputhshmërisë dhe PPP-ve

Në përgjigje të pritshmërive dhe kërkesave rregullatore gjithnjë në rritje, ndërmorëm hapa strategjikë për të forcuar funksionet e përputhshmërisë dhe PPP-ve. U krijua një strukturë e posaçme kontrolli brenda funksionit të PPP-ve, e mbështetur me staf shtesë për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe aftësitë analizuese. Paralelisht, u vendos të rritet numri i përgjithshëm i stafit në të dy strukturat për të siguruar mbulim të mjaftueshëm dhe specializim në fusha kyçe. Ky zgjerim u përfundua në fillim të vitit 2025 dhe pritet të forcojë ndjeshëm aftësinë tonë për të mbështetur biznesin dhe për të menaxhuar rrezikun rregullator.

Për të mbështetur këto përmirësime, gjatë vitit u zhvilluan trajnime të synuara dhe iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve, për stafin e përputhshmërisë dhe PPP-ve. Këto përfshinin sesione trajnimi mbi identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut, aftësitë analizuese, peizazhin e sanksioneve dhe ndryshimet rregullatore.

Gjithashtu, institucioni në tërësi përfitoi nga disa iniciativa ndërgjegjësuese të cilat përfshinin trajnime mbi sjelljen etike, ABC (përfshirë trajtimin e dhuratave dhe ngjarjeve), kanalet e denoncimit dhe të drejtat e mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe një program trajnimi për të gjithë punonjësit e rinj.

Ndërkohë që informacioni i mbledhur nga Banka gjatë procesit 'Njih klientin tënd' ka qenë gjithmonë subjekt i monitorimit dhe përditësimit të vazhdueshëm, - gjatë vitit 2024 kemi punuar intensivisht për të dizenjuar një proces të strukturuar, të bazuar në rrezik për rishikimin periodik, që përmirëson më tej cilësinë dhe periodicitetin e ushtrimit të vigjilencës së nevojshme, për klientët e Bankës.

Partneritet më i fortë me Rregullatorët

Angazhimi ynë proaktiv me rregullatorët, ishte një gur themeli i strategjisë sonë të përputhshmërisë. Morëm pjesë në disa tryeza kombëtare ku u diskutan çështje që lidhen me përputhshmërinë dhe luftën ndaj pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe prodhimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe kontribuam në sesionet e konsultimit për nismat apo ndryshimet legjislative. Gjithashtu, finalizuam me sukses të gjithë kontrollet e planifikuara nga autoritetet pa gjetje të rëndësishme, duke dëshmuar maturinë e kontrolleve tona dhe raportimin në kohë ndaj autoriteteve përkatëse. Ndërkohë, të gjithë raportimet rregullatore u dërguan tek institucionet përkatëse brenda afateve të caktuara.



REZULTATET FINANCIARE

REZULTATET FINANCIARE 2024

REZULTATET FINANCIARE 2024

E ARDHURA BANKARE NETO

€ 103.94 mn

+6.10%

% Rritje Vs 2023

***E ARDHURA NETO**

€ 51.37 mn

+10.50%

% Rritje Vs 2023

KTHIMI NGA KAPITALI

20.60%

-3.10%

% Rritje Vs 2023

RAPORTI SHPENZIME / TË ARDHURA

42.15%

-2.60%

% Rritje Vs 2023

PERFORMANCA E KREDIVE DHE DEPOZITAVE

KREDITË OUTSTANDING

€ 1,206.16 mn

+16.40%

% Rritje Vs 2023

GJENDJA E DEPOZITAVE

€ 1,540.83 mn

+2.20%

% Rritje Vs 2023

PJESA E TREGUT TË KREDIVE

14.49%

+0.20%

% Rritje Vs 2023

*Rritja e rregulluar për shpenzimet e integrimit, të regjistruara në vitin 2023



BANKINGU I SEGMENTEVE

BANKINGU I KORPORATAVE

Në vitin 2024, OTP Bank Albania arriti një performancë të jashtëzakonshme financiare, ku Divizioni i Biznesit luajti një rol thelbësor në këtë sukses. Duke shënuar vitin më të suksesshëm deri më sot, Divizioni i Biznesit kontribuoi ndjeshëm në rritjen e të ardhurave dhe forcimin e bilancit të bankës. Kjo arritje jo vetëm që pasqyron rezultatet e shkëlqyera të bankës, por edhe rolin e saj në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjatë gjithë vitit, Divizioni i Biznesit tregoi një përkushtim të qëndrueshëm për të mbështetur klientët e saj korporatë me përgjegjësi dhe proaktivitet, duke siguruar standardet më të larta të cilësisë së shërbimit dhe duke ofruar zgjidhje financiare të përshtatura sipas nevojave të e tyre. Duke kombinuar njohuritë mbi tregun, përvojën shumëvjeçare dhe ekspertizën, banka menaxhoi me sukses dinamikat e ndërlikuara të tregut ndërsa zbatoi strategjinë e saj të orientuar drejt rritjes, duke përfituar nga mundësitë e tregut dhe duke vendosur themelet për një rritje të qëndrueshme në të ardhmen.

Pikat Kryesore të 2024:

Në vitin 2024, banka realizoi me sukses objektivat e saj strategjike, duke forcuar qëndrueshmërinë:

- **Rritja e Portofolit të Kredive:** Segmenti i Korporatave shënoi një rritje të konsiderueshme prej 16.7% krahasuar me fundin e vitit 2023, duke përforcuar pozicionin e OTP Bank Albania si një nga bankat më të rëndësishme në vend. Ky trend rritjeje pritet të vazhdojë ndërsa banka vazhdon të financojë aktivisht bizneset vendase, duke përforcuar jo vetëm bilancin e saj financiar, por edhe duke promovuar rritjen ekonomike dhe mirëqenien e komunitetit më të gjerë.

- Vit rekord për për **financimin e marrëveshjeve të specializuara**: Duke demostruar aftësinë e bankës për të ndërtuar zgjidhje financiare të përshtatura për nevoja komplekse të bizneseve, duke forcuar rolin e saj si partner i besuar.

- **Mbështetje financiare për bizneset vendase:** Banka ofroi mbështetje të konsiderueshme për bizneset vendase duke i mundësuar atyre të investojnë, të zgjerojnë aktivitetin dhe të kenë sukses në një mjedis ekonomik dinamik. Kjo qasje strategjike në kredidhënie për bizneset, ka ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e industrisë vendase duke nxitur krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- **Menaxhim i disiplinuar i kostove:** Arriti një raport solid të kostove kundrejt të ardhurave, duke ndërtuar një strukturë të të ardhurave neto më pak të ndjeshme ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe kostove të riskut.

- **Investime në teknologji moderne:** Banka ka investuar në një infrastrukturë teknologjike të sigurt, të shkallëzueshme dhe të qëndrueshme duke ofruar shërbime digjitale inovative dhe duke ruajtur sigurinë e të dhënave dhe besueshmërinë operacionale. Pajisjet e reja POS janë të pajisura me teknologjinë më të avancuar, duke përmirësuar përvojën e përdoruesit dhe rritjen e efikasitetin operativ.

• OTP Bank Albania zbatoi praktikat më të mira dhe i kushtoi **përparësi zhvillimit të talenteve**. Përpjekjet e vazhdueshme për tërheqjen, zhvillimin dhe ruajtjen e talenteve kanë krijuar një kulturë të performancës së lartë në përputhje me vizionin strategjik të bankës.

• **Çmimi "Banka Më e Mirë" për të tretin vit radhazi:** OTP Bank Albania u vlerësua për vitin 2023 nga "The Banker", pjesë e grupit Financial Times, për rritjen e qëndrueshme, efikasitetin operacional dhe përshtatshmërinë në një treg në evolucion të shpejtë.

Pavarësisht mjedisit konkurues, banka ruajti marzhe të forta. Portofoli i kredive të korporata është i strukturuar me norma interesi të ndryshueshme, duke kontribuar në përmirësimin e marzheve të interesave. Nga anën e detyrimeve, 87% e fondeve janë të përqëndruara në llogari rrjedhëse, si rrjedhojë ul ndjeshëm koston e fondeve. Kjo bazë solide e depozitave është dëshmi e shërbimit me cilësi të lartë që u ofrohet klientëve dhe besimin të tyre tek OTP Bank Albania si banka e tyre për kryerjen e shërbimeve operacionale e të thesarit.

Divizioni i Biznesit vazhdon të mbështesë dhe shërbejë klientëve nëpërmjet një rrjeti të gjerë degësh, platformash digjitale dhe Departamentit të Bankës Globale të Transaksioneve. Gjithashtu ofron një gamë të plotë shërbimesh bankare për klientët korporatë, të përshtatura për nevojat e institucioneve qeveritare, korporatave të mëdha dhe institucioneve financiare.

Performanca dhe Pikat Kryesore të Aktivitetit të Kreditimit

Në vitin 2024, OTP Bank Albania përforcoi statusin e saj si një nga huadhënësit kryesor për korporatat në vend, duke shënuar një rritje të qëndrueshme si në aktivitetin e kreditimit brenda bilancit ashtu edhe jashtë tij. Divizioni i Biznesit e mbylli vitin me një përfitueshmëri të shkëlqyer të portofolit, duke vazhduar të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për aktivitetin e klientëve dhe duke kontribuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

• **Portofoli i Kredidhënies dhe Performanca:**

– 248.3 milionë euro kredi të reja korporatë u disbursuan gjatë vitit 2024, një rritje mbresëlënëse prej 82.3% krahasuar me vitin e kaluar. Disbursimet e reja, veçanërisht në segmentin e korporatave, mbështetën ndjeshëm përfitueshmërinë e bankës, shumica e ekspozimeve të kontraktua me marzhe të mira.

– Pjesa e tregut të huadhënies për korporatat arriti në 14.7% në fund të vitit 2024, duke e bërë OTP Bank Albania, bankën e dytë më të madhe për korporatat në vend. Përfshirja e linjave të kreditimit jashtë bilancit (off-balance) (kryesisht financimi i tregtisë) e rrit edhe më shumë këtë përqindje, duke theksuar lidershipin në ofrimin e zgjidhjeve financiare gjithëpërfshirëse.

– Tregu total i huadhënies për korporatat u zgjerua me 41.9 miliardë lekë, ndërsa OTP Bank Albania në huadhënien për korporatat kontribuoi me 8.4 miliardë lekë, duke përfaqësuar 20% të rritjes totale të tregut. Si rezultat, pjesa e tregut u rrit me 60 pikë bazë krahasuar me konkurrentët, veçanërisht ata ndërkombëtare. Kjo ecuri evidenton efektivitetin e strategjive të bankës në forcimin e pozicionit konkurrues dhe zgjerimin e pranisë së saj në tregun e kreditimit të korporatave.

• **Linjat e Kreditimit jashtë Bilancit:** OTP Bank Albania ka ruajtur pozicionin si lider, për më shumë se një dekadë, në financat tregtare (Garancitë Bankare e Letrat e Kreditit). Këto instrumente vazhdojnë të jenë prioritet strategjik, pasi përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve të ponderuara sipas riskut në segmentin e korporatave dhe pasqyron ekspertizën e bankës në këtë fushë.

• Divizioni i Korporatave ofron **një gamë të plotë të financimeve** afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të përputhshme me standardet kombëtare dhe praktikat më të mira, duke përfshirë kredi për investime, financimin e marrveshjeve të specializuara për investimet në asete fikse, kredi afatgjata dhe instrumente të lidhura LC/LG. Kapital qarkullues që mbulon gjithë ciklin e biznesit, si overdraft, linja për likuidimin e faturave, si dhe linjat e kreditit shumë qëllimore. Zgjidhjet financiare të personalizuara sipas profilit të riskut të klientit, llojit të kolateralit dhe volatilitetit të biznesit, në shërbim të bizneseve vendase, entitetet shtetërore dhe kompanive të huaja. Produkte sipas nevojat për industri të ndryshme, me çmime konkurruese dhe kushte fleksibile.

• Banka ka **qasje të personalizuar dhe këshilluese gjatë kredidhënies**, karakterizohet nga një proces transparent, fleksibël dhe konsultativ. Klientët përfitojnë këshillim sipas ciklit të jetës së biznesit të tyre, duke siguruar që zgjidhjet financiare të jenë në përputhje me nevojat e tyre.

• **Qasje e orientuar nga Klienti:** OTP Bank Albania dallohet për një proces kredidhënieje transparent, fleksibël dhe me qasje këshilluese, të përshtatur me ciklin e jetës së biznesit. Këshillimi i dedikuar ndihmon klientët të informohen dhe të marrin vendime sipas nevojave financiare të binesit.

• **Raporti i Kredive me Probleme (NPL):** Për segmentin e korporatave është ndër më të ulëtit për më shumë se një dekadë, duke reflektuar menaxhimin e disiplinuar të riskut dhe praktikat e kujdesshme të huadhënies. Cilësia e lartë e portofolit, kostot e ulëta të NPL-ve dhe përfitueshmëria janë avantazhe afatgjata për bankën. Menaxhimi i riskut mbetet një shtyllë kyçe për qëndrueshmërinë dhe besueshmëri ndaj klientëve

• **Portofoli i Leasing-ut** i cili është nën menaxhimin e Divizionit të Korporatave: portofoli i leasing-ut u rrit me 38% krahasuar me vitin e kaluar, ku banka mbulon një pjesë tregu prej 9.4% në tregun e leasingut në vend.

• **Bashkëpunime me Institucionet Ndërkombëtare:** OTP Banka Albania ka zgjeruar bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare si BERZH dhe Fondi i Garancisë së Kredive Rurale. Përmes programeve si SME Competitiveness, Risk Sharing dhe Agro & Hotels Financing, ku banka ka zgjeruar aksesin për financimi tek sektorëve të nën-shërbyer, veçanërisht për bizneset rurale dhe më pak të sigurta, duke ofruar shërbime këshillimi, mekanizma ndarjeje risku dhe financime me stimuj (si p.sh. rimbursime për investime).

• **Kredi të Qëndrueshme dhe në përputhje me ESG:** Parimet ESG janë të integruara plotësisht në proceset e kredishënies së Bankës. Çdo kredi i nënshtrohet vlerësimit ESG për të siguruar përputhshmërinë në objektivat e qëndrueshmërisë. Banka angazhohet në edukimin e klientëve për standartet ESG duke nxitur ndërgjegjësimin dhe qëndrueshmërinë.

Në vitin 2024, OTP Bank Albania tejkaloi objektivin për financimin e kredive të gjelbra me 160%, duke arritur 96 milionë euro kundrejt një objektivit prej 60 milionë eurosh duke dëshmuar lidershipin në financimin e qëndrueshëm.

Operacionet, Digjitalizimi dhe Shërbimet

Në paralel me suksesin në fushën e kredidhënies, OTP Bank Albania ka vendosur theks të veçantë në shërbimet e transaksioneve e pagesave, kapacitetet digjitale dhe ofrimin e shërbimit ndaj klientit, të cilat përbëjnë burime të qëndrueshme të të ardhurave nga komisionet dhe likuiditetit.


• Klientët e Divizionit të Biznesit realizuan mbi 3.5 miliardë euro transferta bankare përmes OTP Bank Albania gjatë vitit 2024. Aktiviteti i routing-ut nga klientët korporativë u rrit me 7.8% krahasuar me një vit më parë. Rreth 20,000 pagamarrës, ku biznesit menaxhohen nga ky divizion.

• Pjesa e tregut të bankës për detyrimet nga bizneset (depozita) në sektorin privat arriti në 9.1%. një objektiv strategjik është që banka të bëhet banka operacionale kryesore për klientët dhe furnitorët e tyre, duke kapur kështu të gjithë ciklin e fluksit të parasë dhe duke forcuar rolin e OTP Bank Albania si partnet finnaciar kryesor.

• Shërbimet POS për klientët korporativë u rritën me 168% bazuar me një vit më parë. Banka ka modernizuar flotën e saj të paisjeve POS me teknoogji të avancuar të integruara me sistemin bazë të bankës. Paisjet e reja përfshijnë funksionalitet për rimbursime, lidhje Wi-Fi për shërbim të pandërprerë dhe raporte të përmirësuara mbi transkasionet për gjurmimin financiar.

• OTP Bank Albania vazhdon të përmirësojë platformat e saj digjitale, njëkohësish duke ruajtur cilësinë e shërbimit në degë. Kjo qasje e dyfishtë i shërben si klientëve të orientuar nga teknologjia ashtu dhe atyre tradicional, duke rritur kënaqësinë dhe volumin e transaksioneve. Në vitin 2024, platforma e bankingut elektronik u përmirësuar ndjeshëm me funksione të reja dhe autorizim me shumë nivele i vlerësuar nga klientët korporativë që menaxhojnë struktura të ndërlikuara financiare.

• Bazuar në rezultatet financiare të vitit 2023, OTP Bank Albania arriti një normë depërtimi prej 70% tek 200 kompanitë më të mëdha në vend, duke reflektuar praninë e fortë dhe rolin udhëheqës të bankës në shërbimin e bizneseve më me ndikim në Shqipëri.



BANKINGU
RETAIL

Banka OTP Albania është prezente në vend me shtrirje të gjerë të një rrjeti prej 49 degësh dhe 1 Private Banking, pozicionuar në mënyrë strategjike, pothuajse në të gjithë qytetet e Shqipërisë, së bashku me një rrjet prej 200 ATM shumë funksionale.

Vitet e fundit Banka OTP ka rritur ndjeshëm prezencën e saj me ATM në të gjithë vendin, si në numër ashtu edhe në shpërndarje gjeografike. Gjithashtu, aplikacioni ynë Online Banking ka pësuar një përmirësim thelbësor për sa i përket eksperiences se klientit, dhe tashmë përfshin shumë funksionalitete të reja duke i ofruar klientëve qetësinë dhe komoditetin e kryerjes së veprimeve bankare në distancë.

OTP Bank Albania është gjithashtu një bankë lider për aktivitetin e kredidhënies, duke u renditur e treta në vend për sa i takon segmentit të individëve. Kjo gjë është arritur me sukses, duke ruajtur paralelisht një nga raportet më të ulëta të NPL-së në treg.

Rrjet i gjerë degësh - OTP Bank Albania ofron shërbime bankare në pothuajse të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 14 degë në Tiranë, 1 Private Banking dhe 35 degë në qytete të tjera.

Degët luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve me klientët, duke ofruar produkte dhe shërbime financiare për çdo kategori. OTP Bank Albania ka një rrjet të gjerë dhe të larmishëm degësh në të gjithë vendin, duke përfshirë si degë kryesore të mëdha, me shërbim gjithëperfshirës në qytetet kryesore, ashtu edhe degë më të vogla të cilat janë vendosur në qendra më të skajshme, të cilat ofrojnë shërbime më specifike në përputhje me nevojat e komunitetit në këto zona.

Rrjeti i Degëve në OTP Bank Albania zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, sipas ndryshimeve demografike të brendshme në vend dhe në përgjigje të nevojave të klientëve. Gjatë vitit 2024, banka ri-alokoi një nga degët e saj historike (Blloku i Ambasadave) në një godinë të ndërtuar rishtas në një nga zonat kryesore të Tiranës, Rruga e Kavajës. Në qendër të çdo zhvillimi, është përmirësimi i përvojës së klientit përmes rindërtimit të ambienteve më komode për klientët tanë që i përshaten të gjithë shërbimeve të ndyshme që ofrohen në degë. Nëpërmjet këshillimit të personalizuar dhe proceseve të shpejta në kohë, banka ka arritur të realizojë objektivin strategjik, për një përvojë të shkëlqyer të klientit.

Sektori i Mbështetjes së Shitjeve të Degëve pati gjithashtu një vit shumë të suksesshëm në përmirësimin e të gjithë aktiviteteve të shitjeve, në të githë rrjetin e degëve. Ky përmirësim me fokus zhvillimin e stafit të degëve, u arrit nëpërmjet zbatimit të metodologjisë dhe moduleve bashkëkohore, trajnimeve invidivuale dhe në grupe, duke sjellë rritje profesionale dhe fuqizim të rrjetit të degëve.

Banka ka prezantuar nje rol të ri "SFE-Navigator", i cili nëpërmjet zbatimit të kësaj metodologjie do të ndihmojë zhvillimin e stafit të degëve në drejtim të rritjes profesionale, efikasitetit të tyre për aktivitetin e shitjes dhe të sigurojnë zbatimin e tij në të gjithë rrjetin. Banka tashmë po dëshmon përmirësime në aftësitë e shitjeve dhe rezultateve në degët pilot për këtë metodologji të re dhe planifikon ta implementojë atë në të gjithë rrjetin e degëve. Të gjitha degët do të ndërmarrin programin SFE për një periudhë njëmujore, dhe trajnimi do të përqëndrohet në menaxhimin e shitjeve, përmirësimin e aftësive dhe efikasitetit të shitjeve, aftësitë organizative dhe kujdesin ndaj klientit.

Aktiviteti i shitjeve në degë është mbështetur nga fushatat e CRM-së (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientët) për të personalizuar shitjet sipas nevojave dhe sjelljes së klientëve, duke përmirësuar shitjet e kryqëzuara dhe për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata. Fushatat CRM janë ndërtuar ne varesi te karakteristikave te klienteve dhe i kanë mundësuar bankës të ofrojë produkte që plotësojnë nevojat specifike të klientëve gjatë gjithë vitit. CRM nxit të gjitha iniciativat e shitjeve dhe siguron që klientit t'i ofrohen zgjidhjet më të mira dhe produkti më i përshtatshëm. Kredia konsumatore dhe produktet revolving kanë qenë në fokus gjatë vitit.

PORTOFOLI I KREDISË PËR INDIVIDË

Viti 2024 ka qenë një vit tejet i suksesshëm për OTP Bank Albania , për sa i përket segmentit të klientëve individë. Pavarësisht sfidave banka arriti të realizonte me sukses objektivat e saj ambicioze vjetore, duke vazhduar të shënojë rritje të qëndrueshme. Kështu, **portofoli i kredisë për klientët Individë** u rrit me rreth 12%, ndërsa depozitat me rreth 2%. Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm për të përmbushur nevojat e klientëve duke ruajtur njëkohësisht një pozicion të fortë financiar.

Produktet e kredisë konsumatore kanë qenë ndër prioritetet tona gjatë gjithë këtij viti, të nxitura nga pritshmëritë e klientëve për zgjidhje të shpejta dhe kushte fleksibël. Banka ofron një gamë produktesh të përshtatura për tipologji të ndryshme klientësh, përfshirë këtu interesa dhe komisione tejet konkurruese si edhe një shumë maksimale të konsiderueshme deri në 3 milionë lekë, pa kolateral. Për klientët pagamarrës banka gjithashtu ka rritur shumën maksimale të financimit në kredinë “Unik”, deri në 1.5 milionë lekë, pa kolateral dhe pa bashkëhuamarrës.

Shërbime të reja lidhur me kredinë konsumatore: Gjatë vitit 2024 OTP Bank Albania lançoi për herë të parë programin e **Kredive Konsumatore të para-aprovuara**. Ky program bazohet në një vlerësim efikas të riskut, dhe i ofron klienteve lehtësi në financimin me kredi konsumatore. Komunikimi i drejtpërdrejtë me klientët ka qenë çelësi i suksesit, duke u siguruar që ata të kuptojnë qartë atë që ofrohet dhe të mund ta përdorin në përfitimin e tyre maksimal. Ky program gjithashtu i inkurajon klientët që të eksplorojnë opsionet e kreditimit në mënyrën më efektive të mundshme.

Të dy produktet e kredisë konsumatore të pasiguruar në Bankën OTP përmbushin një nevojë të rëndësishme dhe kërkesë të vazhdueshme të bazës sonë të klientëve për financim. Kjo jo vetëm duke ofruar shuma të konsiderueshme pa kolateral/garantor, por gjithashtu një bazë solide për ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët.

• **Kredia Hipotekore:** Kërkesës së klientëve huamarrës për alternativa të qëndrueshme financimi dhe kushte sa më fleksibël, OTP Bank Albania i është përgjigjur me oferta të ndryshme promocionale gjatë gjithë vitit, duke i lehtësuar ata me një diferencim në çmim për vitin e parë, me një normë interesi fikse. Banka gjithashtu u ofron klientëve lehtësira alternative hipotekore, me dhe pa sigurim jete, ose me kolateral alternativ.

• **Shërbime të reja kredisë hipotekore:** OTP Bank Albania ka zgjeruar gamën e aktiviteve të saj për kredinë hipotekore, duke bashkëpunuar me agjentë jobankarë për të ofruar shërbime huadhënieje, pa pasur nevojë që të përdoren burimet njerëzore në rrjetin e degëve. Ky kanal alternativ shitjesh, i cili është i pari në aspektin digjital, është fokusuar në gjenerimin e klientëve nëpërmjet referimit nga partnerët, duke iu mundësuar degëve që veprojnë si qendra për shërbime më komplekse, ose me vlerë të lartë.

Banka i ka vendosur vetes objektiva shumë ambiciozë për këtë strategji, ku burime të konsiderueshme njerëzore i janë dedikuar eksplorimit dhe krijimit të partneriteteve të reja dhe vendosjes së produkteve dhe proceseve të mbuluara. Deri më sot, përparësia ka qenë rritja e portofolit të kredive hipotekore, i cili është bërë një komponent kyç i strategjisë që kemi në Retail. Banka ka pasur një vit shumë të suksesshëm në këtë drejtim, i cili ka kontribuar në përgjithësi me 16%, në rritjen e kredisë. Kjo është arritur nëpërmjet:

• **Zgjerimi i Portofolit të Zyrave të Pasurive të Paluajtshme** - Në vitin 2024, banka zgjeroi ndjeshëm bashkëpunimin e saj me zyrat e pasurive të paluajtshme në sektorin e shitjeve alternative. Kjo përfshinte punën me partnerë të rinj dhe ekzistues dhe numri i partnerëve aktivë u rrit me 40% krahasuar me vitin 2023, duke arritur në rreth 60 zyra kryesore. Referimet e suksesshme u përkthyen në vëllime të larta për vitin 2024, dhe ky biznes e tejkaloi objektivin e tij me 209%, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e përgjithshme të bankës në gjenerimin e kredive hipotekore. OTP Bank Albania ka finalizuar gjithashtu një marrëveshje me Shoqatën Kombëtare të Pasurive të Paluajtshme Shqiptare, e cila tashmë ka pasur një ndikim të rëndësishëm në biznesin në këtë sektor. Finalizimi i marrëveshjes do të thotë që të gjithë anëtarët e shoqatës tashmë mund të bëhen partnerë të bankës, gjë që paraqet mundësi të reja të rëndësishme për bashkëpunim në vitin 2025.

• **Digjitalizimi i Sistemit të Origjinimit të Kredisë (Loan Origination Tool - LOT)** ka vazhduar këtë vit, duke rritur efikasitetin, ulur kostot operacionale, përmirësuar menaxhimin e riskut dhe përmbushur kërkesat rregullatore. Tashmë Banka OTP Albania ka një sistem i cili mbeshtetet në një proces transformimi të vazhdueshëm nga aplikimi e deri në disbursimin automatik.

Automatizimi fillon që nga perzgjedhja e produktit të kerkuar nga klienti e deri në gjenerimin e kontratave të kredive, duke siguruar përllogaritje të sakta të vlerësimit financiar, integrim me sistemin qendror të bankës, unifikim të të dhënave, përshtatje të ofertave të dedikuara dhe një eksperiencë tepër fleksibël dhe miqësore të përdoruesit.

Rezultati i përgjithshëm dhe kryesor; një përvojë tejet e përmirësuar edhe për klientët.

Produktet e depozitave

Kërkesës së klientëve për një gamë të gjerë produkte depozitash gjatë vitit 2024, OTP Bank Albania i është përgjigjur me oferta të reja që ofrojnë më shumë fleksibilitet dhe kthim më të mirë, të përshtatshëm për nevojat dhe qëllimet specifike të tyre.
Produktet e depozitave me kohëzgjatje dy deri në tre vjet, janë ofruar këtë vit në të dy monedhat, si në lekë ashtu edhe në euro, kombinuar kjo me norma interesi të pershkallëzuara, me norma më të larta për depozitat me kohëzgjatje më të gjatë, apo norma të segmentuara përkundrejt afateve, si p.sh. gjashtëmujore, ose vjetore.

OTP Bank Albania është gjithashtu e fokusuar në zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme afatgjata me klientët e nje segmenti shumë të rëndësishëm, atë të të rinjve. **"Paketa Student"** e cila ofrohet pa pagesë , është ndërtuar duke patur në qendër të vëmendjes të rinjtë studentë, mbështetur nevojat e tyre specifike dhe sfidat me të cilat ata përballen. Duke ofruar kombinimin e duhur të produkteve dhe sherbimeve për këta të rinj, ndërsa ata studiojnë, banka synon gjithashtu të nxisë marrëdhënie afatgjata bazuar në pavarësinë e tyre financiare në të ardhmen.

Një qasje e ngjashme është ndjekur edhe më klientët e një moshe akoma më të vogel, siç janë fëmijët. Banka ka ndërmarrë disa fushata promocionale, duke dhuruar nje shpërblim simbolik fillestar në llogaritë e kursimeve të fëmijëve, i ndjekur me depozitime të rregullta nga prindërit, tepër të vlefshme për t'u përdorur në momente të rëndësishme për fëmijët, kur ata arrijnë një moshë madhore. Këto nisma inkurajojnë kursimet dhe u ofrojnë prindërve mjetet e duhura në fillim të rrugëtimit financiar, të fëmijëve të tyre.

Si pjesë e **angazhimit të saj në përfshirjen financiare dhe përgjegjësinë sociale**, Banka OTP ofron produkte të llogarive rrjedhëse, apo paketa të dedikuara falas për klientët pensionistët, duke u siguruar që ata të kenë akses lehtësisht në shërbimet baze bankare pa asnjë kosto shtesë. Nëpërmjet këtyre produkteve dhe shërbimeve, pensionistët jo vetëm që marrin pensionin rregullisht, por gjithashtu kanë mundesi të kryejnë një sërë shërbimesh si tërheqjet dhe depozitimet me kartë, transaksionet e pagesave me kartë, përdorimin e platformës bankare online, pagesat e shërbimeve utilitare etj., të gjitha këto pa asnjë pagesë ekstra. Gjithashtu, këtë vit, në kuadër të zgjerimit të angazhimit në përfshirjen financiare dhe përgjegjësinë sociale të saj, banka ofron produkte të dedikuara si "llogaria me shërbime bazike ", për një shtresë tjetër të popullsisë, atë të cilën deri më tani nuk ka pasur akses në bankë. Këto shërbime ofrohen gjithashtu falas, duke vënë në pah akoma më shumë përkushtimin e Bankës OTP ndaj këtyre shtresave.

Aktiviteti i Bankës OTP si **Broker në fushën e sigurimeve**, është një aktivitet i ri dhe gjithashtu një nga shtyllat e strategjisë së Grupit OTP për zhvillim, jo vetëm si burim të ardhurash, por si mënyrë për të krijuar siguri dhe dhënë vlerë investimeve të klientëve tanë.

Në fillim të vitit 2024 OTP Bank Albania ka lançuar aktivitetin e brokerimit në fushën e sigurimeve, duke shërbyer si ndërmjetës midis klientëve dhe kompanive të sigurimit. Çfarë është më e rëndësishme, Banka nëpërmjet një analize të thelluar, u rekomandon klientëve policat e sigurimit që u përshtaten më mirë nevojave të tyre dhe i këshillon për zgjedhjen e ofertës më të mirë.

Aktiviteti i ri i brokerimit në fushën e sigurimeve, lehtëson klientët në marrjen e vendimit të përzgjedhjes së policës së sigurimit të jetës dhe pronës, që të jenë të mbrojtur financiarisht në momente sfiduese të jetës. Ofrimi i produkteve të sigurimit në gamën e shërbimeve tona, rrit besnikërinë e klientit, diversifikon burimet e të ardhurave dhe kontribuon në një menaxhim efikas të riskut, rrjedhimisht forcon stabilitetin financiar, me përfitueshmëri të dyanshme, bankë-klient.

>Zhvillimi i Kanaleve Digjitale

Sistemi financiar në Shqipëri po ecën me ritme të shpejta drejt digjitalizimit, dhe OTP Bank Albania është një nga bankat më aktive në treg për sa i përket shërbimeve digjitale, duke ofruar eksperienca të avancuara përmes të gjithë kanaleve. Platforma digjitale e bankës sjell vlerë për klientët duke përmirësuar aksesin, lehtësinë në përdorim dhe efikasitetin. Gjatë vitit të fundit, banka ka forcuar më tej pozicionin e saj si një institucion inovativ dhe i orientuar drejt klientit, duke ofruar produkte dhe shërbime bashkëkohore dhe të qëndrueshme.

1. Platforma e Bankingut Online

Platforma online, e lehtë për t'u përdorur, ka qenë një shtyllë e rëndësishme e strategjisë së OTP Bank për të ofruar një përvojë më të mirë për klientët. E përmirësuar me elementë sigurie, sipas standardeve ndërkombëtare, platforma ofron:

- Pamje të detajuar të llogarive dhe transaksioneve të mëparshme
- Informacion në kohë reale për produktet financiare që përdor klienti
- Siguri të lartë për mbrojtjen e të dhënave, gjatë kryerjes së veprimeve bankare

Në vitin 2024, banka shënoi një rritje prej 76% në përdorimin e platformës online krahasuar me vitin e kaluar, çka tregon rritje të qëndrueshme në përdorim dhe kënaqësi të klientëve. Janë shtuar edhe përmirësime të reja që e bëjnë navigimin më të thjeshtë dhe i japin klientit më shumë pavarësi për të menaxhuar shërbimet vetë.

Në përputhje me objektivat e saj për zhvillim të qëndrueshëm, OTP Bank Albania ka përqafuar transformimin digjital, duke investuar në teknologji të reja dhe duke punuar për një të ardhme më të gjelbër.

2. Rrjeti i Bankomateve (ATM)

OTP Bank ka zgjeruar rrjetin e saj të bankomateve në 200 ATM aktive, duke siguruar një pozicion lider në tregun shqiptar. Rrjeti ofron:

- Shtrirje të gjerë në të gjithë vendin
- Funksione të avancuara si depozitim cash, pagesa, dhe kontroll balance
- Zgjerimi i këtij rrjeti është bërë me fokus tek nevojat e klientëve dhe ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase në çdo kohë

3. Kartat Bankare

Portofoli i kartave të OTP Bank është krijuar për të përmbushur nevojat e ndryshme të klientëve. Disa nga karakteristikat kryesore përfshijnë:

- Përdorimi i teknologjive të avancuara si pagesat pa kontakt dhe siguria me kod 3D.
- Rreth 70% e kartave të debitit dhe kreditit, përdoren rregullisht për transaksione.
- Fushata të suksesshme me "cash-back" kanë nxitur përdorimin e kartave dhe edukuar klientët për të kaluar nga përdorimi tradicional drejt shërbimeve digjitale.

4. Rrjeti i Pajisjeve POS

OTP Bank Albania ka investuar në teknologjinë më të avancuar për pajisjet POS, duke u fokusuar në:

- Ofrimin e teknologjisë më të mirë për tregtarët
- Ruajtjen e standardeve të larta të shërbimit dhe forcimin e marrëdhënieve me tregtarët
- Ekskluzivitet në ofrimin e metodave të pagesës si American Express, VISA dhe MasterCard

Kjo nismë ka forcuar partneritetet me tregtarët dhe ka rritur me 160% xhiron përmes pajisjeve POS në vetëm një vit.

OTP Bank Albania vazhdon ta shohë inovacionin digjital si prioritet strategjik për të qëndruar përpara në tregun bankar. Përmes investimeve në teknologji dhe edukimit të klientëve, banka i ndihmon ata të përfitojnë nga avantazhet e bankingut në distancë, duke kontribuar për një të ardhme më efikase, më të lehtë dhe më të qëndrueshme.

>Segmenti MSE

Gjatë vitit 2024, OTP Bank Albania ka shënuar arritje të rëndësishme, duke forcuar rolin e saj si një aktor kyç në mbështetjen e rritjes së biznesit dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Me fokus të veçantë tek nevojat financiare të bizneseve në segmentin MSE, Banka OTP ka ofruar zgjidhje financimi fleksibël dhe përshtatura që i përgjigjen kërkesave të tregut, duke ndërtuar partneritete afatgjata me biznese të sektorëve të ndryshëm. Gjatë këtij viti, banka ka zgjeruar më tej portofolin në segmentin MSE, duke vënë në qendër praktikat e qëndrueshme të financimit dhe produkte të reja që mbështesin konkretisht Bizneset e Vogla dhe të Mesme. Këto përpjekje kanë sjellë rritje të volumit të kredidhënies dhe një nivel më të lartë të kënaqësisë së klientëve.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ka qenë promovimi i produkteve të kredisë për sektorin e Bujqësisë dhe Energjisë së Rinovueshme. Kreditë Agro janë krijuar për të mbështetur fermerët dhe bizneset bujqësore, duke ofruar kushte të favorshme si norma konkurruese interesi dhe skema financimi të përshtatura për projekte bujqësore dhe blegtorale. Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm, është rritur gjithashtu interesi për financimin e projekteve fotovoltaike, të cilat synojnë të ndihmojnë bizneset në uljen e kostove të energjisë dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. OTP Bank Albania ofron për këto projekte kushte tërheqëse, përfshirë norma preferenciale interesi. Gjithashtu, janë krijuar skema të posaçme për mbështetjen e startup-eve dhe bizneseve të reja.

Duke hyrë në vitin 2025, sektori mbetet i përkushtuar ndaj inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Në fokus do të jetë zhvillimi i produkteve të reja financiare që i përgjigjen nevojave në evoluim të bizneseve. Gjatë vitit 2024, OTP Bank Albania ka dëshmuar qëndrueshmëri dhe aftësi për t'u përshtatur, duke forcuar më tej rolin e saj si një partner kyç për bizneset që kërkojnë mbështetje financiare.



TREGJET GLOBALE

Gjatë vitit 2024, aktiviteti i këmbimit valutor ka patur një performanceë solide dhe në rritje, duke reflektuar përkushtimin e Tregjeve Globale për të ofruar zgjidhje të përshtatura për klientët korporatë dhe individë.

Fitimi dhe Performanca

OTP Bank Albania ka vijuar me rritje të volumit të transaksioneve FX krahasuar me vitin 2023, falë rritjes së penetrimit në bazën e klientëve që operojnë në sektorin e tregtisë me jashtë. Gjithashtu është realizuar diversifikim i mëtejshëm dhe rritje e bazës së klientëve edhe në industri kyçe si ndërtim, hoteleri turizëm, farmaceutikë, komunikim, etj.

Fitimi nga aktiviteti valutor ka ruajtuar trendin pozitiv pavarësisht faktit që çifti i monedhave EUR/LEK gjatë vitit 2024 ka qenë mjaft i stabilizuar, duke u luhatur në një interval ndjeshëm më të ngushtë se viti paraardhës.

Pamje e ecurisë EUR/LEK për periudhën Janar 2023 – Dhjetor 2024



Zhvillimi teknologjik dhe Inovacioni

Tregjet Globale kanë vijuar investimet në digjitalizimin e shërbimeve financiare. Për herë të parë veprimet e këmbimit valutor regjistrohen në një platformë elektronike, e cila garanton saktësi maksimale, shpejtësi dhe eleminim të riskut operacional, që lidhet me këmbimet valutore. Kjo platformë u përdor për herë të parë në vitin 2024 nga personeli i Tregjeve Globale dhe qëllimi është që brenda vitit 2025, ky shërbim t'u mundësohet klientëve.

Menaxhimi i Riskut

Rol shumë të rëndësishëm në aktivitetin e këmbimit valuator, ka patur komunikimi proaktiv me klientë dhe analiza e kujdesshme e tregut me qëllim parashikimin dhe menaxhimin efektiv të ekspozimit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Gjithashtu, kjo analizë e thelluar ka ndihmuar në ofrimin e çmimeve konkurruese dhe ruajtjen e pozicionit mes bankave "top" në aktivitetin e këmbimit valutor.

Për sa i perket investimeve, mund të thuhet me siguri të plotë që tashme banka ka krijuar një bazë klientësh që njohin proceset tona dhe drejtohen për investime apo riinvestime, duke besuar në trajtimin transparent dhe të dedikuar.

Viti 2024 ishte vit konsolidues për sa i përket prezencës në treg dhe on-boarding të klientëve. Krahasimisht numri i klientëve të rinj ka qenë më i ulët sesa në vitet e kaluar, por kjo vjen edhe prej faktit që vetë banka ka përfunduar procesin e on-boarding të klientëve të saj të mbartur ,apo historik ndërkohë që ecuria e mirë e aktivitetit lexohet prej numrit të transaksioneve/kërkesave të adresuara për investime i cili është mëse i kënaqshëm.

Transaksionet me titujt e borxhit ruajnë të njëjtën shpërndarje të viteve të mëparshme, ku dominuese jane kërkesat për ndërmjetësim në ankandet e tregut primar, ndërkohë që janë ekzekutuar të gjithë kërkesat për shitblerje në treg sekondar.

Duhet theksuar se veçoria e vitit 2024 ka qenë rritja e aktivitetit të brokerimit me titujt si aksionet dhe kuotat e fondeve të tregtueshme në tregjet e huaja. Këto tituj janë kërkuar dhe tregtuar më shumë sesa vitet e kaluar. Mundësia për aksesim të tregjeve ndërkombëtare, nga cilido që di ku të investojë dhe kur të investojë, është shfrytëzuar më tepër gjatë vitit 2024.


Në këtë drejtim ka punuar edhe Departamenti i Tregjeve Globale për:

- të rritur aksesin në tregjet e huaja, duke zgjeruar listën e vendeve të aksesueshme për të gjithë klientët e bankës,
- është perfeksionuar oferta për klientët Private Banking

Është punuar gjithashtu për përmirësimin e kuadrit kontraktual/ rregullativ me klientët, duke pasur gjithmonë në fokus mbrojtjen e klientit dhe rritjen e transparencës, ndërkohë që procesi i ndjekur operacionalisht për investimet, është rishikuar me qëllim përfshirjen dhe nxitjen e përdorimit të online banking.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2024, Banka OTP Albania zhvilloi emetimin e borxhit të varur duke ofruar për shitje obligacione të ndërvaruara me statusin e kapitalit të nivelit të dytë. Shuma për emetim ishte 15 milion euro, ofruar përmes titujve të borxhit me afat 7 vjeçar me normë vjetore intersi fikse në nivelin 4.50% dhe kupon gjashtëmujor. Vlera nominale e çdo obligacioni të ofruar, në përputhje me akt-ofertën ishte 10,000 euro, ndërkohë që shuma e nënshkrimit për çdo investitor ishte minimalisht 50,000 euro.

Banka OTP Albania Sh.a. arriti të mbyllë me sukses periudhën e ofertës për emetimin në datë 20 nëntor 2024, të obligacionit afatgjatë me ISIN Code - AL0022100302. Numri i obligacioneve të emetuara rezultoi 338 copë për shumën totale prej 3.38 milion Euro. Interesi për investim erdhi kryesisht nga klientët retail, duke qene edhe segmenti tradicionalisht me tendenca kursimi, por nuk munguan edhe klientët e biznesit me shumat më të mëdha.



MENAXHIMI I RISKUT NË OTP BANK ALBANIA SH.A

OTP Bank Albania ka krijuar një kulturë të fortë të menaxhimit të riskut duke u përshtatur vazhdimisht me standardet rregullatore në zhvillim.

Korniza e Menaxhimit të Riskut:

Struktura Organizative: Departamentet dhe mjetet e dedikuara sigurojnë që menaxhimi i riskut të jetë pjesë e integruar e operacioneve të përditshme.

Oreksi i Riskut dhe Treguesit: Një kornizë e përcaktuar e oreksit të riskut me tregues RAS, udhëzon vendimmarrjen brenda kufijve të miratuar.

Procedurat e Standardizuara: Procedurat gjithëpërfshirëse përfshijnë standardet më të larta të riskut, në të gjithë organizatën.

Limitet dhe Kontrollet Lokale: Limitet e qarta të riskut lokal dhe një gamë e larmishme kontrollesh mbrojnë operacionet e bankës.

Monitorimi dhe Përputhshmëria:

Mbikëqyrja Rregullatore dhe Operacionale: Raportimi i rregullt dhe i dedikuar përputhet me standardet e Bankës së Shqipërisë dhe IFRS, duke përfshirë treguesit sasiorë dhe cilësorë.

Respektimi i Vazhdueshëm i Rregulloreve: Banka përmbush vazhdimisht kërkesat rregullatore të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe rregullat dhe kufizimet nga Grupi OTP.

Në përgjithësi, qasja gjithëpërfshirëse e menaxhimit të riskut të OTP Bank Albania jo vetëm që mbron operacionet e saj aktuale, por gjithashtu krijon një themel të qëndrueshëm për rritje të ardhshme, besim të shtuar të palëve të interesuara dhe një portofol krediti të fortë dhe me cilësi të lartë. Ky integrim strategjik i kontrolleve të riskut, siguron që banka të mbetet konkurruese në sektorin bankar.



TIPOLOGJITË E RREZIQEVE MENAXHOHEN NË MËNYRË EFEKTIVE NGA NJË SISTEM I FORTË DHE I PËRKUSHTUAR

01 STRUKTURA ORGANIZATIVE E DIVIZIONIT TË RISKUT

Në përputhje me strukturën e Grupit OTP, Divizioni i Riskut është strukturuar për të identifikuar, zbutur dhe menaxhuar në mënyrë proaktive rreziqet që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar dhe efikasitetin operacional të Bankës.

Çdo departament brenda Divizionit të Riskut është i ngarkuar të zbatojë rregulloret në fuqi që përbëhen nga politika, procedura dhe kontrolle. Ky proces kërkon planifikim të saktë dhe rishikim dhe përditësim të rregullt të rreziqeve që lindin, duke siguruar që monitorimi ynë i rreziqeve, të mbetet gjithëpërfshires.


Një qasje e tillë sistematike është thelbësore për të mbështetur në mënyrë efektive rritjen e portofolit.

02 PARIMET E RREZIKUT TË KREDITIT JANË PËRFORCUAR PËR TË MBËSHTETUR DINAMIKËN NË EVOLUCION, SI NË OPERACIONET E SHITJES ME PAKICË DHE NË OPERACIONET E KORPORATAVE


Politikat e menaxhimit të riskut të OTP Bank Albania janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar të gjitha llojet e rreziqeve, për të vendosur limite dhe kontrolle të përshtatshme të riskut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve me anë të sistemeve administrative dhe të informacioneve të besueshme dhe të përditësuara.

OTP Bank Albania rishikon rregullisht politikat dhe procedurat e saj të menaxhimit të riskut, duke synuar gjithmonë praktikat më të mira dhe në perputhshmëri me normativat e Grupit Bankar. Duke forcuar vazhdimisht llogaridhënien individuale dhe profesionalizmin përmes trajnimeve të rregullta, ne promovojmë një kulturë dhe mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv.

Politikat e oreksit për riskun dhe kreditimin janë krijuar dhe i nënshtrohen rishikimit të rregullt, me përditësime të paraqitura dhe të miratuara nga Bordi Mbikëqyrës. Rishikimet e këtyre limiteve janë përshtatur për të reflektuar sektorët, industritë, segmentet e klientëve, llojet e produkteve, garancitë dhe strategjitë e zbutjes.




Përbërja e Portofolit të Kredisë Dhjetor 2023




Përbërja e Portofolit të Kredisë Dhjetor 2024

Rritja e portofolit të kredisë ishte në nivele të kënaqshme për vitin 2024, ndërsa raporti i kredive me probleme ka rënë në 5.62%, për shkak të standardeve të larta të kreditimit dhe monitorimit efikas të ekspozimeve.



Përbërja e Portofolit të Kredisë
Dhjetor 2023



Përbërja e Portofolit të Kredisë
Dhjetor 2024

Provigjimi, si një faktor thelbësor që ndikon në rezultatin financiar të bankës, është nën përgjegjësinë e Divizionit të Riskut, në përputhje si me rregulloret lokale ashtu edhe me standardet IFRS.

Nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në mbulimin e provigjoneve vit pas viti, me ndryshime të vogla për shkak të rishikimit vjetor të PD dhe faktorëve makroekonomikë. Ndërkohë, mbulimi i provigjoneve për kreditë me probleme arriti një nivel prej 60.74% në portofolin e kredive me probleme, kjo për shkak të vlerësimit individual për klientët e Klasës 3. Ky nivel mbulimi ka garantuar menaxhimin e sigurt dhe efikas të portofoleve tona.

Masat e fshirjes së kredive zbatohen sipas kuadrit rregullator si për segmentet me pakicë, ashtu edhe për ato jo-me pakicë.

03 RREZIQET E TREGUT

Rreziku i Tregut menaxhohet dhe monitorohet nga Departmenti i Menaxhimit të Risqeve të integruara dhe qeverisjes së Riskut, pjesë e Divizionit të Riskut. Monitorimi konsiston në mbikëqyrjen e kufijve të pozicioneve të hapura në treg dhe limiteve të miratuar për kundërpartinë, brenda kufijve të dedikuar të miratuar nga Bordi. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të vlerësojë me saktësi dhe të menaxhojë në mënyrë proaktive ekspozimet që burojnë nga luhatjet e tregut, duke siguruar një ekuilibër mes rrezikut dhe përfitimit.

04 RREZIKU OPERACIONAL

Menaxhimi i Riskut Operacional menaxhohet nga Departmenti i Menaxhimit të Risqeve te integruara dhe qeverisjes se Riskut, pjesë e Divizionit të Riskut. Qëllimi i riskut operacional është identifikimi, vlerësimi dhe zbutja e rreziqeve që rrjedhin nga proceset e brendshme, gabimet njerëzore, dështimet e sistemit ose ngjarjet e jashtme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe për të minimizuar humbjet financiare.

05 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Menaxhimi i riskut të likuiditetit në OBA përfshin ruajtjen e një ekuilibri optimal midis aseteve likuide dhe kërkesave për financim për të përmbushur detyrimet financiare në kushte normale dhe stresi. Ai përfshin parashikimin e fluksit të parasë, përputhjen me treguesit rregullatorë si LCR dhe NSFR, testet rigoroze të stresit dhe analizën e skenarëve, menaxhimin efektiv të aseteve dhe detyrimeve, si dhe strategjitë e përcaktuara mirë të financimit në situatë emergjence - të gjitha të mbështetura nga struktura të dedikuara qeverisëse, për të siguruar stabilitetin financiar edhe gjatë krizave.

06 RREZIQET STRUKTURORE

Rreziku strukturor i referohet dobësive të natyrshme të përfshira në kuadrin financiar dhe operacional të Bankës. Kjo përfshin rreziqe të tilla si luhatjet e normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, të cilat mund të çojnë në humbje ose zhvlerësim të aseteve, si dhe rreziqet që rrjedhin nga një mospërputhje midis maturimeve të aseteve dhe detyrimeve. Këto rreziqe janë thelbësore për modelin e biznesit të bankës dhe monitorohen nga afër nga funksioni i Menaxhimit të Aseteve dhe Detyrimeve (ALM) për të siguruar stabilitet financiar afatgjatë dhe zbutje efektive të rrezikut.



PROJEKTE TË RËNDËSISHME

Projektet Strategjike të Zhvilluara Gjatë Vitit

Gjatë vitit që lamë pas, banka ka vijuar me zbatimin e një sërë projektesh të rëndësishme që synojnë përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e përvojës së klientit. Më poshtë paraqiten projektet më të rëndësishme të realizuara nga Banka OTP Albania përgjatë vitit dhe çfarë na pret deri në fund të vitit 2025:

1. Zhvillimet pas Migrimit në CBS dhe Ndërfaqet Digjitale

Pas përfundimit të migrimit në sistemin e ri, banka OTP Albania ka ndërmarrë një sërë hapash për të përmirësuar dhe maksimizuar përfitimet nga kjo platformë. Gjatë vitit janë koordinuar dhe zbatuar mbi 30 ndryshime funksionale në sistemet si: CBS, Kartat dhe POS, si dhe në Online Banking. Këto përmirësime kanë pasur për qëllim:

- Rritjen e stabilitetit dhe performancës së sistemeve
- Përmirësimin e ndërfaqes së përdoruesit për klientët dhe punonjësit
- Automatizimin e proceseve kyçe për të ofruar shërbime më të shpejta dhe më të sigurta

2. Projekti "New Home"

Një nga projektet më ambicioze të vitit ka qenë fillimi i zbatimit të projektit "New Home", i cili përfshin zhvendosjen graduale të punojësve të bankës në mjediset e reja. Ky projekt synon të krijojë një mjedis pune më modern, funksional dhe të përshtatshëm për nevojat e stafit dhe klientëve. Ambientet e reja ofrojnë infrastrukturë të përparuar teknologjike dhe hapësira të dizejnuara për të nxitur bashkëpunimin dhe inovacionin.

3. Përmirësimi i Proceseve Operacionale

Në vitin 2024, një nga prioritetet kryesore të bankës ka qenë përmirësimi i proceseve të brendshme me qëllim rritjen e efikasitetit dhe reduktimin e punës manuale. Janë zbatuar përmirësime në më shumë se 20 procese, përfshirë:

- Proceset e kredidhënies, me qëllim përshpejtimin e vlerësimit dhe disbursimit të kredive.
- Procese të tjera operacionale, të cilat janë automatizuar ose thjeshtuar për të reduktuar ndërhyrjet manuale dhe për të rritur saktësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve.

4. Rikonstruksioni i disa degëve të Bankës

Është ndërmarrë një projekt i gjerë për rikonstruksionin dhe përmirësimin e degëve, me qëllim:

- Të jenë më afër nevojave të klientëve.
- Të përmbushin më mirë standardet moderne të shërbimit dhe sigurisë.
- Të ofrojnë një përvojë më të këndshme dhe efikase për klientët në ambientet fizike.

Çfarë na pret në vitin 2025

Gjatë vitit 2024, banka ka vijuar me një portofol të gjerë projektesh, që përfshin rreth 54 projekte aktive, të fokusuara në inovacion, digjitalizim dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve. Më poshtë paraqiten disa nga projektet më të rëndësishme që pritet të përfundojnë gjatë vitit 2025, të cilat synojnë të rrisin efikasitetin operacional, të zgjerojnë gamën e produkteve dhe të përmirësojnë përvojën e klientit në të gjitha kanalet e bankës:

- **Moduli i ri i pagesave** – Zëvendësimi i modulit të pagesave në përshtatje me ndryshimin e sistemit të pagesave të BoA dhe në përputhje me standardet e reja të sistemeve ndërkombëtare.
- **SEPA Project** – Implementimi i standardeve SEPA për pagesat në hyrje dhe në dalje.
- **CBS Upgrade and Interface** – Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit qendror bankar dhe ndërfaqeve të tij, për të rritur performancën, sigurinë dhe përputhshmërinë me sistemet e tjera të bankës.
- **Cards Processor Change** – Ndërrimi i procesorit të kartave, me qëllim rritjen e performancës dhe fleksibilitetit në ofrimin e produkteve të reja.
- **Online Banking New Platform** – Zhvillimi i një platforme të re për bankingun online, me dizajn modern dhe funksionalitete të avancuara për përdoruesit.
- **Physical Archive Space Optimization** – Optimizimi i hapësirave fizike të arkivës fizike dhe zëvendësimi me arkivë elektronike për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot operacionale.





DIVIZIONI DIGJITAL

Arritjet në 2024, Objektivat & Nismat Kryesore për 2025

Gjatë vitit 2024 u arritën përmirësime të ndjeshme në stabilitetin e sistemeve tona kryesore bankare, shërbimeve digjitale dhe mobile, si dhe në menaxhimin e mjedisit të të dhënave. Ndërsa hyjmë në vitin 2025, objektivat tona përqëndrohen në ndërtimin mbi këto arritje përmes inovacionit të mëtejshëm teknologjik, duke përfshirë një përditësim madhor në FlexCube 14.7, adoptimin e Euronet për procesimin e kartave, zhvillimin e një modeli të unifikuar të të dhënave dhe ambientit të përpunimit të të dhenave, si dhe zgjedhjen e një platforme digjitale bankare të gjeneratës së ardhshme. Ky raport paraqet arritjet tona kryesore për 2024 dhe nismat kryesore të planifikuara për 2025.

1. Arritjet në 2024

Përmirësimet në Bankën Qendrore & Transformimi Digjital

- Stabiliteti i FlexCube 12.3:

  • Parametrizimi i kushteve preferenciale brenda rreth 3 dite pune, si dhe lançimi i produkteve të reja si kreditë me interes fiks dhe depozitat me interes të parapaguar, etj.

- Implementimi i Funksionaliteteve të Reja:

  • Automatizimi i skemës së komisioneve të papaguara të klientit
  • Pasurimi i të dhënave për klientët dhe Llogaritë në funksionet përkatëse
  • Përllogaritje e automatike e tatimit në burim për kreditë e leasing-ut

Menaxhimi i Kartave, POS, dhe ATM-ve

  • Përfundimi i vlerësimit të plotë dhe përcaktimi i funksionaliteteve për procesorin e ri të kartave dhe ATM-ve (TPP).
  • Implementimi ATM friendly fee dhe POS EUR currenvy Acquirer.
  • Automatizimi i shitjeve të kartave të kreditit përmes LOT, duke çuar në përpunim më të shpejtë dhe eliminim të gabimeve.
  • Stabilizimi i procesit të pajtimit GL dhe ATM.

Shërbimet Digjitale dhe Mobile Banking

- Përmirësimi i Shërbimit dhe Procesit:

  • Konfigurimi i degës virtuale ne LOT për të siguruar përpunim të pandërprerë të transaksioneve nga tregtaret.
  • Automatizimi i menaxhimit të limiteve të kreditit përmes LOT
  • Automatizimi i printimit të kontratave të kredisë, duke reduktuar gabimet dhe duke rritur efikasitetin operativ.

Menaxhimi i të Dhënave & Operacionet IT

- Automatizimi i Raporteve & Proceseve të Punës:

  • Krijimi i Retail DataMart për monitorimin e rritjes neto te shitjeve dhe skemës së re të bonuseve.
  • Dizejnimi dhe implementimi i Risk DataMart për monitorimin e automatizuar të rreziqeve operacionale.
  • Ndërtimi i nje DATA Warehouse të unifikuar të të dhënave (ODM) që mbështet raportimin lokal dhe në grup.

- *Nismat e Infrastrukturës dhe Mbështetjes*

  • Ndërtimi i një qendre të re të të dhënave (Dat Center) për të strehuar aplikacionet kritike dhe për të ofruar scalability.
  • Zhvendosja e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese në Data Center për te siguruara efikasitet më të lartë operativ.
  • Stabilizimi i proceseve të fundit të ditës (EoD), muajit (EoM) dhe vitit (EoY) në të gjitha degët dhe kanalet.
  • Mbështetje e fortë teknike gjatë zhvendosjes së degëve dhe modernizimit të qendrës së të dhënave.
  • Finalizimi i projektit të Open Banking/PSD2.
  • Migrimi i përdoruesve në aplikacionet cloud, Exchange Online dhe MS Office 365.

2. Nismat Kryesore për 2025

Përsosmëria Operative dhe Eksperienca e Klientit

- Përmirësimi i Infrastrukturës IT:

  • Rritja e shkallëzimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për të mbështetur rritjen e pritshme të biznesit.

- Modernizimi i Sistemeve Kryesore:

  • Kalimi nga FlexCube 12.3 në FlexCube 14.7, duke ofruar performancë dhe funksionalitet të avancuar.
  • Nisja e procesit të përzgjedhjes për një platformë digjitale bankare për të përmirësuar eksperiencën digjitale dhe shërbimin ndaj klientit.
  • Kalimi i procesimit të kartave në procesorin e ri Euronet për siguri dhe efikasitet të përmirësuar.

- Forcimi i Menaxhimit të të Dhënave:

  • Zhvillimi i një modeli të unifikuar të të dhënave me perfshirjen e elementeve te analizes së avancuar për te lehtesuar procesin e vendimmarrjes



SIGURIA BANKARE

Siguria e informacionit në OTP Bank Albania është thelbësore për të garantuar besimin e klientëve dhe për të mbrojtur të dhënat. Banka ka ndërmarrë një sërë masash për të siguruar që informacioni i klientëve të mbetet i paprekur dhe të mos afektohet nga sulme të ndryshme kibernetike. Banka gjithashtu monitoron aktivitetet në kohë reale dhe përdor sisteme moderne të kombinuara me inteligjencën artificiale për të zbuluar çdo aktivitet të dyshimtë që mund të jetë tregues për një sulm kibernetik.

Këto masa kanë garantuar një nivel të lartë sigurie dhe kanë parandaluar incidentet e sigurisë së informacionit. Gjatë gjithë vitit 2024, testimet dhe auditimet e rregullta të sigurisë ishin pjesë e procesit për të monitoruar infrastrukturën dhe masat e sigurisë, duke u siguruar që çdo dobësi të identifikohet dhe rregullohet në kohën e duhur. Banka është gjithashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare si GDPR dhe PCI DSS, për të siguruar që të dhënat e klientëve të përpunohen në përputhje me ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe për të ruajtur besimin e klientëve.

Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm është mbrojtja kundër sulmeve të ndërprerjes së shërbimit (DDoS) dhe çdo lloj sulmi tjetër kibernetik që mund të shkaktojë ndërprerje të shërbimeve. Për këtë arsye, banka ka zbatuar plane të detajuara të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, për të siguruar që çdo incident i mundshëm të mos ndikojë në vazhdimësinë e shërbimit dhe ka investuar në sisteme moderne mbrojtëse.

Edukimi dhe trajnimi i punonjësve janë gjithashtu komponentë kryesorë të sigurisë, pasi ndërgjegjësimi për rreziqet dhe praktikat më të mira mund të parandalojnë shumë probleme. Në këtë kuadër, gjatë gjithë vitit 2024, banka ka kryer trajnime të vazhdueshme për sigurinë e informacionit dhe ka investuar në platforma të specializuara për zhvillimin e këtyre sesioneve trajnuese. Banka punon ngushtë me autoritetet për të siguruar përputhjen me rregulloret dhe ligjet që mbrojnë të dhënat e klientëve. Banka e Shqipërisë (BSH), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Ky bashkëpunim me autoritetet dhe zbatimi i masave të sigurisë krijojnë një kornizë të fortë për të mbrojtur informacionin konfidencial dhe për të siguruar që banka të operojë në një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për klientët e saj.

Gjatë vitit 2024, shumica e rasteve të mashtrimit me karta rezultuan nga skema të avancuara si phishing, vishing dhe faqe interneti mashtruese të krijuara për të mashtruar mbajtësit e kartave për të zbuluar informacione personale dhe bankare. Falë monitorimit të vazhdueshëm të transaksioneve dhe masave proaktive, vlera parandaluar e aktivitetit mashtrues u rrit me 111,74% , krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu, nëpërmjet reagimit të menjëhershëm dhe bashkëpunimit efektiv me tregtarët dhe institucionet financiare, u rikuperua për klientët 83,55% e vlerës totale të transaksioneve të suksesshme mashtruese. Gjatë gjithë vitit, ka pasur një angazhim të qëndrueshëm për të rritur ndërgjegjësimin e klientëve përmes fushatave të synuara informuese në mediat sociale, që synojnë edukimin e përdoruesve për përdorimin e sigurt të kanaleve bankare dhe mbrojtjen kundër kërcënimeve të jashtme në rritje.





DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka luajtur një rol thelbësor në sigurimin e funksionimit efikas dhe të qëndrueshëm të Bankës OTP Albania gjatë vitit 2024. Nëpërmjet përzgjedhjes dhe punësimit të stafit të kualifikuar, trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të tyre, si dhe menaxhimit të performancës, departamenti ka kontribuar ndjeshëm në përmbushjen e objektivave strategjike të bankës.

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të ndërtuar një ambient pune produktiv, gjithëpërfshirës dhe motivues, duke nxitur angazhimin e punonjësve dhe rritjen e performancës organizative.

Aktivitetet kryesore të departamentit janë përqendruar në pesë fusha strategjike:

- Rekrutimi dhe Promovimi
- Zhvillimi i Punonjësve
- Angazhimi dhe Motivimi
- Employer Branding
- Vlerësimi i Performancës dhe Zhvillimi I Karrierës

Rekrutimi

Procesi i rekrutimit në Bankën OTP Albania mbetet një komponent thelbësor për sigurimin e burimeve njerëzore të kualifikuara dhe të përshtatshme për të përballuar sfidat në zhvillim të tregut bankar. Gjatë vitit 2024, Sektori i Rekrutimit dhe Menaxhimit të Talenteve ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në identifikimin, intervistimin, përzgjedhjen dhe promovimin e kandidatëve potencialë, duke ndjekur një proces të drejtë, transparent dhe të bazuar në meritë. Ky angazhim përbën një themel të rëndësishëm për suksesin, integritetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të bankës.

Në përputhje me kulturën e brendshme të zhvillimit dhe përkushtimin ndaj rritjes së vazhdueshme profesionale, gjatë vitit 2024 u vendos një fokus i veçantë në promovimin e punonjësve të brendshëm. Si rezultat, 92 punonjës u promovuan në pozicione të reja brenda bankës, duke mundësuar:

- Ruajtjen dhe zhvillimin e njohurive institucionale
- Përmirësimin e klimës organizative
- Përgatitjen e stafit për sfida të reja
- Rritjen e kapaciteteve për përmbushjen e objektivave strategjike

Për më tepër, nëpërmjet programit të praktikës për studentët e sapodiplomuar, Banka OTP Albania ka ofruar mundësi reale për përfshirje në ambientin profesional bankar. Ky program synon të identifikojë dhe zhvillojë talentet e reja, duke kontribuar në formimin e brezit të ardhshëm të bankierëve dhe promovimin e sektorit bankar si një drejtim tërheqës për karrierën.

Statistika:

Total Staf	721	
HO	388	54%
Net	333	46%
Femra	508	70%
Meshkuj	213	30%

Mosha mesatare e punonjësve të Bankës OTP Albania është 37 Vjeç.

Zhvillimi i Punonjësve

Zhvillimi profesional i punonjësve ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet strategjike të Bankës OTP Albania. Duke njohur rëndësinë e investimit në kapitalin njerëzor, si një faktor kyç për suksesin afatgjatë të institucionit që në fillim të vitit 2024, Departamenti i Burimeve Njerëzore hartoi dhe zbatoi një plan gjithëpërfshirës trajnimesh, i cili përfshiu të gjithë punonjësit e bankës.

Ky plan synonte:

- Zhvillimin e aftësive shitëse
- Përmirësimin e kompetencave teknike
- Njohjen dhe përvetësimin e produkteve të reja bankare
- Aftësim ne Soft Skills
- Pajtueshmëri dhe Etikë

Qëllimi kryesor ishte jo vetëm përmirësimi i performancës individuale, por edhe forcimi i kapaciteteve organizative për të përballuar sfidat e tregut modern bankar.

Gjatë vitit 2024, trajnimet janë përqendruar në temat prioritare si:

- Funksionalitetet e reja dhe zhvillimi i produkteve digjitale
- Forcimi i kulturës së riskut dhe analizës financiare
- Integrimi dhe mbështetja e punonjësve të rinj
- Parandalimi i pastrimit të parave
- Përmirësimi i eksperiencës së klientit
- Zhvillimi i kulturës menaxheriale
- Rritja e efikasitetit komercial
- Unifikimi i njohurive mbi sistemet, proceset dhe procedurat e bankës

Ky investim i vazhdueshëm në zhvillimin e stafit synon të sigurojë që çdo punonjës i Bankës OTP Albania të ndjehet i përgatitur, i motivuar dhe i vlerësuar në rrugëtimin e tij profesional.

Të dhënat përmbledhëse të trajnimeve për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	2024
Nr. Total i Orëve të Trajnimit	18,433
Nr. Total i Ditëve të Trajnimit	2,300
Nr. punonjësve të trajnuar të paktën një herë	721
Nr. mesatar i orëve të trajnimit për punonjës	25.6

Angazhimi dhe Motivimi

Punonjësit tanë përbëjnë zemrën e Bankës OTP Albania – ata janë forca lëvizëse që zbatojnë strategjinë dhe e çojnë përpara vizionin tonë. Duke njohur këtë rol thelbësor, gjatë vitit 2024 u angazhuam në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar një ambient pune ku secili punonjës ndjehet i vlerësuar, i përfshirë dhe i motivuar.

Organizuam një sërë aktivitetesh të larmishme, jo vetëm për punonjësit, por edhe për familjet e tyre, me qëllim mbështetjen e pasioneve, ideve dhe dëshirave personale. Këto iniciativa synuan të forcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të nxisin një kulturë bashkëpunimi dhe mirëqenieje të qëndrueshme.

Fryma e bashkëpunimit dhe përkushtimi i secilit anëtar të ekipit u reflektua në një nivel të jashtëzakonshëm angazhimi – ndër më të lartët në të gjithë Grupin OTP në rajon.

Një nga arritjet më të rëndësishme në këtë drejtim ishte prezantimi i Jenz, rrjetit të brendshëm social të Bankës OTP Albania. Ky mjet inovativ ka transformuar mënyrën e komunikimit dhe ndërveprimit të përditshëm mes kolegëve, duke krijuar një hapësirë virtuale ku:

- Promovohen dhe shpërndahen arritjet dhe aktivitetet e brendshme
- Forcohet lidhja ndërpersonale mes punonjësve
- Nxitet përfshirja dhe bashkëpunimi ndërdepartamental
- Rritet motivimi dhe ndjenja e përkatësisë në organizatë
- Jenz është kthyer në një urë lidhëse që pasqyron kulturën tonë të hapur, dinamike dhe të orientuar drejt njerëzve

Employer Branding

Banka OTP Albania i kushton një rëndësi të veçantë ndërtimit dhe forcimit të marrëdhënieve me institucionet e arsimit të lartë dhe me studentët e fakulteteve të ndryshme, duke i konsideruar ata si një burim të çmuar të talenteve të së ardhmes. Këto institucione përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për sigurimin e kandidatëve cilësorë, të cilët mund të bëhen pjesë aktive dhe kontribuese në zhvillimin e mëtejshëm të bankës sonë.

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka qenë i angazhuar në një sërë iniciativash të drejtuara drejt komunitetit akademik, me qëllim afrimin e të rinjve me sektorin bankar dhe promovimin e bankës si një punëdhënës i preferuar. Këto përfshinë:

- Pjesëmarrje aktive në panaire pune të organizuara nga universitete të ndryshme në vend
- Zhvillimin e leksioneve të hapura me tematika bashkëkohore dhe me interes për studentët, si siguria kibernetike dhe digjitalizimi i sistemit bankar në Shqipëri
- Promovimin e programeve të praktikës dhe mundësive të karrierës për të rinjtë e talentuar

Këto angazhime kanë shërbyer jo vetëm për të identifikuar dhe tërhequr talente të reja, por edhe për të ndërtuar një imazh të qëndrueshëm dhe të besueshëm të Bankës OTP Albania si një institucion që investon në zhvillimin profesional të brezit të ardhshëm të profesionistëve.

Vlerësimi i Performancës

Vlerësimi i performancës përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm për të siguruar përputhjen ndërmjet objektivave individuale dhe atyre organizative, duke mundësuar zhvillimin profesional të punonjësve dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimit në Bankën OTP Albania. Përveç vlerësimit vjetor të performancës, gjatë vitit 2024 u implementua për herë të parë procesi i Vlerësimit Pjesor të Performancës, një risi që u mirëprit gjerësisht nga të gjitha departamentet dhe rrjeti i degëve. Ky proces synon të:

- Sigurojë feedback të vazhdueshëm nga menaxherët për stafin
- Forcojë komunikimin e hapur dhe të ndershëm mes punonjësve dhe drejtuesve
- Krijojë një kulturë të qëndrueshme të zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm
- Nxisë marrëdhënie pozitive dhe bashkëpunuese brenda ekipeve

Kjo qasje e re ka ndihmuar në ndërtimin e një ambienti pune më të angazhuar dhe më të orientuar drejt objektivave të përbashkëta.

Zhvillimi i Karrierës – Projekti "Career Growth"

Në kuadër të përkushtimit për të ndërtuar një kulturë zhvillimi të qëndrueshëm dhe të personalizuar për çdo punonjës, gjatë vitit 2024 u lançua projekti "Career Growth" – një iniciativë strategjike që vendosi në qendër të vëmendjes potencialin dhe aspiratat individuale të stafit. Ky projekt synoi të:

- Identifikojë pritshmëritë e punonjësve në lidhje me zhvillimin e tyre profesional dhe rrugëtimin e karrierës
- Fasilitojë dialogun e hapur midis punonjësve dhe menaxherëve për të ndërtuar plane zhvillimi të qarta dhe të matshme
- Krijojë mundësi reale për avancim, përmes trajnimeve të synuara, mentorimit dhe përfshirjes në projekte ndërfunksionale
- Rrisë angazhimin dhe kënaqësinë në punë, duke i dhënë secilit punonjës ndjesinë se është pjesë e një organizate që investon në të ardhmen e tij

Nëpërmjet "Career Growth", u hartuan plane individuale zhvillimi për një numër të konsiderueshëm punonjësish të cilat përfshijnë objektiva afatshkurtër dhe afatgjatë, si dhe hapa konkretë për arritjen e tyre. Këto plane janë të integruara me procesin e vlerësimit të performancës dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje në promovime, trajnime dhe lëvizje të brendshme.

Projekti ka kontribuar në rritjen e transparencës në menaxhimin e karrierës dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet stafit dhe menaxhimit të bankës.

Politika e Shpërblimeve

Në Bankën OTP Albania, politika e shpërblimeve është ndërtuar për të nxitur performancën, për të përforcuar kulturën e rezultateve dhe për të siguruar një sistem të drejtë dhe të motivues për të gjithë punonjësit. Qëllimi kryesor i kësaj skeme është arritja e objektivave të vendosura dhe rritja e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve, duke kontribuar në suksesin e përgjithshëm të bankës.

Të gjithë punonjësit janë pjesë e një skeme shpërblimi të përcaktuar sipas pozicionit të tyre. Çdo punonjës mund të përfshihet vetëm në një skemë shpërblimi në të njëjtën kohë.

Struktura e Shpërblimeve
Politika e shpërblimeve përbëhet nga tre komponentë kryesorë:

1. Paga Bazë (Fikse)
2. Paga Variabël (Bonuse)
3. Përfitime të Tjera

Paga Bazë (Fikse)

Paga bazë përfaqëson të ardhurat bruto të punonjësit, përjashtuar përfitimet dhe bonuset. Ajo përcaktohet në bazë të:

- ✓ Përgjegjësive dhe aftësive të kërkuara për pozicionin
- ✓ Ruajtjes së konkurrueshmërisë në treg
- ✓ Eksperiencës së punonjësit
- ✓ Strukturës së gradës përkatëse

Rritja e pagës bazë lidhet me:

- ✓ Performancën individuale
- ✓ Pozicionimin e pagës brenda gradës përkatëse
- ✓ Buxhetin vjetor të përcaktuar për rritje
- ✓ Promovimin në një rol me përgjegjësi më të lartë
- ✓ Kohën e kaluar nga rritja e fundit

Pagat për Bordin e Menaxhimit përcaktohen sipas politikave të Grupit OTP Bank.

Paga Variabël (Bonuse)

Paga variabël është e lidhur ngushtë me performancën vjetore dhe rezultatet e arritura. Ajo përfshin:

- ✓ Bonuse tremujore për forcën shitëse, bazuar në rezultatet e shitjeve
- ✓ Bonuse vjetore për stafin mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme, në përputhje me performancën dhe buxhetin e miratuar
- ✓ Bonuse për drejtuesit ekzekutivë dhe pozicione të tjera kyçe, të përcaktuara sipas politikave të Grupit OTP Bank dhe të lidhura me objektiva specifikë dhe përqindje të paracaktuara.

Këshilli Drejtues shpërblehet me një pagesë fikse mujore.

Përfitime të Tjera

Përfitimet shtesë përfshijnë elementë monetarë dhe jo-monetarë që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e punonjësve, si:

- ✓ Shpërblim për leje lindjeje
- ✓ Kontroll mjekësor periodik
- ✓ Norma preferenciale për produktet e kredisë
- ✓ Paketa telefonie
- ✓ Aktivitete Team Building
- ✓ Ditë shtesë leje për vjetërsinë dhe pozicionin
- ✓ Kontribut në Fondin Vullnetar të Pensionit Privat
- ✓ Dhurata për fëmijët me rastin e festave

Kjo politikë e balancuar shpërblimi synon të krijojë një ambient pune të drejtë, motivues dhe të qëndrueshëm, ku çdo punonjës ndjehet i vlerësuar për kontributin e tij.

Format dhe elementet e shpërblimit për Drejtues Ekzekutiv (çdo fund viti)
(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar pagesave dhe shpërblimeve për vitin fiskal	E menjëhereshme /për periudhën aktuale 2024	Për periudha të kaluara 2023
Elemente te pandryshueshëm të shpërblimit	220,340	157,009
Cash/ bonus	220,340	157,009
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshem të shpërblimit	60,758	32,613
Cash/bonus	15,469	
Aksione		
Të tjera	45,289	32,613

Format dhe elementet e shpërblimit për Këshillin Drejtues (çdo fund viti)(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar pagesave dhe shpërblimeve për vitin fiskal	E menjëhereshme /për periudhën aktuale 2024	Për periudha të kaluara 2023
Elemente te pandryshueshëm të shpërblimit	8,062	7,254
Cash/ bonus	8,062	7,254
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshem të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		





PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Donacione për familjet në nevojë në bashkëpunim me fshatrat SOS

Stafi i Bankës OTP Albania angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në mbështetje të shtresave në nevojë. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, u arrit të grumbullohej një sasi e konsiderueshme donacionesh përmes kutive të gjelbra të vendosura në godinën e zyrave qëndrore të saj.


Të gjithë donacionet që u mblodhën (veshmbathje dhe lodra për fëmijë) u paketuan dhe u dorëzuan për shpërndarje të personave më në nevojë. Ky akt dhurimi erdhi si një bashkëpunim me Fshatrat SOS, i cili do të vijojë edhe më tej.



Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, 2025

Në datat 24-26 Prill, 2024 u zhvillua Panairi Ndërkombëtar i Bujqësisë në Shqipëri, 'Agriculture Days, 2024'. Panairi u mbajt për të tretin vit rradhazi në qytetin e Lushnjes, si një pikë kyçe takimi dhe ndërveprimi për aktorët e sektorit të bujqësisë.

Në këtë aktivitet, ndër më të mëdhenjtë në sektorin bujqësor, Banka OTP Albania u përfaqësua me stendën e saj. Ky panair u prezantua sërish si një mundësi e shkëlqyer për Bankën OTP, jo vetëm për të promovuar angazhimin e saj në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë, por edhe për të ndërvepruar me komunitetin lokal dhe liderët e sektorit të bujqësisë.



Mbështetje për një familje në nevoja emergjente, në bashkëpunim me Save the Children

Në kuadër të projekteve të Përgjegjësisë Sociale (CSR) të Bankës OTP Albania, vullnetarët e 'Green Hearts' të Bankës, në bashkëpunim me organizatën 'Save the Children' apeluan për t'i ardhur në ndihmë një familje në emergjencë, të përbërë nga një nënë e vetme me tre fëmijë të mitur.

'Green Hearts' e ka për mision të japë mbështetje për të sjellë një ndryshim, sado i vogël qoftë ai, ndaj dhe përgjigja kundrejt këtij apeli ishte tepër e shpejtë. Me anë të fondeve të mbledhura nga vullnetarët, u arrit që të mblidhet një shumë financiare me anë të cilës u arrit të shlyhen disa detyrime financiare, të cilat bënin të pamundur aplikimin e kësaj familjeje për të vijuar me procedurat e përfitmit nga skema e strehimit social.

Shpërndarja e pakove ushqimore për familjet në nevojë, në bashkëpunim me World Vision

Data 5 Shtator, Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë, frymëzoi dhe bëri së bashku punonjësit e Bankës OTP Albania, për të kontribuar në mirëqënien e anëtarëve më vulnerabël të shoqërisë, në aksionin fisnik për të ndihmuar ata që kanë më tepër nevojë.



Në bashkëpunim me organizatën World Vision, Banka OTP Albania organizoi shpërndarjen e disa pakove ushqimore duke i ardhur në ndihmë 32 familjeve në Tiranë, të cilat përfituan nga kontributet e vullnetarëve.



'Green Hearts' vijon në angazhimin përherë e më të konsoliduar në misionin për një komunitet më të mirë. Vullnetarët e Bankës OTP Albania ecën në hapat dhe veprën e Nënë Terezës, Nobelistes frymëzuese shqiptare, ndaj dhe u përzgjodh pikërisht data 5 shtator, kremtimi i shenjtërimit të saj, për t'i ardhur në ndihmë atyre që kanë më tepër nevojë.

100 vjetori i Spitalit Rajonal "Omer Nishani", Gjirokastër

Në datën 6 qershor, 2024 Banka OTP Albania ishte pjesë e një eventi tepër të rëndësishëm për komunitetin e Gjirokastrës, ceremonia e kremtimit të 100 vjetorit të themelimit të Spitalit Rajonal, 'Omer Nishani.



Për ta bërë sa më të këndshëm këtë event, OTP Bank me shumë kënaqësi ka mbështetur financiarisht aktivitetin.
Bashkëpunimet dhe mbështetja ndaj institucioneve publike shëndetësore kanë si synim promovimin e shëndetit dhe mirëqënies për secilin nga komunitetet, apo rajonet ku OTP Bank Albania është e pranishme.

Maratona e Tiranës në bashkëpunim me Save the Children

Në datën datën 22 tetor 2024, u zhvillua Maratona e Tiranës. OTP Bank Albania në këtë aktivitet iu bashkua Organizatës 'Save the Children', në mbështetje të kauzës 'Vrapo për mirëqënien e fëmijëve'.

Ky edicion gjithashtu kishte një domethënie të veçantë për stafin e bankës, pasi maratonës iu bashkuan edhe kolegët e CKB Bank, të Malit të Zit, anëtare e rrjetit të bankave të Grupit OTP.





Ky përfaqësim i veçantë në nivel ndërkombëtar, sikurse Banka OTP Albania dhe CKB Bank, duke vrapuar si një skuadër e vetme, përcolli përkushtimin dhe frymën e përbashkët sociale të bankave të Grupit OTP, i cili ka një angazhim të lartë në kauzat sociale në mbarë Evropën Qëndrore dhe Lindore.

Dhurimi i Gjakut në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Në datën 15 nëntor 2024, u zhvillua aktiviteti i Dhurimit të Gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.

Humanizmi dhe përkushtimi ndaj kauzave sociale ishte lajtmotivi që bëri bashkë stafin dhe Vullnetarët 'Green Hearts' të OTP Bank Albania, të cilët ishin organizues dhe pjesëmarrës të këtij aktiviteti të rëndësishëm, së bashku me shumë kolegë të tjerë.





Bashkë me gjestin human, secili prej kolegëve që iu bashkua nismës pati mundësinë të shprehë solidarizimin dhe të theksojë mesazhin e një komuniteti të bashkuar që i përgjigjet thirrjes së organizatave humanitare, sikurse Kryqi i Kuq.

Dhurimi i gjakut është një kauzë e cila do të vijojë të mbetet në qendër të aktiviteteve të përgjegjësisë sociale, duke theksuar ndjeshmërinë e lartë ndaj nevojave humanitare dhe shëndetësore.

'Një ditë në Bankë' - Takim me nxënësit e Shkollës TES

Në datën 20 mars, 2024 është organizuar aktiviteti "Një ditë në Bankë", me pjesëmarrjen e fëmijëve të shkollës 9 vjeçare TES – Tomorrow's Education System. Aktiviteti u organizua në Zyrat Qëndrore të Bankës me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm z. Bledar Shella.

Gjatë aktiviteteit, stafi i bankës prezantoi edhe disa prej koncepteve bazë të sektorit bankar për t'u dhënë vizitorëve të vegjël njohuritë fillestare, lidhur me këtë sektor.



Banka OTP Albania ka një kujdes të veçantë në drejtim të edukimit të të vegjëlve dhe të rinjve për sa i përket njohurive financiare si dhe të konceptit të parasë, kjo në linjë edhe me Youth Program.

OTP Bank mbështet Panairin "Work & Study", 2024



Në datat 3-4 prill, 2024 u zhvillua edicioni 16-të i Panairit "Work & Study", i cili tashmë është kthyer në një traditë për promovimin e vlerave dhe mundësive të punësimit.

Banka OTP Albania u përfaqësua me një stendë të kuruar dhe tepër aktive, duke u prezantuar tek të rinjtë e talentuar, si një institucion financiar prestigjioz dhe tërheqës për punësim.

E veçanta në këtë edicion ishte prezantimi i ekspertëve menaxherë të bankës, të cilët bazuar në fushat e tyre të ekspertizës si: burime njerëzore, kanale digjitale, siguria kibernetike, informuan të interesuarit mbi programet e trajnimit, përfitimet e punësimit në Bankën OTP Albania dhe mundësitë për avancimin në karrierë.

Eskpertët trajtuan tema me interes si: *"Kontributi në përmirësimin e infrastrukturës së sigurisë së Informacionit në Bankë", "Monitorimi i përvojës së klientit me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve", si dhe "Mbështetja dhe zhvillimi i funksioneve operacionale, duke kontribuar në performancën e përgjithshme të Bankës."*

Banka OTP Albania ka në fokus punësimin produktiv, duke krijuar një urë lidhëse mes të rinjve dhe programeve të zhvillimit të aftësive.

Takim me fëmijët e kopshtit 'Gogi Kids', Tiranë

Banka OTP Albania e ka ndër misionet e përgjegjësisë sociale promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke nisur që nga moshat e vogla përmes prezantimit të koncepteve bazike financiare.

Në këtë frymë është organizuar në datën 19 korrik, 2024 në mjediset e një nga degëve të OTP Bank në Tiranë, një vizitë e këndshme e fëmijëve të kopshtit privat 'Gogi Kids', Tiranë.





Qëllimi i aktivitetit ishte jo vetëm organizimi i një vizite me karakter edukativo-financiar, por dhe promovimi i një dimensioni të prekshëm të punës në degë, ku theksi vihet në përmbushjen e misionit kryesor: ofrimin e një përvoje ekselente në degë, jo vetëm në nivelin e klientit të zakonshëm, por dhe tek më kuriozët vogëlushë, të cilët do të jenë klientët e së ardhmes apo pjese e sektorit bankar si të punësuar.

Leksioni i hapur me nxënësit e shkollës 'Misto Mame', Tiranë



Në datën 16 tetor, 2024 është organizuar në mjediset e shkollës publike 9-vjeçare 'Misto Mame' aktiviteti 'Open Lecture' në kuadër të edukimit financiar. Leksioni që u mbajt nga një prej drejtuesve e rrjetit të degëve OTP Bank Albania, i cili kishte në fokus historikun sektorit bankar dhe kuriozitete nga nkjo fushë u ndoq me mjaft interes nga nxënësit e pranishëm.

Banka OTP Albania do të vijojë organizimin e aktiviteteve të kësaj natyre, me qëllim shtrirjen në sa më shumë shkolla.

OTP Bank Albania mbështet 'Nehemiah Gateway University', Pogradec

Përveç edukimit financiar, Banka OTP Albania mbështet në mënyrë të vazhdueshme edhe edukimin digjital. Në këtë kontekst është mundësuar gjatë tremujorit të dytë tëvitit 2024, mbështetja për Universitetin 'Nehemiah Gateway', në Pogradec duke mundësuar blerjen e disa pajisjeve kompjuterike për laboratorin e TI.

Kjo mbështetje vjen në kuadër të angazhimit që Banka OTP Albania ka për sigurimin e një edukimi gjithëpërfshirës dhe cilësor, përgjatë gjithë ciklit të arsimimit.

Banka OTP Albania përcjell mesazhin e barazisë gjinore



Data 8 Mars, 2024 Dita Ndërkombëtare e Gruas shënoi në kalendarin e aktiviteteve të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave të Bankës OTP Albania, një aktivitet i cili mbarti një mesazh kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës në mbështetje të barazisë gjinore.

Në kuadër të kësaj dite, së bashku me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit u organizua një aktivitet në të cilin u mbollën 20 pemë të llojit mimozë.

Pema e mimozës u përzgjodh si simbol i fuqisë femërore dhe qëndrueshmërisë së saj, për të sjellë ndryshimin në shoqërinë shqiptare.

Banka OTP Albania mbështet Panairin e Turizmit, 2024

Banka OTP Albania ka mbështetur dhe marrë pjesë në Panairin e Turizmit, 2024 të organizuar në Pallatin e Kongreseve përgjatë datave 31 janar – 1 shkurt, 2024.

Prej vitesh tashmë Banka OTP ka në fokus zhvillimin e infrastrukturës turistike, duke mbështetur në mënyrë të plotë dhe me fleksibilitet të lartë si operatorët në sektorin e eko turizmit, i cili ka marrë zhvillim të vrullshëm në vitet e fundit, ashtu edhe ato në sektorin e turizmit elitar që synojnë zhvillimin e shërbimeve premium.



OTP Bank Albania do të vijojë të marrë pjesë në aktivitete të kësaj natyre për të shprehur partneritetin ndaj operatorëve turistikë si dhe të mbështesë promovimin e turizmit në të gjithë nivelet.

Panairi 'Agro Tech & Natyral Expo'



Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë ka zhvilluar përgjatë datave 16-17-18, maj, 2024, Panairin 'Agro Tech & Natyral Expo'. Ky panair është zhvilluar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Agroturizmit, 16 maj.

Banka OTP mbështeti në këtë aktivitet Bashkinë e Librazhdit, duke mundësuar prezantimin e stendës së kësaj bashkie. Përtej synimit për të përforcuar bashkëpunimin me komunitetin e Librazhdit, panairi ka shërbyer edhe si platformë për promovimin e oportuniteve që ofron OTP Bank Albania përmes produkteve të dedikuara për sektorin e agro-përpunimit.

Panairi i Pasurive të Paluajtshme, "Global Real eXtate"

OTP Bank Albania mbështeti në datat 12-14 Qershor, 2024 edicionin I-rë të Panairit Ndërkombëtar të Pasurive të Paluajtshme, 'Global Real eXtate Fair', në mjediset e Piramidës, Tiranë, duke qenë aktive në përcjelljen tek të gjithë të interesuarit, si individë ashtu edhe biznese nga rajoni dhe Evropa, risitë dhe mundësitë për blerje e partneritete.

Panairi, i cili u organizua nën kujdesin e NAREA, "National Albanian Real Estate Association" theksoi jo vetëm partneritetin mes OTP Bank dhe kësaj shoqate, por edhe ndihmoi në promovimin e produkteve të Kredisë Konsumatore dhe Hipotekore, në një treg të konsoliduar të pasurive të paluajtshme.



'Green Hearts' mbështet Shoqatën 'Korça Alpin'



Në datën 2 nëntor 2024, mbi 30 vullnetarë 'Green Hearts' të Bankës OTP Albania realizuan një nga aktivitetet më energjike të vitit, në bashkëpunim me Shoqatën 'Korça Alpin'.

Të gjithë së bashku vullnetarë e alpinistë, nisën rrugëtimin për në shtegun e bukur 'Udha e Shkronjave', i cili lidh Vithkuqin me Voskopojën.

Ekipi vullnetar i OTP Bank Albania ka ofruar një mbështetje të konsiderueshme financiare për prodhimin e tabelave orientuese, të cilat do të vendosen në vijim përgjatë gjithë shtegut, i cili u markua me sinjalistikë orientuese, në këtë aktivitet nismëtar.

Banka OTP Albania e ka pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë sociale angazhimin vullnetar. Ky aktivitet kishte për synim jo vetëm aspketin e shijimit të natyrës, por mbi të gjitha mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal, përmes turizmit ekologjik dhe të vetqëndrueshëm.

Banka OTP Albania mbështet eventin e organizuar nga FiAA

'Wishes for a Prosperous Year 2024' ishte tema e eventit prestigjioz të organizuar më 31 janar, 2024, nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FiAA), në të cilin mori pjesë edhe OTP Bank Albania me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm, z. Bledar Shella.



Aderimi i Shqipërisë në BE, rezultatet pozitive dhe sfidat e Shqipërisë, mbështetja e vazhdueshme nga biznesi për të zhvilluar komunitetin, etika e të bërit biznes (rule of law) dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor, ishin disa nga temat e trajtuara gjatë takimit ku ishin prezentë figura drejtuese nga trupi diplomatik dhe institucionet publike.

Banka OTP Albania mbështet në vazhdimësi aktivitete të kësaj natyre për të promovuar dhe mbështetur zhvillimet pozitive ekonomike në Shqipëri, në të cilat vetë ajo kontribuon përmes mbështetjes së konsumatorit shqiptar, në sektorin bankar.

Mbështetje e Shërbimit Social Rajonal, Shkodër

Ne tremujorin e fundit të vitit 2024 është akorduar edhe kontributi financiar për Shërbimin Social Rajonal, Shkodër duke ofruar pajisje faciliteti si kondicionerë, në kuadër të transferimit të këtij enti në mjedise të reja shërbimi për publikun.

Duke përmirësuar infrastrukturën e këtij enti publik, OTP Bank Albania kontribuon për një mjedis më të mirë pune dhe shërbimi. Gjithashtu, aksioni mbështet zhvillimin e qëndrueshëm urban, shëndetin dhe mirëqenien, si dhe efikasitetin e shërbimit publik si për stafin, ashtu edhe për komunitetin që merr shërbime.

Mbrëmja Gala e Bamirësisë - Down Syndrome Albania



Në datën 6 prill, 2024 OTP Bank Albania i është bashkuar Organizatës Down Syndrome Albania në Mbrëmjen Gala të Bamirësisë.

Kjo mbrëmje u konceptua jo vetëm si një ceremoni, por edhe si një event, ku pjesëmarrësit dhanë kontributin e tyre në mbështetje të kësaj organizate dhe gjithë punës që bëhet për të trajtuar fëmijët të cilët kanë më shumë nevojë.

OTP Bank Albania mbështet Qendrën Kulturore 'Aleksandër Moisiu', Durrës

Gërshetimi mes brezave, ruajtja dhe transmetimi i vlerave kulturore kombëtare, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për çdo gjeneratë artistësh ka qenë në fokus të aktivitetit 'Durrësi në këngë', i cili u organizua në datën 23 gusht, 2024.



Ky organizim i projektuar nga Qendra Kulturore 'Aleksandër Moisiu', Durrës është mbështetur me shumë kënaqësi nga Banka OTP Albania.

Interpretuesit e këngës së bukur qytetare durrsake, të cilët tashmë kanë hyrë në historinë e muzikës shqiptare, kanë kënduar përkrah të rinjve të talentuar durrsakë, duke përcjellë nostalgjinë muzikore të këtij qyteti.

Spektakli "Verë dhe Portokalle"



Përgjatë datave 13 qershor-15 gusht, 2024 Banka OTP Albania ka qëndruar në krah të spektaklit më të dashur për shikuesin shqiptar, 'Verë dhe Portokalle', si pjesë e një show të mirënjohur, "Portokalli". Spektakli "shëtitës" vizitoi mbi 20 qytete, ndër të cilat nuk munguan dhe pikat më të frekuentuara turistike gjatë verës si: Vlorë, Gjirokastër, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Belsh, Hamallaj, etj.

Aktorët më të dashur të humorit kanë mbajtur peshë publikun, ndërsa si surprizë për stafin pjesëmarrës të Bankës OTP Albania, është mundësuar realizimi i fotove me aktorët e preferuar. Kjo është një mbështetje që Banka OTP Albania jep në kuadër të pasurimit të kulturës dhe artit duke mundësuar që ato të jenë të pranishme kudo dhe të aksesueshme nga çdo komunitet.



Recitali Pianistik 'Franz Liszt'

Në datën 22 tetor, 2024 u zhvillua një aktivitet tepër i veçantë kulturor sikurse Koncerti Pianistik i artistes së mirënjohur Almira e Emiri, i mbajtur në sallën e Liceut 'Jordan Misja'.





Koncerti i organizuar nga Shoqata Shalom 2004, të cilin Banka OTP Albania e mbështeti më shumë kënaqësi, kishte në qendër kremtimin e artit ekselent hungarez përmes veprës së kompozitorit Franz Liszt, të interpretuar mjeshtërisht nga pianistja Almira Emiri, së bashku me vepra të tjera të njohura.

Banka OTP Albania do të mbështesë përherë ekselencën, në të gjithë spektrin artistik, e sidomos ato evente ku ndërthuret historia, dhe kultura mes vendeve të ndryshme sikurse, Hungaria dhe Shqipëria për ta bërë artin sa më universal dhe për ta sjellë pranë artëdashësit.

Mbështetje me bazë materiale e pajisje për institucionet publike

Banka OTP Albania, gjatë vitit 2024 ka dhënë një mbështetjen tepër të vlefshme ndaj institucioneve publike duke dhuruar një sërë materialesh utilitare si mobilje dhe kompjutera, në institucione të disa rretheve të Shqipërisë me qëllimin për të përmirësuar kushtet e punës në veprimtarinë publike, si më poshtë:

- Mbështetje me mobilje për Bashkinë Divjakë
- Mbështetje me mobilje për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Kuçovë
- Mbështetje me mobilje për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Mallakastër
- Mbështetje me mobilje për Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor, D.R.Q Elbasan
- Mbështetje me mobilje për Bashkinë Librazhd (Njësia Administrative Qendër dhe Hotolisht)
- Mbështetje me bazë materiale Pajisje Kompjuterike për Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare Divjakë
- Mbështetje me pajisje zyre për Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Vlorë
- Mbështetje me bazë materiale Pajisje Kompjuterike për Zyrën Vendore Parauniversitare Divjakë
- Mbështetje me bazë materiale Pajisje Kompjuterike për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Mallakastër

Mbjellja e pemëve në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës

Në mbështetje të nismës 'Dhuro një pemë' të Bashkisë Tiranë dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Banka OTP Albania ka blerë dhe dhuruar 20 pemë të llojit mimozë.

Mbjellja e këtyre pemëve është kryer nga stafi i bankës për të përcjellë mes të tjerash edhe mesazhin e ruajtjes dhe zhvillimit të mëtjeshëm të një mjedisi sa më të gjelbër.



Aktiviteti i pastrimit të lumit Buna



Në datën 21 shtator, 2024 u realizua aktiviteti i përgjegjësisë sociale i pastrimit të rrjedhës dhe grykëderdhjes së Lumit Buna. Ky aktivitet erdhi si një bashkëpunim mes dy bankave anëtare të Grupit OTP Bank: OTP Bank e Shqipërisë dhe CKB e Malit të Zi, në kuadër të iniciativave të përbashkëta të gjelbra.

Punonjësve të të dy bankave të cilët morën pjesë vullnetarisht në këtë nismë, u erdhën në mbështetje edhe autoritetet lokale nga të dy anët e kufirit, si nga Bashkia e Shkodrës dhe Ulqinit, ashtu dhe nga Organizata e Administrimit të Peshkimit dhe Policitë respektive Kufitare dhe të Emigracionit.

Ky projekt mjedisor ishte shumë më tepër sesa një aksion pastrimi, duke përfshirë jo vetëm angazhimin e dy bankave simotra të Grupit OTP, por dhe duke shkrirë kufijtë për një kauzë të përbashkët.

Në përfundim të aksionit të pastrimit, të gjithë bashkë arritëm të mblidhnim rreth 300 kg mbeturina, të cilat u grumbulluan në pikat e përcaktuara nga të dy bashkitë e qyteteve të Shkodrës dhe Ulqinit.

Ekspozita e pikturave në Shkollën 'Marie Kaçulini', Durrës

Në mbështetje të projektit të organizatës Save the Children për ndërtimin e 'Kopshteve të Gjelbra' në shkollat publike, Grupi Vullnetar i Bankës OTP Albania ka zgjedhur qytetin e Durrësit dhe shkollën publike 'Marie Kaçulini', për të inicuar këtë aksion të gjelbër dhe në ndihmë të sistemit arismor publik.

Në datën 15 dhjetor 2024, u mundësua organizimi i një ekspozite pikturash nga vetë nxënësit e talentuar të kësaj shkolle, gjatë të cilës u realizua dhe shitje e pikturave për mbledhjen e fondeve fillestare të projektit.





Këto punime tepër kreative do të vijojnë të jenë në shitje në OTP Bank Albania edhe në vijim të vitit 2025, me qëllim kontribuimin me sa më shumë fonde për ngritjen Këndit të Gjelbër të shkollës.

Aktiviteti i Mbjelljes së pemëve në Paskuqan

Në datën 17 dhjetor, 2024 në mbështetje të projekteve të organizatës World Vision për gjelbërimin e mjediseve publike, Vullnetarët 'Green Hearts' të Bankës OTP kanë kontribuar me blerjen dhe mbjelljen e 85 rrënjëve të pemës së llojit Eucalyptus, në zonën e Paskuqanit.

Vijojmë me misionin ndaj përgjegjësisë sociale duke përfshirë edhe më shumë kolegë vullnetarë të stafit të Bankës OTP Albania.



Javës Globale e Parasë

Në kuadër të organizimit të aktivitetit gjithëpërfshirës 'Java Globale e Parasë', organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, Banka OTP Albania ka marrë pjesë në ciklin e leksioneve të hapura organizuar me studentë të interesuar për fushën financiare, sektorin bankar dhe fushave të lidhura me të.

Një nga ekspertët e Bankës OTP Albania, Drejtor i Departamentit të Sigurisë ka mbajtur në datën 26 mars, 2024 një leksion në Universitetin jo publik Marin Barleti, ku ka trajtuar për të pranishmit temën e Sigurisë Kibernetike".



OTP Bank Albania pjesëmarrëse në "ESG Adria Summit", 2024



Banka OTP Albania ka mbështetur dhe marrë pjesë në edicionin e dytë eventin **'ESG Adria Summit'** të mbajtur në Porto Montenegro, Mali i Zi, në datat **24-26 prill, 2024.**

Në zemër të organizimit të këtij edicioni ishte tema: **"Vepro Tani për një të Nesërme të Qëndrueshme" - "Act Now for a Sustainable Tomorrow"**, lidhur me të cilën u mbajtën diskutime që ndërthurën problematikat reale të rajonit, me zgjidhjet praktike që fuqizojnë bizneset, me qëllim vendosjen dhe realizimin e objektivave ESG dhe kërkesat e përputhshmërisë rregullatore.

Banka OTP Albania në vazhdimësi shpreh angazhimin e saj kundrejt parimeve ESG. Ajo bashkëndan këto parime me krenari me të gjithë aktorët, si pjesë e Grupit OTP, i cili është vlerësuar ndërkombëtarisht me çmime për aktivitetin dhe transparencën në fushën e qëndrueshmërisë, duke u kthyer në një partner të besueshëm dhe të përgjegjshëm në Rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore.

Festa e 1 Qershorit në Presidencën e Republikës së Shqipërisë

Zyra e Presidentit të Shqipërisë, organizoi në mjediset e Presidencës në datën **1 qershor, 2024** një aktivitet festiv, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Në qendër të organizimit ishin vogëlushët dhe momentet e tyre argëtuese.



Kësaj feste i është bashkuar edhe Banka OTP Albania, duke kontribuar për organizimin e eventit për të krijuar momente sa më të bukura për të gjithë pjesëmarrësit.

Banka OTP Albania është e përkushtuar në promovimin e shëndetit të fëmijëve, edukimin e tyre dhe barazinë, elementë këta tejet thelbësorë për të siguruar një jetë të qetë e të lumtur.

OTP Bank Albania mbështet Javën Kulturore Hungareze, 2024



Kultura e pasur dhe shpirti intelektual hungarez kanë mbërritur në Shqipëri për të tretin vit radhazi duke qenë pranë artëdashësit shqiptar në datat 2-6 shtator, përmes aktivitetit të Javës Kulturore Hungareze.

Në kuadër të këtij aktiviteti Banka OTP Albania ka ofruar me shumë krenari mbështetjen financiare me dëshirën për të nxjerrë në pah zhvillimin ekonomik, kulturën dhe inovacionin që mishëron kombin hungarez dhe prezencën hungareze në Shqipëri, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve mes dy shteteve.

Java Hungareze e kulturës nisi aktivitetin përmes një ceremonie të mbajtur në mjediset e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës, tek Piramida në mesin e një ekspozite magjepsëse të punimeve në xham të artistes Yvette Botz, ku spikati edhe punimi për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



Në këtë ceremoni ku morën pjesë personalitete, trupi diplomatik hungarez, artistë shqiptarë e hungarezë, si edhe Drejtori i Përgjithshëm i Bankës OTP Albania, z. Bledar Shella, u përcoll mesazhi i forcimit të urave të bashkëpunimit mes dy vendeve dhe kulturave nëpërmjet këtij aktiviteti.

Ekspozita fotografike 'Aromë Hungarie'

Banka OTP Albania pati kënaqësinë dhe nderin të qëndrojë përkrah artit dhe kulturës përmes mbështetjes së organizimit të ekspozitës fotografike **'Aromë Hungarie'**, nga fotografi prestigjioz **z. Roland Tasho**. Kjo ekspozitë u zhvillua përgjatë datave **10-15 dhjetor, 2024**.

Eventi ofroi për të gjithë artdashësit dhe dashamirësit e kulturës hungareze një eksplorim vizual dhe historik, duke dokumentuar ekselencën e arkitekturës hungareze, si dhe aspektet diplomatike shqiptaro-hungareze, në vizitat e fotografit në tri dekada.



Bashkëpunime të tilla me në qendër dy kultura, sikurse ajo shqiptare dhe hungareze nxisin mirëkuptimin e përbashkët, kreativitetin dhe shkëmbimin kultutor duke lidhur entitetet lokale dhe ndërkombëtare.



PËRVOJA E KLIENTIT

PËRVOJA E KLIENTIT

Përkushtimi ndaj klientit është qendra e strategjisë së bankës sonë që prej vitit 2020.

Pas përfundimit me sukses të bashkimit, tani jemi më të përgatitur për të ofruar produkte dhe shërbime të përmirësuara për klientët tanë, në çdo fazë të udhëtimit të përbashkët.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar kërkime të ndryshme për të vlerësuar eksperiencën e tyre në aspekte të ndryshme të shërbimit, efikasitetin e proceseve, funksionalitetin e produkteve dhe komunikimin.

Disa nga studimet më të rëndësishme janë përqendruar në analizimin e faktorëve që i shtyjnë klientët të ndërpresin procesin e aplikimit për kredi, në vlerësimin e përvojës së tyre gjatë përdorimit të shërbimit POS të ofruar nga banka jonë, si dhe në identifikimin e nivelit të njohjes së përfitimeve të produkteve të përfshira në paketat e tyre. Këto analiza na kanë mundësuar përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve tona, duke rritur vlerën e klientëve tanë dhe duke forcuar marrëdhëniet afatgjata.

Përmes platformës On the Spot, ne vazhdojmë të mbledhim reagime të drejtpërdrejta nga klientët, jo vetëm për transaksionet e transfertave në degë, por edhe për ndërveprimet me Qendrën e Kujdesit ndaj Klientit. Norma mesatare e përgjigjeve ka tejkaluar standardet e vendosura, duke arritur 25% dhe duke siguruar një vlerësim të plotë të eksperiencës së klientëve.

Tashmë është kthyer në traditë promovimi dhe shpërblimi i punonjësve të degëve, më të vlerësuar nga klientët.

Për të gjashtin vit radhazi Kantar, kompania ndërkombëtare e kërkimeve ka kryer kërkime të tregut për matjen e kënaqësisë së klientëve, perceptimin e markës OTP dhe pritshmëritë për produktet dhe shërbimet tona.

Indeksi TRiM ka mbetur i qëndrueshëm krahasuar me vitin 2023, pavarësisht impaktit të bashkimit teknik, në dhjetor 2023.

81
otpbank

82
COUNTRY SPECIFIC BENCHMARK

Gjetjet e kërkimeve tregojnë se klientët e mëparshëm të Alpha Bank janë bërë dukshëm më të angazhuar ndaj OTP Bank Albania, të nxitur nga rritja e kënaqësisë dhe forcimi i besnikërisë. Ky ndryshim ka çuar në një balancim më të mirë të performancës midis bazave të klientëve me histori të ndryshme bankare.

Mystery Shopping, një kërkim vjetor cilësor, na mundëson të vlerësojmë performancën e punonjësve në degë. Njohuritë praktike të fituara nga ky studim kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të ofruar.

Tre degët me performancën më të lartë sipas rezultateve të kërkimit, shpallen dhe vlerësohen në Konventën Vjetore të Rrjetit të Degëve.

Ekipi ynë i Trajtimit të Ankesave është i përkushtuar për të adresuar me efikasitet çdo kërkesë dhe ankesë të klientëve. Falë edhe bashkëpunimit me departamente të tjera, kemi mundësuar identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave, duke minimizuar rastet e pakënaqësisë dhe përmirësuar vazhdimisht eksperiencën e klientit.

Gjatë vitit 2024, lançuam Programin e Mentorimit të Rrjetit të Degëve për të forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis kolegëve të degëve dhe atyre në Zyrën Qendrore. Çdo drejtues departamenti është caktuar si mentor për një degë, duke e vizituar rregullisht dhe mbështetur stafin e degës në arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës. Ky program i mundëson drejtuesve të bankës të kuptojnë sfidat operacionale, proceset dhe dinamikën e shitjeve në degë. Raporti i rezultateve nga ky program dhe praktikat më të mira, dërgohen dhe diskutohen në çdo tremujor.

Për të forcuar kulturën e punës së orientuar drejt klientit, është zhvilluar edhe trajnimi i Service Design. Kjo metodologji e re integron parimet dhe etapat e Service Design në proceset bankare, si një teknikë inovative dhe praktike për të krijuar zgjidhje që adresojnë nevojat e klientëve përmes bashkëveprimit të vazhdueshëm. Ky mënyrë pune do të ndihmojë për të zhvilluar produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar, duke rritur avantazhet konkurruese në treg.





INFORMACION I DETAJUAR

BANKA OTP ALBANIA SH.A.

Raporti i audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare në datën dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur ..... **i-ii**
Pasqyra e pozicionit financiar **1**
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse **2**
Pasqyra e ndryshimeve në kapital **3**
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare **4**
1. Të përgjithshme **5**
2. Baza e përgatitjes **5**
3. Deklarata e përputhshmërisë **5**
4. Paraqitja e pasqyrave financiare **5**
5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese **6**
6. Përmbledhje e politikave kontabël **6**
7. Standardet e reja por ende jo efektive **25**
8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël **26**
9. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre **30**
10. Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore **31**
11. Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare **31**
12. Investime në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse **31**
13. Hua dhe paradhënie për klientët, neto **32**
14. Aktive të tjera **38**
15. Aktive afatgjata materiale **39**
16. Aktive me të drejtë përdorimi **40**
17. Aktive afatgjata jo materiale **40**
18. Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore **41**
19. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare **41**
20. Detyrime ndaj klientëve **42**
21. Detyrime të qirasë **43**
22. Detyrime të tjera **44**
23. Borxhi i varur **45**
24. Provizionet për detyrime dhe të tjera **45**
25. Aktive/Detyrime tatimore te shtyra, neto **46**
26. Kapitali aksionar **47**
27. Rezerva **47**
28. Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit **47**
29. Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit **48**
30. Të ardhura nga komisionet **48**
31. Shpenzime për komisionet **48**
32. Rimarrje / (humbje) të pritshme kreditore për aktivet financiare **48**
33. Shpenzimet për personelin **49**
34. (Shpenzime) / rimarrje neto nga provizione të tjera **49**
35. Shpenzime administrative **50**
36. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin **50**
37. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara **51**
38. Transaksionet me palët e lidhura **53**
39. Ngjarjet pas datës së raportimit **54**
40. Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit **55**
41. Administrimi i rrezikut financiar **56-104**

Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K61911012I
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6th floor
1001,Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Banka OTP Albania sh.a.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka OTP Albania sh.a. (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të informacionit të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiare të Bankës më 31 dhjetor 2024 dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2024 të Banka OTP Albania sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2024, përgatitur ne përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë proçedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Bankës të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka OTP Albania sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojme gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

11 prill 2025
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2024

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivet			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	5,983,272	20,547,198
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	10	13,948,090	14,213,819
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	11	1,637,649	894,030
Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	12	28,915,149	27,713,277
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	12.1	15,577,410	10,484,224
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	13	107,145,830	93,413,612
Qiratë financiare të arkëtueshme	13.1	1,763,203	1,540,095
Aktive të tjera	14	1,405,014	1,685,703
Aktive afatgjata materiale	15	4,824,671	4,967,234
Aktive me të drejtë përdorimi	16	1,011,862	1,323,193
Aktive afatgjata jo materiale	17	975,953	392,315
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	18	44,106	113,488
Aktive tatimore të shtyra, neto	25	-	49,772
Totali i aktiveve		**183,232,209**	**177,337,960**
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	19	3,845,818	2,166,715
Detyrime ndaj klientëve	20	147,333,496	148,343,661
Detyrime të qirasë	21	919,110	1,202,301
Detyrime të tjera	22	2,487,046	2,819,846
Borxhi i varur	23	1,066,195	775,526
Provizione për detyrime dhe të tjera	24	285,380	303,292
Detyrime tatimore të shtyra, neto	25	77,262	-
Totali i detyrimeve		**156,014,307**	**155,611,341**
Kapitali			
Kapitali aksionar	26	6,740,900	6,740,900
Primi i lidhur me aksionet		1,750	1,750
Rezervat	27	7,432,759	6,520,246
Fitim i pashpërndarë		13,042,493	8,463,723
Totali i kapitalit		**27,217,902**	**21,726,619**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**183,232,209**	**177,337,960**

Pasqyrat e pozicionit financiar duhen lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në 104, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtuesit e Bankës më 2 prill 2025 dhe janë nënshkruar në emër të saj nga:

Bledar Shella
Drejtor Ekzekutiv

Banka OTP Albania sh.a. Drejtoria e Përgjithshme

Attila Kovacs
Drejtor i Divizionit të Financës

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit	**28**	9,466,903	8,945,985
Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit	**29**	(991,581)	(1,051,413)
Të ardhura neto nga interesat dhe të ngjashme		**8,475,322**	**7,894,572**
Të ardhura nga komisionet	**30**	1,744,632	1,535,037
Shpenzime nga komisionet	**31**	(666,032)	(565,836)
Të ardhura neto nga komisionet		**1,078,600**	**969,201**
Rimarrje të humbjeve të pritshme të kredisë për aktivet financiare	**32**	**116,380**	**229,058**
Fitimi neto nga këmbimi valutor		433,990	333,488
Fitim/(humbja) neto nga shitja e aktiveve financiare VDATGj	**1** **2**	1,915	(38,152)
Humbje neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(13,949)	(51,910)
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të marra në pronësi në rrugë ligjore		164,574	40,801
Të ardhurat/(shpenzimet) e tjera neto		12,596	(8,862)
Të ardhura neto operative		**599,126**	**275,365**
Shpenzimet për personelin	**33**	(1,741,258)	(1,840,431)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	**15**	(244,829)	(196,368)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale	**17**	(236,016)	(155,781)
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	**16**	(301,889)	(325,286)
Shpenzimet administrative	**35**	(1,666,595)	(2,830,885)
(Shpenzime) / rimarrje neto nga provizione të tjera	**34**	(54,760)	67,605
Totali i shpenzimeve operative		**(4,245,347)**	**(5,281,146)**
Fitimi para tatimit		**6,024,081**	**4,087,050**
Tatimi mbi fitimin	**36**	(986,207)	(697,678)
Të ardhura / (shpenzime) tatimore të shtyra	**25**	4,178	(9,831)
Fitimi për vitin		**5,042,052**	**3,379,541**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Elementët që mund të ri klasifikohen më pas në fitim ose humbje:			
Ndryshimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare me VDATGj, neto nga tatimi	**27(iii)**	743,536	1,248,070
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi		**743,536**	**1,248,070**
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi		**5,785,588**	**4,627,611**

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 104, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullatore	Rezerva e vlerës së drejtë	Rezerva e bashkimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	**6,740,900**	**1,750**	**1,293,423**	**(1,187,345)**	**4,757,573**	**5,492,707**	**17,099,008**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Fitimi për vitin	**-**	**-**	**-**	-	**-**	3,379,541	**3,379,541**
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj (Shënimi 27 (iii))	**-**	**-**	**-**	1,248,070	**-**	-	**1,248,070**
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	**1,248,070**	**-**	**3,379,541**	**4,627,611**
Përvetësimi i fitimeve të pashpërndara në rezervën rregullatore (Shënimi 27 (ii))	**-**	**-**	408,525	**-**	**-**	(408,525)	**-**
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**6,740,900**	**1,750**	**1,701,948**	**60,725**	**4,757,573**	**8,463,723**	**21,726,619**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Fitimi për vitin	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	5,042,052	**5,042,052**
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj (Shënimi 27 (iii))	**-**	**-**	**-**	743,536	**-**	-	**743,536**
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	**743,536**	-	**5,042,052**	**5,785,588**
Përvetësimi i fitimeve të pashpërndara në rezervën ligjore (Shënimi 27 (i))	**-**	**-**	168,977	**-**	**-**	(168,977)	**-**
Shpërndarja e dividendit (Shënimi 26)	**-**	**-**	-	**-**	**-**	(294,305)	**(294,305)**
Gjendja më 31 dhjetor 2024	**6,740,900**	**1,750**	**1,870,925**	**804,261**	**4,757,573**	**13,042,493**	**27,217,902**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 104, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë operativ:			
Fitimi para tatimit		**6,024,081**	**4,087,050**
Rregullime në aktivet neto me flukset monetare nga veprimtaritë operative:			
Zhvlerësimi	**15**	244,829	196,368
Amortizimi	**17**	236,016	155,781
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	**16**	301,889	325,286
Rimarrje zhvlerësimi e aktiveve financiare	**32**	(116,380)	(229,058)
Rënie në vlerë mbi aktivet e marra në rrugë ligjore	**18**	-	43,829
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		13,949	51,910
Efekte të tjera rivlerësimi		562,216	423,423
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore		(164,574)	(40,801)
Të ardhura nga interesat	**28**	(9,466,903)	(8,945,985)
Shpenzime nga interesat	**29**	991,581	1,051,413
Fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		**(1,373,296)**	**(2,880,784)**
Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:			
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore		265,729	740,408
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare		(743,619)	(266,278)
Hua dhe paradhënie klientëve		(13,955,326)	6,396,527
Aktive të tjera		280,689	(1,005,334)
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare		1,767,695	(402,376)
Detyrime ndaj klientëve		(1,010,165)	967,169
Detyrime të tjera		(332,800)	945,629
Të ardhura nga shitja e aktiveve të marra në pronësi në rrugë ligjore		276,276	66,359
Interesi i arkëtuar		9,424,200	8,936,473
Interesi i paguar		(1,000,288)	(1,334,873)
Tatim fitimi i paguar		(832,678)	(690,000)
Flukset neto te mjeteve monetare (përdorur)/gjeneruar nga veprimtaritë operative		**(7,233,583)**	**11,472,920**
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese:			
Blerje e aktiveve financiare me VDATGj		(15,764,975)	(7,560,897)
Të ardhurat nga shitja dhe shlyerja e letrave me vlerë të borxhit në VDATGj		9,854,206	6,975,204
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale		(148,509)	(31,398)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(795,428)	(1,762,730)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		8,068	99,113
Flukset neto te mjeteve monetare përdorur për veprimtaritë investuese		**(6,846,638)**	**(2,280,708)**
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese:			
Borxhi i varur		331,578	775,526
Pagesa për shlyerjen e principalit të detyrimeve të qirasë	**21**	(295,710)	(352,428)
Shlyerje e huamarrjeve		(88,592)	(6,066,964)
Pagesë dividendi	**26**	(294,305)	-
Fluksi neto te mjeteve monetare përdorur për veprimtaritë financuese		**(347,029)**	**(5,643,866)**
Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre		**(14,427,250)**	**3,548,346**
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit		**20,547,198**	**17,779,996**
Efekti neto i këmbimit valutor në para dhe ekuivalentët e tyre		(136,676)	(781,144)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	**9**	**5,983,272**	**20,547,198**

Pasqyra e fluksi të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 104, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Banka OTP Albania Sh.a, ("Banka") është një institucion financiar shqiptar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe u licensua nga Banka e Shqipërisë ("Banka Qendrore") më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i muajit Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë". Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. OTP Bank NYRT është mëma përfundimtare e Grupit.

Në datën 1 dhjetor 2022, Banka dhe "Alpha Bank Albania" sh.a." (e njohur edhe si "ABA") u bashkuan ligjërisht duke inkorporuar aktivet dhe detyrimet me Bankën. Përpara bashkimit, Banka dhe ABA ishin nën kontrollin e përbashkët të OTP Bank NYRT duke qenë i njëjti dhe aksioneri i vetëm që nga 18 korrik 2022 kur OTP Bank NYRT bleu ABA-n. Banka dhe aksioneri i ABA miratuan termat dhe kushtet e bashkimit më 1 dhjetor 2022 pas miratimit paraprak rregullator të marrë më 23 nëntor 2022.

Më 31 dhjetor 2024, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 49 degëve të saj (2023: 49 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2024 Banka kishte 748 punonjës (31 dhjetor 2023: 819 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është pranë Kullat Binjake, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2024, Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti i Kontrollit të Bankës përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi Mbikëqyrës	Gabor Kolics	Kryetar
	Orsolya Csilla Kovács	Zëvendëskryetar
	Ilir Ciko	Anëtar
	Stavri Pashko	Anëtar
	Örs Levente Szilágyi	Anëtar
	Armando Duka	Anëtar
	Janos Veres	Anëtar
Komiteti i Auditimit	Stavri Pashko	Kryetar
	Jitka Pantůčková	Anëtar
	Zoltan György Molnar	Anëtar

2. Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGj") të aktiveve financiare që janë matur me vlerën e drejtë dhe aktiveve të marra në pronësi në rrugë ligjore të cilat maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Pasqyrat financiare paraqiten në lekë ("Lek") dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet ndryshe.

Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e vijimësisë, pasi Drejtimi është i kënaqur që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar në vijimësi për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, Drejtimi ka marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni duke përfshirë parashikimet e përfitueshmërisë, kërkesat rregullatore për kapital dhe nevojat për financim. Vlerësimi përfshin gjithashtu shqyrtimin e skenarëve të arsyeshëm të mundshëm ekonomikë dhe ndikimet e tyre të mundshme në rentabilitetin, kapitalin dhe likuiditetin e Bankës dhe shoqërisë mëmë të saj.

3. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

4. Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka paraqet pasqyrën e saj të pozicionit financiar sipas likuiditetit bazuar në synimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të zërit përkatës të pasqyrës financiare. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (aktuale) dhe më shumë se 12 muajve pas datës së raportimit (jo aktuale) është paraqitur në Shënimin 40.

5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese

Standarde të reja dhe te ndryshuara si dhe interpretimet e tyre.

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese të kontabilitetit të SNRF hyjnë në fuqi për periudhën ushtrimore që fillon më 1 janar 2024:

- Klasifikimi i detyrimeve si detyrime afat-shkurtër ose afat-gjata dhe detyrime afat-gjatë me marrëveshje – Ndryshime të SNK 1.
- Detyrimet e qirasë në një shitje ose një rimarrje me qira - Ndryshime të SNRF 16
- Shënime shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnitorit – Ndryshime të SNF 7 dhe SNRF 7.

Asnjë nga këto ndryshime nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Bankës ne 31 dhjetor 2024.

6. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare nga Banka. Për më tepër, Banka zbatoi dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) nga 1 janar 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale' në vend të atyre 'të rëndësishme'. Ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël dhe nuk ndikuan në mënyrë thelbësore në informacionin e politikave kontabël.

(a) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin e datës së raportimit. Fitimi humbja në valutë të huaj nga instrumentet financiare me kosto të amortizuar, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj, të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund vitit.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
USD	94.26	93.94
EUR	98.15	103.88

(c) Interesi

Metoda e normës efektive të interesit

Të ardhurat nga interesi regjistrohen duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) për të gjithë instrumentet financiarë të matur me koston e amortizuar, duke përfshirë qiranë financiare. Të ardhurat nga interesi nga instrumentet e borxhit të mbajtur me VDATGj gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën NEI. Shpenzimet e interesit llogariten gjithashtu duke përdorur metodën NEI për të gjitha detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. NEI është norma që aktualizon saktësisht flukset e ardhshme të parasë përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, në një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

NEI (dhe për këtë arsye, kostoja e amortizuar e aktivit) llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose primin për blerjen, tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e NEI. Banka njeh të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, Banka njeh efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme të ngarkuara në faza të ndryshme dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (përfshirë parapagimet, interesat e penaliteteve dhe gjobat).

Nëse pritshmëritë e flukseve monetare të aktiveve ose detyrimeve financiare me normë fikse rishikohen për arsye të tjera përveç rrezikut të kredisë, atëherë ndryshimet në flukset monetare të ardhshme kontraktuale zbriten me NEI origjinale me një rregullim në vijim në vlerën kontabël. Diferenca nga vlera kontabël e mëparshme regjistrohet si një sistemim pozitiv ose negativ në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar në bilanc me një rritje ose ulje përkatëse në të ardhurat/shpenzimet nga interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Interesi (vazhdim)

Metoda e normës efektive të interesit (vazhdim)

Për instrumentet financiare me normë të ndryshueshme interesi, rivlerësimi periodik i flukseve monetare për të reflektuar lëvizjet në normat e interesit të tregut ndryshojnë gjithashtu normën efektive të interesit, por kur instrumentet financiarë u njohën fillimisht në një shumë të barabartë me principalin, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ndikon ndjeshëm vlerën kontabël të aktivit ose e detyrimit.

Interesa dhe të ardhura/shpenzime të ngjashme

Të ardhurat nga veprimtaritë bankare, duke përfshirë të ardhurat nga hua dhe paradhëniet ndaj klientëve, të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, njihen në fitim ose humbje duke zbatuar NEI në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç aktiveve të zhvlerësuara.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Faza 3' (shiko shënim 6 (i) (v) A), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar NEI në koston e amortizuar neto të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar e rikuperuar (siç përshkruhet në Shënimin 41.b) dhe nuk ka zhvlerësim, Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

Për aktivin financiar të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI) (si në shënimin 41.b), Banka llogarit të ardhura nga interesi duke llogaritur normë interesi efektive e rregulluar për cilësinë e kredisë dhe duke zbatuar atë normë në koston e amortizuar të aktivit financiar. NEI e rregulluar për cilësinë e kredisë është norma e interesit që, në njohjen fillestare, aktualizon flukset monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të aktiveve të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI).

Banka shpalos interesin e paguar për këto aktive financiare si shpenzim interesi, me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në shënimin 28.

Të ardhurat nga interesi të qirasë financiare njihen gjatë afatit të qirasë, duke përdorur metodën e investimit neto (para tatimit), e cila pasqyron një normë periodike konstante kthimi /duke aplikuar normën e nënkuptuar në qira për (i) vlerën kontabël bruto të qirasë të arkëtueshme në Fazën 1 dhe 2 dhe (ii) vlerën kontabël neto të llogarive të arkëtueshme të qirasë në fazën 3 të modelit HPK.

Të ardhurat nga qiratë regjistrohen brenda të ardhurave nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv në fitim ose humbje.

(d) Tarifat dhe komisionet

Banka fiton të ardhura nga komisionet nga gama e gjerë e shërbimeve që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga komisionet njihen në një vlerë që pasqyron shumën të cilën Banka pret të përfitojë në këmbim të ofrimit të shërbimeve. Detyrimet e ekzekutimit, si dhe koha e përmbushjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës nuk përfshijnë detyrime të shumta performuese, siç shpjegohet më tej në Shënimet A dhe B më poshtë.

Kur Banka ofron një shërbim për klientët e saj, vlera faturohet dhe në përgjithësi paguhet menjëherë pas realizimit të një shërbimi të ofruar në një moment të caktuar pergjatë periudhës ose në fund të afatit të kontratës për një shërbim të ofruar përgjatë periudhës.

Banka në përgjithësi ka arritur në përfundimin se ajo është kryesore në marrëveshjet e saj të të ardhurave, sepse zakonisht kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato te klienti.

A. Të ardhura nga komisionet e fituara nga shërbimet e ofruara përgjatë periudhës.

Të ardhurat nga komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhe kohore llogariten gjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhurat nga komisionet, duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e menaxhimit të investimeve dhe tarifat e vendosjes.

B. Të ardhurat nga komisionet për ofrimin e shërbimeve financiare nga realizimi e një veprimi të rëndësishëm.

Tarifat dhe komisionet që rrjedhin nga negocimi ose pjesëmarrja në negocimin e një transaksioni me një palë të tretë, siç janë tarifat dhe shpenzimet e tjera të komisioneve që lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve, njihen në përfundimin e transaksionit përkatës, pra në një moment të caktuar në kohë. Tarifat ose përbërësit e tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas përmbushjes së kritereve përkatëse.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Tarifat dhe komisionet (vazhdim)

C. Të ardhurat nga komisionet që përbëjnë një pjesë integrale të instrumentit financiar korrespondues

Komisionet që Banka konsideron të jenë pjesë përbërëse e instrumenteve financiarë përkatëse përfshijnë komisionet e njohjes së huasë, tarifa për angazhimin e kredisë për kredi që ka gjasa të tërhiqen dhe tarifa të tjera të lidhura me dhënien e kredisë. Njohja e këtyre komisioneve (së bashku me kostot shtesë) përbëjnë një pjesë integrale të instrumenteve financiarë përkatëse dhe njihen si të ardhura nga interesi nëpërmjet një rregullimi në NEI.

Përjashtim bën rasti kur nuk ka gjasa që një kredi të tërhiqet dhe komisionet e angazhimit të huasë njihen në ardhura kur mbaron afati i kredisë. Angazhimet që përfshihen në qëllimin e SNRF 9 (dmth., janë përcaktuar me VDPFH ose janë nën normën e interesit të tregut, ose janë përcaktuar neto) njihen si derivativë dhe regjistrohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(e) Qiraja

Banka vlerëson në fillimin e kontratës nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Kjo do të thotë, nëse kontrata jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të një kompensimi.

i. Banka në cilësinë e qiramarrësit

Kontabiliteti për qiratë nga Banka si qiramarrës.

Banka merr me qira toka, ambiente për zyra, pajisje dhe makina. Qiratë njihen si një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim përkatës në datën në të cilën aktivi i dhënë me qira është i disponueshëm për përdorim nga Banka. Çdo pagesë qiraje ndahet ndërmjet detyrimit dhe kostos financiare. Kostoja financiare ngarkohet në fitimin ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë. Aktivi me të drejtën e përdorimit njihet me kosto dhe zhvlerësohet për periudhën më te shkurtër midis jetës së dobishme të aktivit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Detyrimet që rrjedhin nga një qira matën fillimisht në bazë të vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- pagesat fikse (përfshirë pagesat që në thelb janë fikse), pa përfshirë stimujt e qirasë që priten të merren;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë;
- shumat që priten për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë;
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiradhënësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, dhe
- pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse periudha e qirasë pasqyron ushtrimin e këtij opsioni nga qiradhënësi.

Pagesat e qirasë skontohen duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet, përdoret norma rritëse e huamarrjes së qiramarrësit, që është norma që qiradhënësi do të duhej të paguante për të huazuar fondet e nevojshme për të siguruar një pasuri me vlerë të ngjashme, në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte dhe afate të ngjashme. Pagesat nën qira afatgjata të tokës bazuar në vlerën kadastrale të tokës trajtohen si pagesa variabël të qirasë që nuk bazohen në një indeks ose një normë.

Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi do të përfshijë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marrë;
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- kostot e restaurimit

Në përcaktimin e afatit të qirasë, drejtimi i Bankës merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një nxitje ekonomike për të ushtruar një opsion zgjatjeje ose për të mos ushtruar një opsion përfundimi. Opsionet e zgjatjes (ose periudhat pas opsioneve të përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse është e arsyeshme dhe e sigurt se qiraja do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Vlerësimi rishikohet nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm në rrethana që ndikon në këtë vlerësim dhe që është nën kontrollin e qiradhënësit.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Qiraja (vazhdim)

ii. Banka që vepron si qiradhënës

Qiratë në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e një pasurie klasifikohen si qira operacionale. Të ardhurat nga qiraja që rrjedhin regjistrohen në mënyrë lineare gjatë periudhave të qirasë dhe përfshihen në të ardhurat në pasqyrën e fitimit ose humbjes për shkak të natyrës së tyre operative. Kostot fillestare direkt të kryera gjatë negocimit dhe organizimit të një qiraje operative shtohen në vlerën e mbartur të pasurisë së dhënë me qira dhe njihen gjatë periudhës së qirasë në të njëjtën mënyrë si të ardhurat nga qiraja. Qiratë të kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën kur ato fitohen. Banka është e ekspozuar ndaj qirave financiare si qiradhënëse dhe politika kontabël është shpalosur në Shënimin 6 (m).

(f) Shpenzimet Operative

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

(g) Përfitimet e punonjësve

(*i) Plani i përcaktuar i kontributeve*

Detyrimet për kontribute në planet e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ato duhet të paguhen. Banka paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të përcaktuar ligjërisht për pensionet në Shqipëri sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitime afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të paskontuara dhe njihen si shpenzime pasi ofrohet shërbimi i lidhur. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet në kuadër të planeve afatshkurtra të bonuseve në para ose ndarjes së fitimit, nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimit të kryer nga punonjësi dhe nëse ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(iii) Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve

Detyrimi neto i Bankës në lidhje me përfitimet afatgjata të punonjësve është shuma e përfitimit të ardhshëm që punonjësit kanë fituar në këmbim të shërbimit të tyre në periudhat aktuale dhe të mëparshme. Ky përfitim skontohet për të përcaktuar vlerën e tij aktuale. Rivlerësimet njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato lindin.
Kredi të lehtësuara iu ofrohen punonjësve me norma interesi preferenciale, ku përfitimi llogaritet si diferencë midis vlerës së drejtë të kredisë, e përcaktuar duke skontuar flukset e pritura të parave me një normë interesi tregu dhe shumës së dhënë punonjësve. Përfitimi njihet si një shpenzim i parapaguar dhe amortizohet në fitimin ose humbjen e periudhës gjatë së cilës punonjësit ofrojnë shërbim, zakonisht në përputhje me afatin e kredisë. (Shënimi 14)

(iv) Përfitimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit

Përfitimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit njihen si shpenzime në kohën më të hershme ndërmjet kohës kur Banka nuk mund të tërheqë më ofertën e këtyre përfitimeve dhe kohës kur Banka njeh kostot për një ristrukturim. Nëse përfitimet nuk pritet të shlyhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohen.

(h) Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Interesi dhe gjobat që lidhen me taksat mbi të ardhurat, te cilat përfshijnë edhe trajtimet e pasigurta tatimore, kontabilizohen sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshme ose të arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet që pasqyron pasigurinë në lidhje me taksat e të ardhurave, nëse ka. Ajo matet duke përdorur tarifat tatimore që janë në fuqi ose janë miratuar në parim duke filluar nga data e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore afatshkurtra netohen vetëm nëse plotësohen disa kritere.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Shpenzimet e tatimit mbi fitimin (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e pozicionit financiar, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar, dhe bazës së tyre tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë ne datën e raportimit. Detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjithë diferencat e përkohshme të tatueshme siç janë ndryshimet në vlerën e drejtë dhe në amortizim.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet. Zbritja tatimore për pagesat e qirasë shpërndahet në zhvlerësimin e të drejtës së përdorimit të aktivit dhe kostos së interesit mbi detyrimin e qirasë. Si rezultat, diferencat e përkohshme lindin me njohjen fillestare të një qiraje të re ku Banka është një qiramarrës.

(i) Instrumentet financiarë

(i) Njohja fillestare dhe matja e mëparshme

Data e njohjes

Aktivet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të huave dhe paradhënieve për klientët dhe tepricat për shkak të klientëve, fillimisht njihen në datën e tregtimit, domethënë data kur Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin tregtimet në mënyrë të rregullt: blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënien e aktiveve brenda afatit kohor të përcaktuar përgjithësisht me rregullore ose me marrëveshje në treg. Hua dhe paradhëniet për klientët njihen kur fondet transferohen në llogaritë e klientëve. Banka njeh vlerën që iu detyrohet klientëve kur fondet transferohen në Bankë.

Matja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe nga modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve, siç përshkruhet në Shënimet 6 (i) (ii) (testimi i modelit të biznesit dhe testimi i VPPI). Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë (siç përcaktohet në Shënimin 6 (i)), përveç në rastin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në VDPFH, kostot e transaksionit shtohen ose zbriten nga kjo shumë. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka llogarit fitimin ose humbjen e Ditës 1, siç përshkruhet më poshtë.

Fitimi ose humbja e Ditës 1

Kur çmimi i transaksionit të instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë në krijimin e tij dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm të dhënat e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njeh diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë, në të ardhurat neto të tregtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga të dhënat nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë zhvlerësohet dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur të dhënat bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivit, të matura me:

- Kosto të amortizuar, siç shpjegohet në Shënimin 6 (i) (iii) A
- VDATGj, siç shpjegohet në Shënimin 6 (i) (iii) C
- VDPFH, siç shpjegohet në Shënimin 6 (i) (iii) D

Banka mund të caktojë instrumente financiarë në VDPFH, nëse kështu eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes, siç shpjegohet në Shënimin 6 (i) (i) D.

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të kredive dhe garancive financiare, maten me metodën e kostos së amortizuar ose VDPFH, në rastet qe mbahen për tregtim dhe si instrumente derivativë ose përcaktohen me vlerë të drejtë, siç shpjegohet në 6 (i) (i) D.

Banka nuk ka instrumente të kapitalit më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet i matur me metodën e kostos së amortizuar, VDATGj ose VDPFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk zbatohet VDPFH:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes për të mbledhur flukse monetare kontraktuale të aktivit
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar krijojnë flukset e mjeteve monetare në datat e përcaktuara të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)

Një aktiv financiar matet me VDATGj vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk zbatohet VDPFH:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes për të mbledhur flukse monetare kontraktuale të aktivit dhe shitjes së tij dhe
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar krijojnë flukse monetare që janë VPPI në data të specifikuara

Vlerësimi i modelit te biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që pasqyron më mirë se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet për çdo instrument, por në një nivel më të lartë të portofoleve të grumbulluara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Mënyra se si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit të biznesit dhe e aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi ndaj personelit drejtues kyç të njësisë ekonomike;
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura në atë model biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato rreziqe;
- Mënyra se si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset monetare kontraktuale të arkëtuara)
- Frekuenca, vlera dhe koha e pritshme e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme në vlerësimin e Bankës.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët e "rastit më të keq" ose "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëria ne fillim, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të krijuara ose të blera rishtas dhe që do vazhdojnë në të ardhmen.

Banka i menaxhon aktivet e veta financiare nën modelin e biznesit "mbajtur për të arkëtuar", përveç letrave me vlerë të cilat menaxhohen nën modelin e biznesit "mbajtur për të arkëtuar dhe shitur".

Testi VPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin VPPI (Vetëm Pagesa Principali dhe Interesi).
'Principali' për qëllimet e këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / zbritjes).

Elementët më të rëndësishëm të interesit brenda një marrëveshjeje huaje janë zakonisht kompensimi për vlerën kohore të parave dhe rreziku i kreditit. Për të bërë vlerësimin e VPPI, Banka zbaton gjykimin dhe e konsideron të rëndësishme faktorë të tillë si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe periudha për të cilën shkalla e interesit është vendosur.

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më shumë se *de Minimis* ndaj rreziqeve ose luhatshmërise në flukset kontraktuale të mjeteve monetare që nuk janë të lidhura me një marrëveshje bazë të huadhënies nuk krijojnë flukse kontraktuale të parasë që janë vetëm pagesat e principalit dhe interesit për shumën e mbetur. Në raste të tilla, pasuria financiare kërkohet të jetë matur në VDPFH.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(iii) Aktivet dhe detyrimet financiare

A – Detyrime ndaj bankave, hua dhe paradhëniet për klientët, investimet financiare me kosto të amortizuar

Banka mat detyrimet nga bankat, hua dhe paradhëniet për klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuar nëse të dyja kushtet e lartpërmendura lidhur me modelin e biznesit dhe testin VPPI plotësohen.

B - Aktivet financiare ose detyrimet financiare të mbajtura për tregtim

Banka klasifikon aktivet financiare ose detyrimet financiare të mbajtura për tregtim kur ato janë blerë ose emetuara kryesisht për qëllime fitimi afatshkurtër përmes aktiviteteve tregtare ose që bëjnë pjesë në një portofol instrumentesh financiare që menaxhohen së bashku, për të cilat ekzistojnë dëshmi të një praktike të fundit të përfitimeve afatshkurtra. Aktivet dhe pasivet të mbajtura për tregtim regjistrohen dhe maten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat neto nga tregtimi. Të ardhurat ose shpenzimet nga interesi dhe dividendët regjistrohen në të ardhurat neto nga tregtimi, në përputhje me kushtet e kontratës ose kur është krijuar e drejta për pagesë. Banka nuk mban asnjë instrument për qëllime tregtimi.

C - Instrumentet e borxhit në VDATGj

Banka zbaton kategorinë e instrumenteve të borxhit të matur në VDATGj kur të dyja kushtet në vijim janë plotësuar:

- Instrumenti është mbajtur brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit arrihet duke mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare;
- Kushtet kontraktuale të aktivit financiar përmbushin testin VPPI.

Instrumentet e borxhit të VDATGj më pas maten me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet që rrjedhin për shkak të ndryshimeve në vlerën e drejtë të njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet në valutë të huaj njihen në fitim ose humbje njësoj si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar siç shpjegohet në Shënimin 6 (i) *(iii)* A. Llogaritja e HPK për Instrumentet e borxhit në VDATGj shpjegohen në Shënimin 6 (i) *(iii)* C. Kur Banka ka më shumë se një investim për të njëjtën letër me vlerë, ato konsiderohen të jetë të realizuara sipas metodës së FIFO. Për çregjistrimin, fitimet kumulative ose humbjet e njohura më parë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë ri klasifikuar nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje.

D- Instrumente financiarë në VDPFH

Banka nuk mban ndonjë aktiv financiar ose ndonjë detyrim financiar që matet me vlerën e drejtë ne fitim ose humbje.

E - Garancitë financiare, letër kreditë dhe angazhimet e huazuara të pa tërhequra

Banka lëshon garanci financiare, letra krediti dhe angazhime për kredi. Garancitë financiare janë fillimisht të njohura në pasqyrat financiare (brenda *Provizioneve*) me vlerën e drejtë, duke qenë se primi është marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën secilën garanci matet në nivelin më të lartë të shumës së njohur fillimisht minus amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe një provizion të HPK siç përcaktohet në Shënimin 34.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në *Të Ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet* në mënyrë lineare gjatë gjithë jetës së garancisë. Angazhimet e huasë dhe letrat e kredive janë angazhime nën të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Banka duhet të ofrojë një hua me kushte të paracaktuara për klientin. Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të kredisë që nuk janë tërhequr, ku kredia e rënë dakord të jepet me kushte tregu, nuk regjistrohen në pasqyrën e gjendjes financiare. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve së bashku me ECL-të përkatëse janë të zbuluara në Shënimin 34.

(iv) Ri- klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka nuk ri-klasifikon aktivet e saj financiare pas njohjes së tyre fillestare, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme në të cilat Banka blen, heq dore ose përfundon një linjë biznesi. Detyrimet financiare nuk ri-klasifikohen kurrë. Banka nuk ka ri-klasifikuar asnjë nga aktivet ose detyrimet e saj financiare në vitin 2024 dhe 2023.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(v) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

A – Çregjistrimi për shkak të modifikimeve të konsiderueshme të kushteve dhe termave

Banka nuk njeh më një aktiv financiar, siç mund të jetë huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë ri-negociuar në atë masë që, në thelb, ajo bëhet një hua e re, me diferencën e njohur në fitim humbje, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Kreditë e reja të njohura klasifikohen në Faza 1 për qëllimet e matjes HPK, përveçse në rastet ku kredia e re konsiderohet POCI.

Gjatë vlerësimit nëse duhet ose jo të çregjistrohet një hua ndaj një klienti, ndër faktorët që Banka merr parasysh janë:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Prezantimin e një tipari kapitali
- Ndryshimi në palën tjetër
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti të mos plotësojë më kriterin e VPPI.

Nëse modifikimi nuk shfaq flukse monetare të cilat janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk shkakton mosnjohje. Bazuar në ndryshimin në flukset monetare të skontuara me NEI origjinale, Banka regjistron një ndryshim ne fitim ose humbje, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende.

Kur ndryshimi i kushteve të një detyrimi financiar ekzistues nuk gjykohet të jetë thelbësor dhe për pasojë, nuk shkakton mosnjohje, kostoja e amortizuar e detyrimit financiar ripërcaktohet duke llogaritur vlerën e drejtë të flukseve të ardhshme kontraktuale monetare që skontohen me NEI origjinale të detyrimit financiar. Çdo diferencë njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Për detyrimet financiare, Banka konsideron se një modifikim është thelbësor bazuar në faktorët kualitativë dhe nëse rezulton në një ndryshim midis vlerës aktuale të skontuar dhe vlerës fillestare të njohur të detyrimit financiar, nëse ai është i barabartë ose më i madh se dhjetë përqind.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(v) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

B – Çregjistrimi në raste të ndryshme nga modifikimi i rëndësishëm

Aktive Financiare

Një aktiv financiar (ose, aty ku është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose një pjese të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) është çregjistruar kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka çregjistron gjithashtu aktivin financiar nëse ka transferuar si aktivin financiar ashtu edhe rrezikun dhe përfitimet përkatëse, dhe ky transferim plotëson kushtet për çregjistrim.

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Banka mban të drejtat mbi flukset monetare, por ka marrë përsipër një detyrim për të transferuar të gjitha flukset monetare të marra, pa vonesë të konsiderueshme, te një palë e tretë në kuadër të një marrëveshjeje të tipit "*kalimtare*".

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ('aktivi origjinal'), por merr një detyrim kontraktual për t'i paguar këto flukse monetare në një ose më shumë ('marrësit e mundshëm'), kur të gjitha tri kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim për të paguar shumat për përfituesit eventual, përveç nëse ka mbledhur shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën e rimbursimit të plotë të shumës së huazuar plus interesit të përllogaritur në normat e tregut;
- Banka nuk mund të shesë ose të përdorë si kolateral aktivin origjinal, përveçse si garanci ndaj përfituesve përfundimtarë;
- Banka duhet të transferojë çdo fluks monetar që mbledh në emër të përfituesve përfundimtarë pa ndonjë vonesë të konsiderueshme.

Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë të ri-investojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së mbledhjes dhe datës së dërgesës së kërkuar për marrësit.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; ose
- Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka konsideron se kontrolli transferohet nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e vet tek një palë e tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa imponuar kufizimet shtesë mbi transferimin.

Kur Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka ruajtur kontrollin, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën që banka përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka gjithashtu njeh një detyrim shoqërues. Aktivi i transferuar dhe detyrimi shoqërues maten në një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet në nivelin më të ulët të shumës origjinale kontabël të aktivit dhe shumës maksimale të konsideratës që Bankës mund t'i kërkohet të paguajë.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni me shkrim ose të blerë (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet në vlerën që Banka do të duhej të paguante në rast të blerjes përsëri. Në rastin e një opsioni të vënë me shkrim mbi një aktiv që matet me vlerën e drejtë, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë kufizohet në vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë të aktivizuar të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(v) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

B – Çregjistrimi në raste të ndryshme nga modifikimi i rëndësishëm (vazhdim)

Detyrimet Financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi nën këtë detyrim është përmbushur, anuluar ose i mbaron afati. Kur një pasiv financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër, nga i njëjti huadhënës, me kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar thelbësisht, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

(vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

A – Përmbledhje e parimeve të HPK

Banka njeh humbje të zbritshme për HPK për instrumentet e mëposhtëm financiar të cilët nuk maten me VDPFH.

- Aktivet financiare të cilat janë instrumente të borxhit;
- Të arkëtueshme nga qiratë;
- Kontratat për garancitë financiare të dhëna;
- Angazhimet e huave të dhëna.

Nuk njihen humbjet nga zhvlerësimi për investimet në kapital pasi ato do te maten me vlerën e drejtë. Nuk ka investime në kapital gjatë viteve 2024 dhe 2023.

Banka mat humbjen nga zhvlerësimi me një vlerë të barabartë me HPK, përgjatë jetës së aktivit me përjashtim të rasteve të mëposhtme, të cilat maten me HPK 12 mujore: (12mHPK):

- Letra me vlerë te investimit të borxhit të cilat vlerësohen të kenë një rrezik te ulët kredie ne datën e raportimit.

- Hua ndaj klientëve dhe instrumente të tjerë financiarë, për te cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm nga momenti i njohjes së tyre fillestare (shiko shënimin 41 b).

Banka vlerëson se një letër me vlerë e investimit të borxhit ka rrezik të ulët kredie ne momentin kur vlerësimi i rrezikut të kredisë i saj është ekuivalent me përkufizimin e pranuar gjerësisht të "nivelit të investimit". Banka nuk e aplikon përjashtimin e rrezikut të ulët të kredisë për ndonjë nga instrumentet e tjerë financiare.

HPK 12 mujore është pjesa e HPK përgjatë jetës së aktivit që përfaqëson HPK-në që rezultojnë nga ngjarjet e paracaktuara për një financim instrument që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Të dy HPK-të (12 mujore dhe përgjatë jetës së aktiviti) llogariten qoftë në baza individuale ose në bazë kolektive, në varës të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare. Politika e Bankës për grupimin e mjeteve financiare të matur në një bazë kolektive është shpjeguar në Shënimin 41 (b) *(iii)*.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku i kredisë të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e parazgjedhjes që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumenti financiar. Kjo shpjegohet më tej në Shënimin 41 (b) *(iii)*.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka i grupon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2 dhe Fazën 3, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeh një provizion të bazuar në HPK 12 mujore. Faza 1 e ekspozimit të kredive gjithashtu përfshijnë objektet ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është ri-klasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një provizion për humbjen për HPK-në përgjatë jetës së aktivit. Kreditë e fazës 2 gjithashtu përfshijnë objekte, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia ka qenë ri-klasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: Ekspozimet e kredive që konsiderohen të zhvlerësuara në mënyrë të konsiderueshme. Banka regjistron një kompensim për HPK-në përgjatë jetës së aktivit. Shënimi 41 (b) *(i)*.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

B – Llogaritja e HPK-ve

Banka llogarit HPK- bazuar në tre skenarë të peshuar sipas probabilitetit për të matur mungesat e pritura të flukseve monetare, të skontuara me një përafrim të NEI (normën e interesit efektiv). Një mungesë monetare është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që duhen paguar nga një njësi ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që njësia ekonomike pret të marrë.

Mekanika e llogaritjeve të HPK-ve është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PM - *Probabiliteti i Mospagimit* është një vlerësim i mundësisë së mos pagesës gjatë një periudhe të caktuar kohore. Një mos pagesë mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar, nëse objekti nuk është çregjistruar më parë dhe është ende në portofol. Koncepti i PM-ve sqarohet më tej në Shënimin 41 (b) *(ii)* dhe *(iv)*.
- EM - *Ekspozimi në rast Mospagimi* është një vlerësim i ekspozimit të një dështimi të ardhshëm, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozimin pas datës së raportimit, duke përfshirë ri-pagesat e principalit dhe të interesit, nëse është planifikuar me kontratë ose jo, tërheqjet e pritshme në objektet e zotuara dhe interesat e përllogaritur nga pagesat e humbura. EM është shpjeguar më tej në Shënimin 41 (b) *(iii)*.
- HM - *Humbja në rast Mospagimi* është një vlerësim i humbjes që lind në rastet kur kemi një mos pagesë në një kohë të caktuar. Ai bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale që duhen marrë dhe atyre që huadhënësi pritet të marrë, duke përfshirë edhe ato qe janë realizuar nga çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e EM. HM shpjegohet më tej në Shënimin 41 (b) *(v)*.

Kur vlerëson HPK, Banka shqyrton tre skenarë, një optimist, një skenar bazë dhe atë pesimist. Secili prej tyre është lidhur me PM-të e ndryshme, EM-të dhe HM-të, siç përcaktohet në Shënimin 6 (i) E. Kur është e përshtatshme, vlerësimi i skenarëve të shumëfishta përfshijnë edhe mënyrën se si kreditë e papaguara pritet të mbulohen, duke përfshirë probabilitetin që kreditë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose vlera që mund të merret nga shitja e aktivit.

Me përjashtim të kartave te kreditit dhe kredive të tjera afatshkurtra përsëritëse, për të cilat trajtimi është përcaktuar veçmas në Shënimin 6 (i) periudha maksimale për të cilën janë përcaktuar humbjet e kredisë është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore ta kërkojë më herët.

Humbjet nga zhvlerësimi dhe rimarrjet janë kontabilizuar dhe shpjeguar veçmas nga humbjet ose fitimet nga modifikimi, që janë kontabilizuar si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar.

Metoda HPK është përmbledhur më poshtë:

- Faza 1: HPK 12 mujore llogaritet si pjesë e HPK- së përgjatë jetës së aktivit, që përfaqësojnë HPK-të që përfaqëson nga ngjarja e mos pagesës për një instrument financiar dhe që janë të mundshme 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit provizionin 12 mujor HPK bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabiliteti mospagimi të pritshme 12 mujore zbatohen në një ED të parashikuar dhe shumëzohen me HM-në e pritshme dhe skontohet nga një NEI i përafërt me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç u shpjegua më sipër.
- Faza 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një provizion për HPK përgjatë jetës së aktivit. Mënyra është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumëfishtë, por PM-të dhe HM-të vlerësohen gjatë jetës së instrumentit. Mungesat e pritshme monetare janë skontuar nga një NEI e përafërt me origjinalen.
- Faza 3: Për kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara (siç përcaktohet në Shënimin 41 (b) (i)), Banka njeh humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre për këto kredi.
- POCI: Aktivi financiar i zhvlerësuar që në blerje ose në krijim është aktiv financiar që janë të zhvlerësuara në njohjen fillestare. Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në HPK-në gjatë jetës, që nga njohja fillestare, të skontuara me normën e interesit efektiv të rregulluar.
- Angazhimet e kredisë dhe letër kreditë: Gjatë vlerësimit të 12m HPK ose HPK-ve përgjatë gjithë jetës për angazhime të huazuara, Banka vlerëson pjesën e pritshme të angazhimit të huasë që do të tërhiqet gjatë jetës së tij të pritshme. HPK bazohet më pas në vlerën aktuale të mungesave të pritura në flukset monetare nëse huaja tërhiqet. Mungesat e pritura në flukset monetare skontohen me një përafrim të normës efektive të interesit të pritshme të huasë.

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

B – Llogaritja e HPK-ve (vazhdim)

Për kreditë e përsëritshme që përfshijnë si hua dhe angazhimet e pa-tërhequr, HPK- të llogariten dhe paraqiten së bashku me huanë. Për angazhimet e kredisë dhe letër kreditë, HPK-të njihen brenda provizioneve.

- Kontratat e garancisë financiare: Detyrimi i Bankës për secilën garanci matet me vlerën më të lartë midis shumës së njohur fillimisht të zvogëluar me amortizimin kumulativ të njohur në rezultatet e aktivitetit dhe provizionit të HPK-së. Për këtë qëllim, Banka vlerëson HPK-në bazuar në vlerën aktuale të pagesave të pritura për të kompensuar mbajtësin për humbjen nga kredia që ajo pëson. Mungesat skontohen nga norma e interesit e rregulluar sipas riskut që lidhet me ekspozimin. Llogaritja bëhet duke përdorur një ponderim probabiliteti të tre skenarëve. HPK-ja që lidhet me kontratat e garancisë financiare njihet brenda Provizioneve.

C – Instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë përmes Të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (ATGj).

HPK për instrumentet e borxhit të matur në VDATGj nuk e zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, i cili mbetet në vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me shpenzimin që do të lindte nëse aktivi mateshin me koston e amortizuar, njihet në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si një vlerë e akumuluar e zhvlerësimit, me një vlerë përkatëse në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është ricikluar në fitim dhe humbje në momentin e heqjes së aktiveve nga pasqyrat financiare.

D - Aktiv financiar i zhvlerësuar që në blerje ose në krijim (POCI)

Për aktivet financiare POCI, Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në HPK përgjatë gjithë jetës së aktivit që nga njohja fillestare e provizioneve të humbjes.

E – Kartat e kreditit dhe kreditë të tjera të rinovueshme.

Produktet e Bankës ofrojnë lehtësira për tejkalim (overdraft) për klientë individualë dhe karta krediti, ku Banka ka të drejtën të anulojë dhe/ose të ulë linjat me një njoftim paraprak prej një dite. Banka nuk kufizon ekspozimin e saj ndaj humbjeve kreditore në njoftimin kontraktues por në vend të saj llogarit HPK-në për një periudhë që reflekton pritshmeritë e Bankës për sjelljen e klientit, gjasat e vonesës dhe procedurat e Bankës për zbutjen e rrezikut të ardhshëm, të cilat mund të përfshijnë reduktimin ose anulimin e paradhënies. Bazuar në përvojën e kaluar dhe pritshmerinë e Bankës, periudha gjatë së cilës Banka llogarit HPK-të për këto produkte, është shtatë vjet për klientët individë.

Vlerësimi i vazhdueshëm nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë për kreditë përsëritëse është e ngjashme për produktet e tjera të kredi dhënies. Kjo bazohet në ndryshimet në vlerësimin e brendshëm të kreditit të klientit, por gjithashtu i jepet rëndësi më e madhe faktorëve cilësorë, të tillë si ndryshimet në mënyrën e përdorimit.

F– Informacione të parashikuara

Në modelet e saj për HPK-të, Banka mbështetet në një gamë të gjerë informacioni parashikues si të dhënat ekonomike, të tilla si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së)
- Normat e papunësisë
- Normat bazë të Bankës Qendrore
- Indeksi i çmimeve të konsumit

Banka ndërthur informacione të parashikuara në matjet e HPK. Banka ka identifikuar dhe dokumentuar indikatorë kyç të rrezikut të kredisë dhe humbjes së kredisë për secilin nga portofolët e investimeve financiare, dhe duke analizuar të dhënat historike, ka përllogaritur marrëdhënien midis rritjes së PBB-së dhe humbjeve kreditore.

Të dhënat dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HPK-ve mundet që jo gjithmonë të kapin të gjitha karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për ta pasqyruar këtë, rregullimet cilësore ose mbivendosjet bëhen herë pas here si rregullime të përkohshme kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale. Informata të detajuara në lidhje me këto të dhëna dhe analizat e ndjeshmërisë janë dhënë në Shënimin 41 (b) (xi).

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(vii) *Vlerësimi i kolateralit*

Për të zbutur rreziqet e saj të kredisë mbi aktivet financiare, Banka kërkon të përdorë kolateralin, kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme, siç janë mjetet monetare, letrat me vlerë, letër kreditë / garancitë, pasuritë e paluajtshme, të arkëtueshmet, inventarët, të tjera pasuri jo-financiare dhe përmirësimet e kredisë si marrëveshjet e rrjetëzimit. Të ardhurat nga shitja e kolateraleve të caktuara në Bankë përmes marrëveshjeve të saj të kredisë përdoren si një nga skenarët e mundshëm për qëllime të llogaritjes së HPK-së. Kolaterali, përveç nëse është i riposeduar, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

Megjithatë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e HPK-së. Përgjithësisht vlerësohet në minimum, në fillim dhe ri-vlerësohet në baza trevjeçare. Megjithatë, disa kolaterale, për shembull, para ose letra me vlerë që lidhen me kërkesat e mbulimit, vlerësohen çdo ditë. Detajet e ndikimit të përmirësimeve të ndryshme të kredisë të Bankës dhe ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit sipas klasës së aktivit financiar janë të shpalosur në Shënimin 41 (b) (xi) *Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kreditit*. Ato gjithashtu tregojnë vlerën totale të drejtë të kolateralit, çdo kolateral të tepërt (shtrirjen në të cilën vlera e drejtë e kolateralit të mbajtur është më e madhe se ekspozimi për të cilin lidhet), dhe ekspozimin neto ndaj rrezikut të kredisë.

Për aq sa është e mundur, Banka përdor të dhëna aktive të tregut për vlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura si kolateral. Të tjera aktive financiare të cilat nuk kanë vlera të tregut të përcaktuar lehtë vlerësohen duke përdorur modele. Kolateral jo-financiar, të tillë si pasuri e patundshme, vlerësohet në bazë të të dhënave të ofruara nga palë të treta, si vlerësimi i jashtëm i pavarur.

(viii) Fshirjet nga bilanci

Aktivet financiare fshihen apo çregjistrohen pjesërisht ose tërësisht, vetëm kur Banka nuk ka asnjë pritje të arsyeshme për të rimarrë një pasuri financiare në tërësinë e saj ose një pjesë të tij. Nëse shuma që do të fshihet është më e madhe se rezerva e akumuluar për humbjet, diferenca trajtohet fillimisht si një shtesë në rezervë, e cila më pas aplikohet kundrejt shumës bruto të mbajtur. Çdo rimarrje e mëvonshme kreditohet në shpenzimet e humbjes së kredisë.

(ix) Kreditë e ri- negociuara dhe modifikuara

Banka ndonjëherë bën lehtësime modifikime të kushteve origjinale të kredive si përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend që të marrë në zotërim kolateralin ose të ushtrojë masa të tjera për mbledhjen e tij.

Banka e konsideron një kredi si të ristrukturuar (*forborne*) kur lehtësimet ose modifikimet përkatëse ofrohen si rezultat i vështirësive aktuale ose të pritshme financiare të huamarrësit, dhe kur Banka nuk do t'i kishte pranuar këto kushte nëse huamarrësi do të kishte qenë në gjendje të mirë financiare. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë shkelje të kushteve kontraktuale, ose shqetësime të konsiderueshme të ngritura nga Departamenti i Rrezikut të Kredisë. Paralajmërimi mund të përfshijë shtrirjen e marrëveshjeve të pagesës dhe marrëveshjen e re për kushtet e huasë.

Pasi të jenë ri-negociuar termat, çdo dëmtim matet duke përdorur NEI origjinale të llogaritur para ndryshimit të termave. Është politika e Bankës për të monitoruar huatë e ri-negociuara për të ndihmuar në sigurimin e pagesave në të ardhmen.

Vendimet e mosnjohjes dhe klasifikimi ndërmjet Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen rast pas rasti. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një hua, ajo është zbuluar dhe menaxhuar si një aktiv i zhvlerësuar dhe i modifikuar i Fazës 3 derisa të mblidhet ose fshihet.

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ix) Kreditë e ri-negociuara dhe modifikuara (vazhdim)

Kur kredia është ri-negocuar ose modifikuar, por nuk është çregjistruar, Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë, siç përcaktohet në Shënimin 41 (b) (vi). Banka gjithashtu konsideron nëse aktivet duhet të klasifikohen si Faza 3. Pasi një aktiv të jetë klasifikuar si i modifikuar, ai do të mbetet në paralajmerim për një periudhë prove 24-mujore minimlisht. Në mënyrë që kredia të ri-klasifikohet nga kategoria e modifikimit, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha objektet e tij duhet të konsiderohen si performuese
- Periudha e provës prej gjashtë muajsh ka kaluar që nga data kur kontrata e kërkuar ishte kryer
- Janë bërë pagesa të rregullta me më shumë se një shumë të parëndësishme të principalit ose interesit të paktën sa gjysma e periudhës së provës
- Konsumatori nuk ka ndonjë kontratë që është më shumë se 30 ditë e pashlyer

(x) Kompensimi

Banka nuk paraqet të netuara aktivet dhe detyrimet ose të ardhurat dhe shpenzimet, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga një SNRF. Përveç kësaj, Banka paraqet në neto fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme, për shembull, fitimet dhe humbjet në valutë. Megjithatë, Banka paraqet fitime dhe humbje të tilla veçmas nëse ato janë materiale.

(xi) Matja e vlerës së drejtë

Parimi i vlerësimit

Vlera e drejtë është çmimi që do të mund të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) me matjen në kushtet aktuale të tregut (d.m.th., një çmim shitje), pavarësisht nëse ai çmim është drejtpërdrejt i vëzhgueshëm ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi. Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare klasifikohen bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit.

Qeverisja e vlerësimit

Metodologjia e vlerës së drejtë të Bankës dhe qeverisja mbi modelet e saj përfshin një sërë kontrollesh dhe procedurash të tjera për të siguruar që janë vendosur masat e duhura mbrojtëse për të siguruar cilësinë dhe përshtatshmërinë e saj. Të gjitha iniciativat e produkteve të reja (përfshirë metodologjitë e tyre të vlerësimit) i nënshtrohen miratimeve nga funksione të ndryshme të Bankës, duke përfshirë funksionet e rrezikut dhe financave. Përgjegjësia e matjeve të vazhdueshme i takon sektorit të biznesit dhe linjës së produktit.

Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve miraton metodat e aplikuara nga OTP Bank Albania për përcaktimin e vlerës së drejtë. *Sektori i Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve* paraqet propozime në lidhje me metodat e aplikuara nga OTP Bank Albania për përcaktimin e vlerës së drejtë në bashkëpunim me Departamentin e Kontabilitetit dhe Financave. Ai përcakton vlerën e drejtë të të gjitha instrumenteve të tregut të parasë dhe kapitalit të tregtuara nga Banka në baza ditore, për aq sa është e mundur, por të paktën një herë në muaj dhe kontrollon vazhdimisht përputhshmërinë e të dhënave të përdorura për qëllime matjeje dhe teknikave të vlerësimit. Nëse zbulon devijime të vazhdueshme, ai fillon një rishikim të të dhënave dhe parimeve të matjes të përdorura për matje. Në përputhje me urdhrat mujore të mbylljes, ajo i përcjell të dhënat e vlerës së drejtë Departamentit të Thesarit dhe Departamentit të Kontabilitetit dhe Financës për përpunim.

Departamenti i Thesarit korrigjon brenda kompetencës së tij ose ka korrigjuar pa vonesë të gjitha mospërputhjet e konstatuara në sistemin analitik dhe njofton personat kompetentë të caktuar në *Sektorin e Menaxhimit te Aktiveve dhe Detyrimeve* dhe në Departamentin e Thesarit në të njëjtën kohë për mospërputhjet e konstatuara në sistemin e mbajtjes së pozicioneve.

Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës kryen kontabilitetin e kërkuar sipas IFRS-së, bazuar në vlerat e drejtë të siguruara.

Departamenti i Thesarit siguron plotësinë e transaksioneve të kryera nga Departamenti i Thesarit në sistemin e mbajtjes së pozicioneve.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(xi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Qeverisja e vlerësimit (vazhdim)

Në rast regjistrimi të pasaktë, kryen korrigjimin(et) e nevojshme në sistemin e mbajtjes së pozicionit dhe njëkohësisht njofton personat kompetentë pranë Departamentit të Thesarit dhe *Sektorin e Menaxhimit te Aktiveve dhe Detyrimeve* për verifikim të përsëritur. Ai jep opinion mbi besueshmërinë e burimeve të të dhënave të përdorura për matje dhe për pajtueshmërinë e parimeve të matjes.

Teknika e vlerësimit

Banka do të përdorë teknika vlerësimi që janë të përshtatshme për rrethanat dhe për të cilat disponohen të dhëna të mjaftueshme.

Teknikat e vlerësimit zakonisht mund të klasifikohen në dy grupe kryesore:
- Qasja e tregut
- Qasja e të ardhurave

Qasja e tregut kryesisht përdor çmimet dhe informacione të tjera përkatëse të krijuara nga transaksionet e tregut që përfshijnë instrumente identike ose të ngjashme. Banka aplikon qasjen e tregut për matjen e produkteve të bazuara në pozicionin likuid (blerje dhe shitje të obligacioneve). Kjo është qasja ideale për të matur vlerën e drejtë të gjithë bonove të thesarit dhe obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, megjithatë, vetëm një numër i kufizuar obligacionesh kanë kuota ditore. Për pozicionet e gjata, ofertat e tregut janë të dhëna kryesor në matjen e vlerës së drejtë për:

- Obligacionet standarde të shprehura në lekë dhe
- Euro bonde shqiptare.

Qasja e të ardhurave përcakton vlerën aktuale neto të skontuar të flukseve monetare të ardhshme. Kur përdoret metoda e të ardhurave, matja e vlerës së drejtë pasqyron pritshmëritë aktuale të tregut për shumat e ardhshme.

Grupi i teknikave të vlerësimit që aplikojnë metodën e të ardhurave përfshijnë, ndër të tjera, teknikat e llogaritjes së vlerës aktuale duke përdorur kurbën e ndërtuar të normave të interesit, e cila rrjedh kryesisht nga kuotat mesatare të tregut dhe gjithashtu nga rezultatet më të fundit të ankandeve të bonove të thesarit ose obligacioneve. I gjithë portofoli i obligacioneve me përjashtim të obligacioneve standarde të shprehura në monedhën lekë dhe eurobondi shqiptar vlerësohen duke përdorur metodën e të ardhurave.

Në matjen e vlerës aktuale, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- një vlerësim i flukseve monetare të ardhshme
- pritjet e variancave të mundshme në flukset monetare të ardhshme
- vlerën në kohë të parasë
- primi i rrezikut për përballimin e pasigurisë së trashëgueshme të flukseve monetare.
- faktorë të tjerë që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh sipas rrethanave
- për një detyrim, rrezikun e mospërdorimit, duke përfshirë rrezikun e kredisë së vetë njësisë ekonomike.

Banka përdor sistemin Kondor + për ndërtimin e kurbës së normave të interesit në lekë dhe vlerësimin e të gjithë portofolit të letrave me vlerë të përcaktuar me vlerën e drejtë në përputhje me teknikat e vlerësimit të mësipërme.

Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë duhet të maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të vëzhgueshme dhe të minimizojnë përdorimin e të dhënave të vlerësuara. Bazuar në të dhëna të rëndësishme të përzgjedhura, Banka klasifikon matjen e vlerës së drejtë në një nga tre nivelet e ndryshme të hierarkisë:

- **Niveli 1** përfshin matjet e bazuara në çmimet e kuotuara të vëzhguara për instrumente identike në tregjet aktive ku: Banka ka qasje në tregtim dhe frekuenca dhe vëllimi i transaksioneve janë të mjaftueshme për të ofruar vazhdimisht informacion në cilësinë e duhur për matjen.

  Aktualisht banka nuk ka një portofol tregtimi, edhe pse banka ka qasje në tregtim. Gjithashtu, nga eksperiencat e kaluara, banka e ka pasur të vështirë blerjen nga tregu dytësor për obligacione në lekë ose në euro. Obligacionet standarde në lekë mund të plotësojnë kushtet e mësipërme, megjithatë, shpeshtësia dhe vëllimi i transaksioneve nuk janë aq të kënaqshme.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(xi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Teknika e vlerësimit (vazhdim)

- **Niveli 2** përfshin matje të bazuara në të dhënat që nuk përfshihen në Nivelin 1, por ofrojnë informacion të vëzhgueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për matjen e një instrumenti të caktuar:
  - Çmimet e kuotuara për instrumente të ngjashme në tregjet aktive.
  - Çmimet e kuotuara për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që nuk janë aktive (tregjet që kanë pak transaksione dhe ku çmimet nuk janë të përditësuara ose luhaten në një gamë të gjerë ose në terma të profilit kohor ose midis krijuesve të tregut konsiderohen jo aktiv). Ky është rasti për obligacionet standarde shqiptare të shprehura në LEK dhe për euro bondin shqiptar.
  - Të dhëna të tjera të vëzhgueshme të tregut që mund të ndikojnë në çmimin e instrumentit (kurbën e normave të interesit për afatet kryesore). Kjo do të përdoret vetëm për LEK duke ndërtuar kurbën e normave të interesit në LEK bazuar në rezultatet më të fundit të ankandit dhe kuotimet ditore për obligacionet standarde (obligacionet e tregtuara nga krijuesit e tregut). Kurba e ndërtuar e rendimentit prodhon kuota mesatare.
- **Niveli 3** Matjet e bazuara në të dhënat e Nivelit 3 përdorin të dhëna që nuk mund të vëzhgohen në treg ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, por pasqyrojnë llogaritjet e vetë Bankës për mënyrën se si një pjesëmarrës i pavarur tregu do të përcaktonte vlerën e të dhënë. Banka duhet të bazojë llogaritjet e veta në informacionin më të mirë të disponueshëm sipas rrethanave. Banka aktualisht nuk zotëron asnjë instrument të këtij lloji.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare matet përgjithësisht mbi baza individuale. Megjithatë, në rastet kur Banka administron një grup aktivesh dhe pasivesh financiare në bazë të ekspozimit të saj neto të tregut ose rrezikut të kredisë, vlera e drejtë e grupit të instrumenteve financiare matet mbi bazën neto, megjithatë aktiveve dhe detyrimeve financiare paraqiten veçmas në pasqyrat financiare, përveç rasteve kur ato plotësojnë kriteret e kompensimit të SNRF-ve.

Banka rishikon periodikisht teknikat e saj të vlerësimit duke përfshirë metodologjitë dhe modelin e miratuar të kalibrimit. Banka aplikon teknika të ndryshme për të vlerësuar rrezikun e kredisë që lidhet me instrumentet e saj financiare të matura me vlerën e drejtë, të cilat përfshijnë një qasje të bazuar në portofol që vlerëson ekspozimin neto të pritshëm për palë gjatë gjithë jetës së aktiveve individuale, në mënyrë që të pasqyrojë rrezikun e palëve individuale për instrumente financiare të pakolateralizuara. Banka vlerëson vlerën e kredisë së saj nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut, të tilla si çmimet dytësore për borxhin e saj të tregtuar dhe diferenca e kredisë në këmbimet e mospagimit të kredisë dhe borxhet e tregtuara nga vetja. Detajet për këtë shpjegohen më tej në Shënimin 41 e) *i)*.

(xii) Aktivet financiare të zhvlerësuara

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse se aktivi financiar i mbajtur me metodën e kostos së amortizuar, aktivi financiar me VDATGj, të arkëtueshmet nga qiratë, garancitë financiare dhe angazhimet e huave janë të zhvlerësuara. Një aktiv financiar konsiderohet 'i dëmtuar nga kredia' kur ndodhin një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim negativ në rrjedhat e ardhshme të parashikuara të parasë të aktivin financiar.

Faktet objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuara përfshijnë:

1. mospagimi ose vonesa ne pagesë nga një huamarrës
2. ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Banka, sipas kushteve që Banka nuk do ta konsideronte ndryshe
3. shenja se një huamarrës ose një emetues do të falimentoje,
4. zhdukja e një tregu aktiv për një aktiv financiar,
5. ose të dhëna të tjera të vëzhguara në lidhje me një grup aktivesh të tilla si ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesës së huamarrësve ose emetues në Bankë, ose
6. kushtet ekonomike që lidhen me mos pagesat në Bankë.

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mos pagesës, koha e rikuperimit dhe shuma e humbjes së shkaktuar. Normat e mos pagesës, normat e humbjeve dhe koha e pritshme për rikuperimet në të ardhmen krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Instrumenti Financiar (vazhdim)

(xiii) Rimarrja e zhvlerësimit

Nëse në një periudhë të mëpasshme, rritet vlera e drejtë e një aktivi financiar të zhvlerësuar për shitje dhe kjo rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi rimarret nëpërmjet fitimit ose humbjes. Përndryshe çdo rritje në vlerën e drejtë njihet nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Çdo rikuperim i mëpasshëm i vlerës së drejtë të një aktivi financiar të zhvlerësuar me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse njihet gjithmonë në ATGj.

(j) Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, siç janë të referuara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, përfshijnë kartëmonedhat dhe monedhat, balancat e pakufizuara që mbahen me bankat qendrore dhe aktive financiare shumë likuide me maturitet fillestar më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i rrezikut të ulet të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për trajtimin e rezervës së detyruar i referohemi shënimit 10.

(k) Hua dhe paradhëniet

Paraqitje e huave dhe paradhënieve, në pasqyrën e pozicionit financiar, përfshijnë hua dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar. Ato maten ne fillim me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit direkt në rritje, dhe si rrjedhim me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Qira financiare

Kur Banka është qiradhënës në një kontratë qiraje e cila transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjithë rreziqet dhe përfitimet e rastësishme për pronësinë te qiramarrësi, aktivet e dhëna me qira paraqiten si një qira financiare e arkëtueshme dhe mbahen me vlerën e drejtë të pagesave të qirasë në të ardhmen. Qiratë financiare të arkëtueshme njihen fillimisht (kur fillon afati i qirasë) duke përdorur një normë skontim të përcaktuar në fillim (data më e hershme ndërmjet datës së marrëveshjes së qirasë dhe data e zotimit nga palët në dispozitat kryesore të qirasë).

Diferenca midis të zërave të arkëtueshëm bruto dhe vlerës aktuale paraqet të ardhura financiare të pa fituara. Këto të ardhura njihen përgjatë kohëzgjatjes së qirasë duke përdorur metodën e investimit neto (përpara taksimit), e cila reflekton një kosto konstante kthimi duke zbatuar normën e nënkuptuar në qira në (i) vlerën bruto të qirasë financiare të arkëtueshme në fazën 1 dhe 2 dhe (ii) vlerën neto të qirasë financiare të arkëtueshme në fazën 3 të modelit HPK. Kostot shtesë të lidhura drejtpërdrejt me negocimin dhe menaxhimin e qirasë përfshihen në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe zvogëlojnë shumën e të ardhurave të njohura gjatë afatit të qirasë. Të ardhurat financiare nga qiratë regjistrohen në të ardhura të tjera të ngjashme në fitim ose humbje.

Provizionet për humbjen e kredisë njihen në përputhje me modelin e përgjithshëm HPK, duke përdorur HPK përgjatë jetës. HPK përcaktohet në të njëjtën mënyrë si për kredinë dhe hua e maturuara me koston e amortizuar dhe njihet përmes një llogarie provizioni për të ulur shumën neto të aktiveve të marrë në vlerën aktuale të pritshme të flukseve të parasë, të skontuara me normat e interesit të implikuar në kontratat e financimit me qira. Flukset e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara, pasqyrojnë flukset monetare që mund të rezultojnë nga marrja dhe shitja e aktiveve që i nënshtrohen qirasë.

(m) Investime në letra me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Investimet në letra me vlerë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë instrumentet e borxhit të matura me Vlerën e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (VDATGj). Për instrumentet e borxhit të matura me VDATGj, fitimi ose humbja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, përveç rasteve të mëposhtme të cilat njihen në fitim humbje me të njëjtën mënyrë siç njihen aktivet financiare të matura me metodën e kostos së amortizuar:

- të ardhura nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- HPK dhe kthimet, dhe
- fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor

Kur instrumentet e borxhit të matur me VDATGj janë çregjistruar, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGj ri- klasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(n) Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore

Inventari përfshin aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore fituar përmes zbatimit të sigurisë mbi kredi dhe hua ndaj klientëve që nuk përformojnë, të cilat nuk gjenerojnë të ardhura nga qiraja dhe nuk përdoren nga Banka, dhe janë të destinuara për shitje brenda një periudhe të arsyeshme kohe, pa pasur nevojë për ristrukturim të konsiderueshëm. Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

(o) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që të sigurohen përfitime te ardhshme ekonomike për Bankën, që i atribuohen atij elementi dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitimit humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në momentin kur ndodhin.

(i) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse mbi bazë lineare gjatë jetës së përdorshme të parashikuar për secilën pjesë të një objekti të pasurive të paluajtshme dhe pajisjeve. Përmirësimet e bëra në aktivet e marra me qira zhvlerësohen për kohën më të shkurtër të qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	(në vite)
Ndërtesa	30
Kompjutera dhe pajisje informatike	5
Instalime dhe pajisje të tjera	5
Pajisje zyre	10
Automjete	5
Investime në mjetet e marra me qira	5

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proces.

(p) Aktive afatgjata jo-materiale

Programet kompjuterike dhe licencat përbëjnë aktivet afatgjata jo-materiale dhe njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e fitimit humbjes, duke përdorur metodën lineare të amortizimit për te gjithë jetëgjatësinë e aktivit afatgjate material, duke filluar nga data e përdorimit. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 10 vjet dhe e licencave 7 vjet.

(q) Borxhi i varur

Borxhi i varur i emetuar njihet fillimisht në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Banka njeh detyrimin e borxhit të varur kur fondet i transferohen Bankës. Pas matjes fillestare, borxhi i varur i emetuar matet më pas me koston e amortizuar. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shpenzimet e interesit llogariten me normën nominale të interesit dhe njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Interesi i përllogaritur por i papaguar transferohet në llogarinë e të ardhurave dhe njihet si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesi i përllogaritur". Gjatë vitit 2024, Banka ka emetuar borxh të varur privat të pa listuar (referojuni Shënimit 23).

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Në çdo datë raportimi, Banka shqyrton vlerën e kontabël të aktiveve të saj jo-financiare (përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra) për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues i zhvlerësimit. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i të ardhurave të parashikuara, skontohet në vlerën aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut me vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihen ne fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi rimerren vetëm kur shuma e mbartur a aktivit, nuk tejkalon vlerën kontabël të mbartur, që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do njihej asnjë humbje nga zhvlerësimi.

(s) Depozita dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht nënshkruan një marrëveshje për të riblerë aktivin, (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për riblerje në një datë të caktuar të ardhshme nuk fshihen nga pasqyra e pozicionit financiar pasi Banka ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Mjetet monetare përkatëse të pranuar njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si aktiv me një detyrim korrespondues për ta kthyer atë, duke përfshirë interesin e përllogaritur si detyrim te përfshirë në *cash* kolateralin e letrës me vlerë të huazuara dhe marrëveshjeve të riblerjes duke pasqyruar thelbin ekonomik të transaksionit si një hua për Bankën. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe është përllogaritur gjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur normën e interesit efektiv.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(t) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që të kërkohet dalje fondesh për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme rrezikun specifik të detyrimit.

(u) Kapital aksionar

Aksionet e zakonshme dhe aksionet preferenciale të pashlyeshme me dividendë klasifikohen të dyja si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja trajtohen në kapital si zbritje, neto nga tatimi i të ardhurave. Çdo tepricë e vlerës së drejte së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si primi i aksioneve në kapitalin e vet.

(v) Dividendi

Dividendët regjistrohen në kapitalin neto në periudhën në të cilën ato janë deklaruar. Çdo dividend i deklaruar pas datës së raportimit dhe përpara autorizimit të pasqyrave financiare për publikim do të paraqitet në Shënimin për ngjarjet pas datës së raportimit. Raportimet SNRF të Bankës janë baza për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(w) Garancitë financiare dhe angazhimet e huasë

Në rrjedhën normale të biznesit, Banka lëshon garanci financiare, të përbërë nga letër kredi, garanci dhe pranime. Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (brenda 'detyrimeve të tjera') me vlerën e drejtë, që është primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën çdo garanci është matur me më të lartën midis shumës të njohur ne fillim minus amortizimin e akumuluar të njohur në fitim humbje, dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer çdo detyrim financiar që lind si rezultat i garancisë. Çdo rritje e detyrimit që lidhet me garancitë financiare regjistrohet në pasqyrën e fitim humbjes, në shpenzimet e humbjeve kreditore. Primi i pranuar njihet në pasqyrën e fitim humbjes në të ardhurat neto të komisioneve në mënyrë lineare gjatë jetës së garancisë. Më pas, garancitë financiare maten me vlerën më të madhe të fondit për humbjet nga zhvlerësimet e përcaktuar sipas SNRF 9 dhe shuma e njohur në fillim minus, sipas rastit, shumën e akumuluar të të ardhurave të njohura në përputhe me parimet e SNRF 15. Angazhimet e huasë maten më pas neto nga zbritja për humbje kreditore e njohur në përputhje me SNRF 9(Note 6(i),(vi), B).

(x) Te dhënat krahasuese

Disa ri klasifikime janë bërë në nivelin e shënimeve shpjeguese për të përmirësuar shpalosjen brenda shënimit "Aktive të Tjera" për datat 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023. Në veçanti, shpenzimet e parapaguara që lidhen me përfitimet e punonjësve, të përfshira më parë nën shënimin "Debitor", janë ri-klasifikuar në shënimin "Parapagimet" (shih Shënimin 14). Këto rregullime janë bërë për të përmirësuar qartësinë dhe konsistencën e zbulimeve të pasqyrave financiare. (shih Shënimin 14)

7. Standardet e reja por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë vendosur por ende nuk kanë hyrë në fuqi janë duke u vlerësuar nga Banka për të përcaktuar ndikimin e tyre tek pasqyrat financiare. Sikundër shpjegohet më lart, kjo do të përfshinte standarde dhe ndryshimet që do të kenë hyrë në fuqi tashmë në bazë të standardit ose ndryshimet të ri, por miratimi lokal është ende në proces ose do të hyjë në fuqi në një datë të mëvonshme.

- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare—Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7

Më 30 maj 2024, BSNK vendosi Ndryshimet për SNRF 9 dhe SNRF 7, Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshimet). Ndryshimet përfshijnë:

- Një sqarim se një detyrim financiar çregjistrohet në 'datën e shlyerjes' dhe prezanton një zgjedhje të politikës kontabël (nëse plotësohen kushte të caktuara specifike) për të çregjistruar detyrimet financiare të cilat janë shlyer duke përdorur një sistem pagese elektronike përpara datës së shlyerjes;
- Udhëzime shtesë mbi mënyrën se si duhet të vlerësohen flukset mjeteve monetare kontraktuale për aktivet financiare në kuadrin e Qeverisjes mjedisore, sociale dhe të korporatës (ESG) dhe karakteristikat e ngjashme;
- Sqarime se cilat janë 'karakteristikat pa rekurs' dhe cilat janë karakteristikat e instrumenteve që janë subjekt i kontratave;
- Paraqitja e informacioneve shpjeguese për instrumentet financiare me karakteristika të kushtëzuara dhe kërkesa shtesë për informacione shpjeguese për instrumentet e kapitalit të klasifikuara me vlerën e drejtë me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2026. Zbatimi i hershëm lejohet, me opsionin për të miratuar më herët vetëm ndryshimet për klasifikimin e aktiveve financiare dhe informacionet shpjeguese përkatëse. Aktualisht, Banka është duke vlerësuar ndikimin e ndryshimeve të reja, megjithatë nuk planifikon të miratojë më herët këto ndryshime.

- SNRF 18 Paraqitja dhe prezantimi i shënimeve shpjeguese në Pasqyrat Financiare

Në prill 2024, BSNK vendosi standardin SNRF 18 Paraqitja dhe prezantimi i shënimeve shpjeguese në Pasqyrat Financiare, i cili zëvendëson SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare. SNRF 18 paraqet kërkesat e reja për paraqitjen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, duke përfshirë totalet dhe nën totalet e specifikuara. Gjithashtu, subjekteve ekonomike u kërkohet që të klasifikojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në një nga pesë kategoritë e mëposhtme: operative, investimi, financimi, tatimet mbi të ardhurat dhe operacionet e ndërprera, nga të cilat tre kategoritë e para janë të reja. Ka kërkesa dhe opsione specifike paraqitjeje për subjektet ekonomike, si Banka, ku aktivitetet kryesore të biznesit të tyre janë të specifikuara (si financimi i klientëve ose investimin në një lloj të caktuar aktivesh, ose të dyja).

7. Standardet e reja por ende jo efektive (vazhdim)

- SNRF 18 Paraqitja dhe prezantimi i shënimeve shpjeguese në Pasqyrat Financiare (vazhdim)

Ky standard gjithashtu kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për masat e përcaktuara së fundmi për mbarëvajtjen dhe ecurinë e menaxhimit, të cilat janë nën totali i të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe përfshin kërkesa të reja për agregimin dhe zbërthimin e informacionit financiar në bazë të "roleve" të identifikuara të pasqyrave financiare kryesore dhe shënimeve.

Ndryshimet me fushë veprimit të ngushtë janë bërë në SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare, të cilat përfshijnë ndryshimin e pikës fillestare për përcaktimin e flukseve monetare nga operacionet sipas metodës së tërthortë, nga 'fitim humbje' në 'fitim humbje operative' dhe heqjen e opsionit për klasifikimin e flukseve monetare nga dividendët dhe interesat. Përveç kësaj, ka ndryshime të njëpasnjëshme në disa standarde të tjera.

SNRF 18, dhe ndryshimet në standardet e tjera, hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2027, por zbatimi më i hershëm lejohet dhe duhet të paraqiten. SNRF 18 do të zbatohet në mënyrë retrospektive. Aktualisht, Banka po punon për identifikimin e të gjitha ndikimeve që ndryshimet do të kenë në pasqyrat financiare kryesore dhe shënimet e pasqyrave financiare.

- SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Mungesa Këmbueshmërisë (Ndryshime)

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat raportimi vjetore që fillojnë më 1 janar 2025 ose më pas, me aplikim të hershëm të lejuar. Drejtimi ka vlerësuar se ky standard nuk ka ndikim.

- SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Zbulimet – Kontratat që Referojnë Energjinë Elektrike të Varur nga Natyra (Ndryshime)

Në dhjetor 2024, BSNK lëshoi ndryshime të synuara për të pasqyruar më mirë kontratat që referojnë energjinë elektrike të varur nga natyra, të cilat ndryshuan SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Zbulimet. Këto ndryshime hyjnë në fuqi për periudhat raportimi vjetore që fillojnë më 1 janar 2026 ose më pas, me aplikim të hershëm të lejuar. Drejtimi ka vlerësuar se ky standard nuk ka ndikim.

- SNRF 19 Degët pa përgjegjësi publike: Shënime Shpjeguese

Në maj 2024, BSNK lëshoi SNRF 19 – Degët pa Përgjegjësi Publike: Shënime Shpjeguese, i cili hyn në fuqi për periudhat raportimi vjetore që fillojnë më 1 janar 2027 ose më pas, me aplikim të hershëm të lejuar. Drejtimi ka vlerësuar se banka nuk ka ndikim.

- Ndryshime në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduar dhe SNK 28 Investimet në Shoqëri të Lidhura dhe Ndërmarrje të Përbashkëta: Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë së tij të Lidhur ose Ndërmarrjes së Përbashkët

Në dhjetor 2015, BSNK shtyu afatin e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një periudhë të pacaktuar, në pritje të përfundimit të projektit të tij kërkimor mbi metodën e kontabilizimit sipas kapitalit. Drejtimi ka vlerësuar se banka nuk ka ndikim.

- Përmirësime Vjetore në Standardet e Kontabilitetit Sipas SNRF – Vëllimi 11

Në korrik 2024, BSNK lëshoi Përmirësimet Vjetore në Standardet e Kontabilitetit Sipas SNRF – Vëllimi 11. Një entitet duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat raportimi vjetore që fillojnë më 1 janar 2026 ose më pas. Aplikimi i hershëm është i lejuar.

8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël

Drejtimi diskuton me Bordin e Drejtorëve zhvillimin, përzgjedhjen dhe shpalosjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës, si dhe zbatimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet e kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhave të ardhshme, nëse rishikimi prek si periudhat aktuale ashtu edhe ato të ardhshme. Këto informacione shpjeguese plotësojnë komentin mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 41).

8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

A. Gjykime

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra gjatë zbatimit të politikave kontabël që kanë efekte më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshihen në shënimet e mëposhtme.

- Shënimi 41(b): përcaktimi i kritereve për vendosjen nëse rreziku i kredisë për aktivin financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare, duke përcaktuar metodologjinë për përfshirjen e informacionit të ardhshëm në matjen e HPK, zgjedhjen dhe miratimin e modeleve të përdorura për të matur HPK.

B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

— Shënimet 6 (i)(ii): klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit brenda të cilit mbahen aktivet dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të aktivit financiar janë SPPI mbi shumën kryesore të papaguar.

(a) Zhvlerësimi nga humbjet e aktiveve financiare

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e aktiveve financiare në objekt kërkon gjykim, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit kur përcaktohen humbjet nga rënia në vlerë dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë. Këto vlerësime nxiten nga një sërë faktorësh, ndryshimet në të cilët mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të lejimeve.

Matja e HPK-ve është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe hyrjeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes HPK janë shpalosur më poshtë:

Komponentët e mëposhtëm kanë një ndikim të madh në zbritjet nga humbjet e kredisë:
- segmentimi i aktiveve financiare për qëllimet e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore (HPK);
- përcaktimi i një niveli të vlerësimit të HPK mbi një bazë individuale të instrumentit ose mbi një bazë kolektive;
- përcaktimi i mospagimit të aplikuar nga Banka;
- zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të klasifikimit të brendshëm të kredisë, i cili cakton probabilitetin e dështimit (PM-të) për shkallët individuale të rrezikut të kredisë;
- zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të brendshme të përdorura për të vlerësuar ekspozimin në rast dështimi ("EM") për instrumentet financiare dhe zotimet e lidhura me kredinë;
- vlerësimi i humbjes në rast dështimi ("HM"), duke përfshirë gjykimet për vlerësimin e kolateralit; - kriteret për vlerësimin nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë;
- zgjedhja e skenarëve makroekonomikë të ardhshëm dhe peshat e tyre të probabilitetit.

Banka rregullisht rishikon dhe vërteton modelet dhe të dhënave në modele për të zvogëluar çdo ndryshim midis vlerësimeve të pritshme të humbjes së kredisë dhe përvojës aktuale të humbjes së kredisë.

OTP HQ ofron një sërë parametrash rreziku për grupin për llogaritjet kolektive të provizioneve. Gjatë vitit 2024 u kryen 2 raunde rishikimi të parametrave nga selia e OTP dhe u zbatuan nga Banka si më poshtë:

• TM3 2024: rishikim vjetor i parametrave PM dhe HM që rezultoi në rrimeje provizioni prej 27.16 milionë lekësh kryesisht për shkak të ndikimit të rikuperimit të parave të gatshme.

• TM4 2024: rishikim i pritjeve (skenarëve) të ardhshme me parametra HM dhe pesha skenarësh të pandryshuara, që rezultoi në një rritje të zhvlerësimit prej 72.7 milionë lekësh për shkak të kufizimit të efektit pozitiv që vinte nga një stres më pak i rëndë në grupin aktual të PBB-ve duke rritur kufirin e përqindjes së aplikuar nga 75% në 80% në skenarin e stresit.

(b) Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë ("RRNRRK")

Në mënyrë që të përcaktohet nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë, Banka krahason rrezikun e një mospagimi që ndodh gjatë jetës së një instrumenti financiar në fund të datës së raportimit me rrezikun e mospagimit në datën e njohjes fillestare. Vlerësimi konsideron rritjen relative të rrezikut të kredisë sesa arritjen e një niveli specifik të rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese.

Banka i konsideron të gjitha informacionet e arsyeshme dhe mbështetshme të disponueshme pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, të cilat përfshijnë një sërë faktorësh, përfshirë aspektet e sjelljes të portofoleve të veçantë të klientëve. Banka identifikon treguesit e sjelljes të rritjes së rrezikut të kredisë para delikuencës dhe përfshirjes së informacionit e duhur në vlerësimin e rrezikut të kredisë, ose në një instrument individual, ose në një nivel portofoli.

8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit *(vazhdim)*

(c) Vlerësimi i modelit të biznesit.

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për administrimin e aktiveve dhe kushtet kontraktuale të aktiveve të matura në:

• Kosto e amortizuar

• VDATGj

Banka konsideron strategjinë e saj për 2024-2026 në rritjen e huave për klientët, ndërsa ndërton në të njëjtën kohë një bazë të përshtatshme depozitash nga klientët. Prandaj, investimet në letra me vlerë shihet t'i shërbejë nevojave të likuiditetit dhe një pjesë e këtij portofoli pritet të shitet për të mbuluar nevojën e fondeve në aktivitetin e huave të klientëve. Para se të përdoren për të zgjeruar aktivitetin e huasë, këto letra me vlerë mund të përdoren si kolateral në transaksionet e REPOs me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe i gjithë portofoli i letrave me vlerë është pjesë e mbrojtjes të likuiditetit të nevojshëm në vend dhe për "Raportin e Mbulimit të Likuiditetit Basel III raportet e likuiditetit ". Kjo është në përputhje me strategjinë e Administrimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (ALM) të Grupit sepse sipas konceptit të likuiditetit operativ të nivelit të Grupit, letrat me vlerë që janë të pranueshme për transaksione REPOs me bankën qendrore, duhet të jenë pjesë e portofolit të aktiveve likuide dhe ato mund të përdoren si mbulim i daljeve kontraktuale të parave dhe goditjet potenciale të likuiditetit.

Sipas politikës ALM të Grupit OTP, shitja e aktiveve është pjesë e drejtpërdrejtë e administrimit të likuiditetit, duke përfshirë aktivet nga likuiditeti dytësor ose aktivet jo-likuide. Prandaj, banka dhe Grupi OTP beson se modeli i biznesit të portofolit të letrave me vlerë është në përputhje me parimet e SNRF 9 "Mbaj për të mbledhur dhe shitur" dhe kështu ato maten me "Vlera e drejtë përmes ATGj".

(d) Modifikimi i aktiveve financiare

Kur aktivet financiare modifikohen me kontratë (p.sh. ri-negociohen), Banka vlerëson nëse modifikimi është thelbësor dhe duhet të rezultojë në mosnjohje të aktivit origjinal dhe njohje të një aktivi të ri me vlerën e drejtë. Ky vlerësim bazohet kryesisht në faktorë cilësorë, të përshkruar në politikën përkatëse të kontabilitetit dhe kërkon gjykim të rëndësishëm. Në veçanti, Banka zbaton gjykimin për të vendosur nëse huatë e ri-negociuara të dëmtuara nga kredia duhet të çregjistrohen dhe nëse hua të reja të njohura duhet të konsiderohen si të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Vlerësimi i mosnjohjes varet nëse rreziqet dhe përfitimet, domethënë, ndryshueshmëria e flukseve të parave të pritura (në vend se kontraktuale), ndryshojnë si rezultat i modifikimeve të tilla. Drejtimi i Bankës përcaktoi që rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshuan si rezultat i modifikimit të kredive të tilla dhe për këtë arsye në të gjitha modifikimet e tilla, kreditë nuk u çregjistruan dhe as nuk u klasifikuan jashtë fazës së zhvlerësimit të kredisë.

(e) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (d.m.th., një çmim dalje) pavarësisht nëse ky çmim është drejtpërdrejt i vëzhgueshëm ose i vlerësueshëm duke përdorur një teknikë tjetër të vlerësimit. Kur vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të derivojnë nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një larmi teknikash vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Të dhënat në këto modele merren nga tregjet e vëzhguara kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundshme, kërkohen matje dhe vlerësime në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsideratat e likuiditetit dhe të të dhënave të modelit që lidhen me zëra të tillë si rreziku i kredisë (si i vetes ashtu dhe i palës tjetër), normat e përditësuara të interesit nga tregu, korrelacioni dhe paqëndrueshmëria. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 6(i) (xi) dhe 41 (e) i).

8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)

(f) Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me opsione rinovimi dhe përfundimi (Banka si qiramarrëse)

Banka e përcakton afatin e qirasë si periudhën e pa anullueshme të kontratës së qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga opsioni për të zgjatur qiranë nëse është e sigurt në mënyrë të arsyeshme se do të ushtrohet, ose çdo periudhë të mbuluar nga opsioni për të përfunduar qiranë, nëse ekziston siguri e arsyeshme që ky opsion nuk do të ushtrohet. Banka ka disa kontrata qiraje që përfshijnë opsione zgjatjeje dhe përfundimi. Banka përdor gjykim profesional për të vlerësuar nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurt të ushtrojë apo jo opsionin për të rinovuar ose përfunduar qiranë. Në këtë vlerësim, merren në konsideratë të gjithë faktorët përkatës që krijojnë një nxitje ekonomike për të ushtruar ose rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që është nën kontrollin e saj dhe që ndikon në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo opsionin për rinovim ose ndërprerje te qirasë (p.sh., ndërtimi i përmirësimeve të rëndësishme të pronës me qira ose përshtatje të konsiderueshme të aktivit të dhënë me qira).

(g) Vlerësimi i normës në rritje të huamarrjes

Banka nuk mund të përcaktojë lehtësisht normën e interesit të nënkuptuar në qira, prandaj, ajo përdor normën e saj rritëse të huamarrjes (NRH) për të matur detyrimet e qirasë. NRH është norma e interesit që Banka duhet të paguajë për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një garanci të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin e të drejtës së përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik. Prandaj, NRH pasqyron atë që Banka 'do të duhet të paguajë', e cila kërkon vlerësim kur nuk ka tarifa të vëzhgueshme (si p.sh. për filialet që nuk hyjnë në transaksione financimi) ose kur ato duhet të rregullohen për të pasqyruar termat dhe kushtet e qirasë (për shembull, kur qiratë nuk janë në monedhën funksionale të filialit). Norma e skontimit e aplikuar për llogaritjen e vlerës aktuale - përveç rasteve kur kontrata ka dispozita të tjera - është norma rritëse e huamarrjes e përcaktuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Aktivev dhe Detyrimeve të Bankës në baza mujore për çdo shtet, për monedhë, në periudhat kohore 1, 3, 5, 7 , 10 vjeçare , bazuar në kurbat e normës se interesit të kuponit zero të letrave me vlerë të qeverisë u rritën nga diferenca që reflekton rrezikun e Grupit.

(h) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të paguhen taksa dhe interesa shtesë. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri që mund të bëhet i disponueshëm mund ta çojë Bankën të ndryshojë vlerësimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur bëhet një përcaktim i tillë. (Shënim 36).

(i) Aktivet/Detyrimet tatimore të shtyra

Aktivet/detyrimet tatimore të shtyra njihen në lidhje me diferencat e përkohshme, në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit mund të përdoren humbjet. Përdorimi i gjykimit është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e aktiveve/detyrimeve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar në kohën e mundshme dhe nivelin e fitimeve të tatueshme në të ardhmen, së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor (Shënim 25).

(j) Provizionet dhe të tjera detyrimet të kushtëzuara.

Drejtimi i Bankës ka krijuar një proces të brendshëm në lidhje me njohjen dhe matjen e provizioneve dhe kushtëzimeve për shkak të çështjeve gjyqësore aktuale ose kërcënuese. Supozimet kryesore rreth mundësisë së daljes së burimeve bazohen në këshillat ligjore të brendshme dhe të jashtme, te cilat ndjekin strategjitë përkatëse të mbrojtjes te suksesshme kundrejt veprimeve të shfaqura. Çdo veprim dhe rrezik përkatës vlerësohet në bazë të meritës se tyre, detyrimit themelor konstruktiv ose ligjor, si dhe vlerësimit të daljeve monetare qe të konsideruara të pagueshme. Drejtimi beson se proceset gjyqësore ekzistuese ose të mundshme në të ardhmen janë të largëta, megjithatë për shkaqe përtej sfondit ligjor dhe kornizës mund të shkaktohen rreziqe të mëtejshme (Shënimi 6 (t), Shënimi 24, Shënimi 37)

9. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2024 and 31 dhjetor 2023 janë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Arka		
Në Lek	*1,688,125*	*1,540,058*
Në monedhë të huaj	*2,228,360*	*1,544,569*
Llogari rrjedhëse me Bankën Qendrore	1,081,334	11,019,897
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	378,146	2,296,645
Depozita me bankat dhe institucionet financiare	608,977	4,164,816
Humbje të pritshme	(1,670)	(18,787)
Total	**5,983,272**	**20,547,198**

Humbjet e pritshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, janë detajuar si më poshtë:

Humbje të pritshme	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Në fushën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, Banka zbaton metodologjitë e mëposhtme në përputhje me kërkesat rregullatore dhe të kompanisë mëmë, e cila mundëson matjen e pozicionit aktual dhe të ardhshëm të likuiditetit. Banka menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut pjesërisht nga administrimi dhe analiza e pozicioneve të likuiditetit, pjesërisht duke përcaktuar kufijtë e brendshëm për ekspozimet ndaj rrezikut.

Banka duhet së pari të jetë në përputhje me rregulloren vendore të parashikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Rregulloret e likuiditetit të nxjerra nga Banka e Shqipërisë janë:

- Rregullorja nr. 71 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", datë 14.10.2009.
- Rregullorja nr. 27, "Për raportin e mbulimit të likuiditetit", hyrë në fuqi më 1.3.2020.
- Vendimi nr. 70, datë 2.12.2020 "Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave"; ka hyrë në fuqi në janar 2023.

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 71 Banka është e detyruar të respektojë raportet e likuiditetit (aktive likuide/detyrime afatshkurtra) si më poshtë

- **Raporti i likuiditetit total:**
  (të gjithë artikujt në monedhë)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 20%
- **Raporti i likuiditetit në monedhën vendase:**
  (zëra në lekë)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 15%
- **Raportet e likuiditetit të monedhave të tjera:**
  (zëra të tjerë në valutë të huaj)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 20%

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2024. Raporti i likuiditetit total është dhjetor 2024 është 31.1 % (dhjetor 2023: 35.2 %)

Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (RML) brenda 1 muaji raportohet çdo muaj sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për RML.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për RML totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë është përcaktuar në nivelin 120%. Në rast të shkeljes së këtij kufiri, menaxhimi aktiv bëhet i nevojshëm për të shmangur shkeljen e kufirit rregullator. Ndërkohë për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme kufiri rregullator vendor nuk është më i ulët se 85%, , dhe një objektiv i brendshëm më i rreptë është përcaktuar në nivelin prej 85%.

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2024**.** *Raporti total i mbulimit të likuiditetit (RML) në dhjetor 2024 është 188.5% (dhjetor 2023: 303.2%) shumë mbi kufirin rregullator jo më të ulët se 100%. Raporti përkatës RML në valutë të huaj menaxhohet me grupin e likuiditetit te OTP.*

Sipas rregullores RML të Bankës së Shqipërisë është përcaktuar një kufi i valutave totale prej të paktën 100% si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 80% ,në fuqi që prej datës 1 mars 2020. Sipas rregullores se Bankës së Shqipërisë për raportin e detyrueshëm të raportit të qëndrueshëm të financimit neto (NSFR) raportohet në baza tremujore.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për Raporti Neto i Financimit të Qëndrueshëm (NSFR) totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë përcaktohet në nivelin 105%.

Banka ka qënë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2024. *Raporti Total Neto i Financimit të qëndrueshëm (NSFR) në dhjetor 2024 është 150.9% (dhjetor 2023: 164 %)shumë mbi kufirin rregullator minimal prej100%.*

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për raportin neto të financimit të qëndrueshëm (NSFR), një kufi i valutave totale është përcaktuar të paktën 100% dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 70%-100% është në fuqi nga 1 janar 2023. Zbatimi i monedhës së rëndësishme RNFS është gradualisht si më poshtë:

MONEDHA TOTALE E RËNDËSISHME NSFR

- 1 janar 2023 70%
- 1 janar 2024 80%
- 1 janar 2025 100%

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,983,272	-	-	-	-	-	**5,983,272**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	13,948,090	-	-	-	-	-	**13,948,090**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	21,557	290,540	515,124	152,529	657,899	-	**1,637,649**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	-	705,771	1,159,244	2,633,285	17,377,205	7,039,644	**28,915,149**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	4,933,413	397,049	960,149	890,467	7,658,398	737,934	**15,577,410**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	788,824	4,200,273	4,441,738	10,842,393	23,669,091	63,203,511	**107,145,830**
Qiratë financiare të arkëtueshme	3,077	1,407	4,807	130,465	1,608,780	14,667	**1,763,203**
Aktive te tjera	1,022,054	-	-	382,960	-	-	**1,405,014**
Totali i aktiveve	**26,700,287**	**5,595,040**	**7,081,062**	**15,032,099**	**50,971,373**	**70,995,756**	**176,375,617**
Detyrime							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,380,940	336,784	1,291,153	725,640	111,301		**3,845,818**
Detyrime ndaj klientëve	85,034,343	5,961,606	8,889,342	24,751,986	20,788,720	1,907,499	**147,333,496**
Qira financiare	3,343	675	1,541	4,449	301,116	607,986	**919,110**
Detyrime të tjera	69,998	1,072,750	-	1,344,298	-	-	**2,487,046**
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	1,066,195	**1,066,195**
Total i detyrimeve	**86,488,624**	**7,371,815**	**10,182,036**	**26,826,373**	**21,201,137**	**3,581,680**	**155,651,665**
Ekspozimi	**(59,788,337)**	**(1,776,775)**	**(3,100,974)**	**(11,794,274)**	**29,770,236**	**67,414,076**	**20,723,952**
Efekti kumulativ	**(59,788,337)**	**(61,565,112)**	**(64,666,086)**	**(76,460,360)**	**(46,690,124)**	**20,723,952**	**-**

Drejtimi beson se pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e llogarive të klientëve janë depozita pa afat, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve, dhe përvoja e kaluar e bankës do të tregonte se këto llogari klientësh ofrojnë një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm financimi për Bankën.

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	-	-	-	-	**20,547,198**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	14,213,819	-	-	-	-	-	**14,213,819**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	33,032	218,878	590,052	52,068	-	-	**894,030**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	849,264	1,029,434	1,229,981	3,685,333	14,252,269	6,666,996	**27,713,277**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar			1,752,091	1,852,578	6,879,555		**10,484,224**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	3,767,097	2,792,821	4,816,265	9,875,103	23,800,742	48,361,584	**93,413,612**
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,308	3,033	6,379	43,591	1,438,273	47,511	**1,540,095**
Aktive te tjera	1,121,065	-	-	564,638	-	-	**1,685,703**
Totali i aktiveve	**40,532,783**	**4,044,166**	**8,394,768**	**16,073,311**	**46,370,839**	**55,076,091**	**170,491,958**
Detyrime							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	378,902	519	-	1,688,275	99,019		**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	82,421,715	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,143	2,769,555	**148,343,661**
Qira financiare	26,005	188	332	35,137	347,437	793,202	**1,202,301**
Detyrime të tjera	366,764	1,744,497	-	708,585	-	-	**2,819,846**
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	775,526	**775,526**
Total i detyrimeve	**83,193,386**	**6,780,070**	**8,033,342**	**33,453,369**	**19,509,599**	**4,338,283**	**155,308,049**
Ekspozimi	**(42,660,603)**	**(2,735,904)**	**361,426**	**(17,380,058)**	**26,861,240**	**50,737,808**	**15,183,909**
Efekti kumulativ	**(42,660,603)**	**(45,396,507)**	**(45,035,081)**	**(62,415,139)**	**(35,553,899)**	**15,183,909**	**-**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si norma e interesit, normat e këmbimit valutor dhe diferencat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të debitorit / emetuesit) do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiarë të saj. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e rrezikut. Strategjia e Bankës për menaxhimin e rrezikut për librin e saj bankar është e ndryshme për secilën nga kategoritë e mëposhtme të rrezikut të tregut dhe është përcaktuar në nën seksionet vijuese të këtyre pasqyrave financiare, si më poshtë:

Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin e saj ndaj rrezikut të tregut midis portofolit tregtar dhe atij jo tregtar. Portofoli i tregtimit përfshin ato pozicione që rrjedhin nga transaksionet e krijimit të tregut ku Banka vepron si principal me klientët ose me tregun, së bashku me aktivet dhe detyrimet financiare që menaxhohen mbi bazën e vlerës së drejtë. Pozicioni i këmbimit valutor trajtohet si pjesë e portofolit tregtar të Bankës për qëllime të administrimit të rrezikut. Portofolet jo tregtare lindin kryesisht nga administrimi i normave të interesit të aktiveve dhe detyrimeve bankare me pakicë dhe tregtare të njësisë ekonomike. Portofolet jo tregtare gjithashtu përbëhen nga rreziqet që rrjedhin nga investimet e Bankës të mbajtura deri në maturim dhe ato të disponueshme për shitje.

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (KAD). KAD është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të detajuara të menaxhimit të rrezikut dhe ndjekjen e rregullt të zbatimit të tyre. Kufijtë e rrezikut të tregut miratohen përfundimisht nga Bordi.

Në nivel operacional, rreziku i tregut menaxhohet kryesisht nga departamenti i thesarit të Bankës, i cili është përgjegjës për të siguruar që ekspozimet e Bankës janë në përputhje me kufijtë e rrezikut të tregut të miratuar nga Bordi dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura kur është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofole të tregtueshme

Banka është e ekspozuar ndaj efektit të luhatjeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja në pozicionin e saj financiar dhe fluksit të parasë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Duke qenë se monedha në të cilën Banka paraqet pasqyrat e saj financiare është Leku Shqiptar, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizja në kurset e këmbimit midis Lekut dhe monedhave të tjera. Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor.

Në përputhje me politikën e Bankës, pozicionet llogariten nga Departamenti i Financës dhe monitorohen çdo ditë nga Departamenti i Riskut dhe përdoren strategji mbrojtëse për të siguruar që pozicionet të mbahen brenda kufijve të përcaktuar. Kufijtë për pozicionet neto që Banka mund të mbajë në secilën monedhë kryesore, si dhe kufiri individual për çdo monedhë tjetër janë përcaktuar si më poshtë:

Në mijë Lek	EUR	USD	CAD	CHF	GBP	XAU
2024	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250
2023	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës më poshtë llogarit efektin e një lëvizjeje të mundshme të arsyeshme të kursit të monedhës kundrejt lekut (të gjithë variablat e tjerë janë konstantë) në pasqyrën e të ardhurave (për shkak të vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve monetare të ndjeshme ndaj monedhës) dhe kapitalit (nr. kapitali special ose instrumentet mbrojtëse që ndikojnë në ndjeshmërinë e kapitalit, kështu që efekti është i njëjtë me ndjeshmërinë e fitimit dhe humbjes). Një shumë negative në tabelë pasqyron një reduktim të mundshëm neto në pasqyrën e të ardhurave ose kapitalit, ndërsa një shumë pozitive pasqyron një rritje të mundshme neto. Një ulje ekuivalente e secilës prej valutave më poshtë kundrejt lekut do të rezultonte në një ndikim të barabartë, por të kundërt.

		31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Rritje/(Zvoglim) në pikët bazë	**Ndjeshmëria e fitimit para tatimit**	**Ndjeshmëria e kapitalit**	**Ndjeshmëria e fitimit para tatimit**	**Ndjeshmëria e kapitalit**
LEK	+/(-) 100	(171,915)	171,915	(113,806)	113,806
USD	+/(-) 100	47,540	(47,540)	39,660	(39,660)
EURO	+/(-) 100	(164,673)	164,673	405,159	(405,159)

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

	Lek	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktivet					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,768,385	1,946,832	658,106	609,949	**5,983,272**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	4,187,119	9,212,384	548,587	-	**13,948,090**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,430,720	206,929	-	-	**1,637,649**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	14,819,153	13,923,413	172,583	-	**28,915,149**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	11,136,503	1,620,135	2,820,772	-	**15,577,410**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	60,647,942	46,326,397	171,491	-	**107,145,830**
Qiratë financiare të arkëtueshme	174,457	1,588,746	-	-	**1,763,203**
Aktive të tjera	815,298	576,059	13,657	-	**1,405,014**
Aktive afatgjata materiale	4,824,671	-	-	-	**4,824,671**
Aktive afatgjata jo materiale	975,953	-	-	-	**975,953**
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,011,862	-	-	-	**1,011,862**
Aktive tatimore të shtyra, neto	-	-	-	-	**-**
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	44,106	-	-	-	**44,106**
Total i aktivit	**102,836,169**	**75,400,895**	**4,385,196**	**609,949**	**183,232,209**
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,184,649	2,442,875	218,294	-	**3,845,818**
Detyrime ndaj klientëve	70,517,539	71,028,896	4,033,186	1,753,875	**147,333,496**
Detyrime të tjera	2,168,959	307,808	9,625	654	**2,487,046**
Detyrime të qirasë	110,084	674,001	135,025	-	**919,110**
Borxhi i varur	-	1,066,195	-	-	**1,066,195**
Provizione të tjera	173,105	97,670	14,605	-	**285,380**
Detyrime tatimore të shtyra, neto	77,262	-	-		**77,262**
Totali i detyrimeve	**74,231,598**	**75,617,445**	**4,410,735**	**1,754,529**	**156,014,307**
Totali i kapitalit	**27,217,902**	**-**	**-**	**-**	**27,217,902**
Pozicioni Neto	**28,604,571**	**(216,550)**	**(25,539)**	**(1,144,580)**	**27,217,902**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	Lek	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktivet					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,669,484	12,100,079	2,945,930	1,831,705	**20,547,198**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	3,976,843	9,646,408	590,568	-	**14,213,819**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	860,998	33,032	-	-	**894,030**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	19,542,024	7,755,095	416,158	-	**27,713,277**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	9,700,796	783,428	-	-	**10,484,224**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	49,578,732	43,555,392	279,488	-	**93,413,612**
Qiratë financiare të arkëtueshme	186,287	1,353,695	113	-	**1,540,095**
Aktive të tjera	1,394,780	277,322	12,339	1,262	**1,685,703**
Aktive afatgjata materiale	4,964,802	2,432	-	-	**4,967,234**
Aktive afatgjata jo materiale	392,315	-	-	-	**392,315**
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,323,193	-	-	-	**1,323,193**
Aktive tatimore të shtyra, neto	49,772	-	-	-	**49,772**
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	113,488	-	-	-	**113,488**
Total i aktivit	**95,753,514**	**75,506,883**	**4,244,596**	**1,832,967**	**177,337,960**
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	455,312	1,531,676	177,743	1,984.00	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	69,333,272	72,998,077	4,187,201	1,825,111	**148,343,661**
Detyrime të tjera	2,424,752	387,383	-	7,711	**2,819,846**
Detyrime të qirasë	393,275	674,001	135,025	-	**1,202,301**
Borxhi i varur	-	775,526	-	-	**775,526**
Provizione të tjera	274,532	28,760	-	-	**303,292**
Totali i detyrimeve	**72,881,143**	**76,395,423**	**4,499,969**	**1,834,806**	**155,611,341**
Totali i kapitalit	**21,726,619**	**-**	**-**	**-**	**21,726,619**
Pozicioni Neto	**22,872,371**	**(888,540)**	**(255,373)**	**(1,839)**	**21,726,619**

41. Administrimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – portofoli jo i tregtueshme

Rreziku primar ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo të tregtueshme është rreziku i humbjeve nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë për shkak të ndryshimit në normat e interesit të tregut.

KAD përkufizon dhe rishikon politikën e përcaktimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare.

Tabela në vijim tregon ndjeshmërinë ndaj një ndryshimi të arsyeshëm të mundshëm të normave të interesit (të gjitha variablat e tjerë janë konstantë) të pasqyrës së të ardhurave të Bankës. Ndjeshmëria e pasqyrës së të ardhurave është efekti i ndryshimeve të supozuara në normat e interesit në fitim ose humbje për një vit, në bazë të normës së luhatshme të aktiveve financiare dhe të detyrimeve financiare të mbajtura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023. Ndjeshmëria totale e kapitalit supozohet të jetë e njëjtë me ndjeshmërinë në fitim dhe humbje dhe bazohet në supozimin se ka zhvendosje paralele në kurbën e normave të interesit.

Administrimi i rrezikut të normës së interesit ndaj hendekut të limiteve të normave të interesit është plotësuar përmes monitorimit të luhatshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas skenarëve standardë dhe të ndryshëm të normës së interesit. Skenarët standardë që janë konsideruar çdo muaj përfshijnë ndryshimin me 100 pikë bazë në rënie ose ngritje paralele në të gjithë kurbat e normave të interesit.

Një analizë e luhatshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose zvogëlimit të normës së interesit me 100 pikë (duke supozuar asnjë lëvizje asimetrike në kurbat e normave dhe pozicionit financiar konstant) paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2024	**Skenar deri në një vit**		**Skenar mbi 1 vit**	
	100 pikë rritje	**100 pikë zvogëlim**	**100 pikë rritje**	**100 pikë zvogëlim**
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	88,625	(83,625)	(51,012)	51,012

31 dhjetor 2023	**Skenar deri në një vit**		**Skenar mbi 1 vit**	
	100 pikë rritje	**100 pikë zvogëlim**	**100 pikë rritje**	**100 pikë zvogëlim**
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	173,784	(173,784)	(459,433)	459,433

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rendimentet mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 ishin si më poshtë:

	Norma mesatare e ponderuar e interesit (Lek)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (EUR)	
31 dhjetor	**2024**	**2023**	**204**	**2023**	**2024**	**2023**
Aktivet						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	-	-	-	-	-	-
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	2.75%	3.25%	-	-	0.00%	0.00%
Depozita me bankat		3.27%		5.25%	2.80%	4.15%
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	4.39%	4.17%	-	-	7.78%	7.66%
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	4.99%	5.42%	6.12%	6.12%	3.32%	2.47%
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar	4.96%	4.66%	4.3%	-	2.55%	0.91%
Hua dhe paradhënie klientëve (përfshirë të arkëtueshmet e qirasë financiare)	5.79%	5.95%	6.71	7.98%	6.15%	6.66%
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1.59%	1.58%	2.56%	0.00%	1.29%	3.05%
Detyrime ndaj klientëve	0.82%	0.87%	0.21%	0.29%	0.35%	0.21%
Borxhi i varur	-	-	-	-	4.50%	4.5%

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)

Tabela e mëposhtme ofron një analizë të analizës së ri çmimit të normës së interesit të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2024. Aktivet dhe detyrimet e Bankës përfshihen me vlerën kontabël dhe kategorizohen sipas datës së ri çmimit kontraktual ose datës së maturimit.

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Vlera kontabël
Aktivet							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	608,977	-	-	-	-	5,374,295	**5,983,272**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore	13,948,090	-	-	-	-	-	**13,948,090**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	265,101	574,964	776,027	-	21,557	**1,637,649**
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	7,814,610	7,533,882	7,867,503	5,426,409	272,745	-	**28,915,149**
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	7,570,255	6,546,572	1,362,503	98,080	-	-	**15,577,410**
Hua për klientët, vlera neto	4,874,746	13,113,330	20,929,475	44,684,652	23,543,627	-	**107,145,830**
Qiratë financiare të arkëtueshme	57,780	245,305	577,535	812,432	70,151	-	**1,763,203**
Totali i aktiveve	**34,874,458**	**27,704,190**	**31,311,980**	**51,797,600**	**23,886,523**	**5,395,852**	**174,970,603**
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,380,940	336,784	1,291,153	725,640	111,301	-	3,845,818
Detyrime ndaj klientëve	16,298,005	5,961,606	8,889,342	24,751,986	22,696,219	68,736,338	147,333,496
Borxhi i varur	-	-	-	-	1,066,195	-	1,066,195
Totali i detyrimeve	**17,678,945**	**6,298,390**	**10,180,495**	**25,477,626**	**23,873,715**	**68,736,338**	**152,245,509**
Ekspozimi	**17,195,513**	**21,405,800**	**21,131,485**	**26,319,974**	**12,808**	**(63,340,486)**	**22,725,094**
Efekti kumulativ	**17,195,513**	**38,601,313**	**59,732,798**	**86,052,772**	**86,065,580**	**22,725,094**	**-**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)

Analiza e ri çmimit të normës së interesit të Bankës më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Vlera kontabël
Aktivet							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4,153,751	-	-	-	-	16,393,447	**20,547,198**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	14,213,819	-	-	-	-	-	**14,213,819**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	222,251	585,867	52,879	-	33,033	**894,030**
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	10,307,718	7,029,948	6,896,809	3,478,802	-	-	**27,713,277**
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	1,185,229	4,556,673	4,638,544	103,778	-	-	**10,484,224**
Hua për klientët, vlera neto	7,737,737	12,180,488	18,815,715	37,464,536	17,215,136	-	**93,413,612**
Qiratë financiare të arkëtueshme	80,217	269,981	332,757	812,972	44,168	-	**1,540,095**
Totali i aktiveve	**37,678,471**	**24,259,341**	**31,269,692**	**41,912,967**	**17,259,304**	**16,426,480**	**168,806,255**
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	378,902	519	-	1,688,275	99,019	-	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	17,415,139	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,144	67,776,130	**148,343,661**
Borxhi i varur	-	-	-	-	775,526	-	**775,526**
Totali i detyrimeve	**17,794,041**	**5,035,385**	**8,033,010**	**32,709,647**	**19,937,689**	**67,776,130**	**151,285,902**
Ekspozimi	**19,884,430**	**19,223,956**	**23,236,682**	**9,203,320**	**(2,678,385)**	**(51,349,650)**	**17,520,353**
Efekti kumulativ	**19,884,430**	**39,108,386**	**62,345,068**	**71,548,388**	**68,870,003**	**17,520,353**	**-**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiar

Kjo tabelë përfshin aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat vlera e drejtë përafrohet me vlerën kontabël. Banka ka përcaktuar se për aktivet dhe detyrimet financiare që (a) kanë një maturim afatshkurtër (më pak se tre muaj), (b) janë likuide dhe (c) janë instrumente me normë të ndryshueshme, vlerat e tyre kontabël (neto prej zhvlerësimit aty ku është e zbatueshme) janë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tyre të drejtë. Instrumente të tilla përfshijnë: paratë e gatshme dhe gjendjet me bankën qendrore; Hua ndaj dhe detyrime nga bankave dhe institucioneve financiare.

	31 dhjetor 2024				
Aktivet dhe Detyrimet Financiare					**Vlera e drejtë**
	Vlera kontabël	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Aktive Financiare					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,983,272	-	5,983,272	-	**5,983,272**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	13,948,090	-	13,948,090	-	**13,948,090**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,637,649	-	-	1,637,649	**1,637,649**
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	15,577,410	4,436,764	11,523,635	-	**15,960,399**
Aktive e tjera	1,405,014	-	-	1,405,014	**1,405,014**
Hua dhe paradhënie për klientët	107,145,830	-	-	115,735,237	**115,735,237**
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,763,203	-	-	2,222,522	**2,222,522**
Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**147,460,468**	**4,436,764**	**31,454,997**	**121,000,422**	**156,892,183**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	3,845,818	-	3,845,818	-	**3,845,818**
Detyrime ndaj klientëve	147,333,496	-	-	147,069,566	**147,069,566**
Detyrime të tjera	2,487,046	-	-	2,487,046	**2,487,046**
Borxh i varur	1,066,195			1,066,195	**1,066,195**
Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**154,732,555**	**-**	**3,845,818**	**150,622,807**	**154,468,625**
Zërat jashtë bilancit					
Garancitë financiare	10,577,331	**-**	**-**	10,577,331	**10,577,331**
Letër kredi për klientët	495,895	**-**	**-**	495,895	**495,895**
Angazhime të tjera	6,304,730	**-**	**-**	6,304,730	**6,304,730**
Totali i zërave jashtë bilancit	**17,377,956**	**-**	**-**	**17,377,956**	**17,377,956**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë (vazhdim)

					31 dhjetor 2023
Aktivet dhe Detyrimet Financiare					Vlera e drejtë
	Vlera kontabël	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Aktive Financiare					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	20,547,198	-	**20,547,198**
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	14,213,819	-	14,213,819	-	**14,213,819**
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	894,030	-	-	894,030	**894,030**
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	10,484,224	763,615	9,805,026	-	**10,568,641**
Aktive e tjera	1,685,703	-	-	1,685,703	**1,685,703**
Hua dhe paradhënie për klientët	93,413,612	-	-	98,450,331	**98,450,331**
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,540,095	-	-	1,664,865	**1,664,865**
Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**142,778,681**	**763,615**	**44,566,043**	**102,694,929**	**148,024,587**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2,166,715	-	2,166,715	-	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	148,343,661	-	-	145,604,558	**145,604,558**
Detyrime të tjera	2,819,846	-	-	2,819,846	**2,819,846**
	775,526	-	-	775,526	**775,526**
Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**154,105,748**	**-**	**2,166,715**	**149,199,930**	**151,366,645**
Zërat jashtë bilancit					
Garancitë financiare	**11,117,415**	**-**	**-**	11,117,415	**11,117,415**
Letër kredi për klientët	**550,232**	**-**	**-**	550,232	**550,232**
Angazhime të tjera	**9,502,614**	**-**	**-**	9,502,614	**9,502,614**
Totali i zërave jashtë bilancit	**21,170,261**	**-**	**-**	**21,170,261**	**21,170,261**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Metodologjitë e vlerësimit të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Më poshtë janë metodologjitë dhe supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta te instrumenteve financiare të mësipërme të cilat nuk regjistrohen dhe maten me vlerën e drejtë në pasqyrat financiare të Bankës. Këto vlera të drejta ishin llogaritur vetëm për qëllime të zbulimit. Metodologjitë dhe supozimet e mëposhtme lidhen vetëm me instrumentet në tabelat e mësipërme dhe, si të tilla, mund të ndryshojnë nga teknikat dhe supozimet e shpjeguara në Shënimin 6 (xi).

Hua dhe paradhënie për klientët

Huatë dhe paradhëniet janë paraqitur neto nga provizionet për zhvlerësim. Portofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë të drejtë afërsisht të barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së luhatshme të normave të interesit, me kreditë që ri çmohen brenda ciklit një vjeçar, me përjashtim të një grupi kredish të dhëna në vitin 2008 të cilat janë dhënë pa një dysheme minimale e aplikueshme.

Qiratë financiare të arkëtueshme

Kontratat e qirasë financiare kanë një vlerë të drejtë që është e përafërt me vlerën e tyre kontabël. Afati mesatar i këtyre kontratave është më tepër afatmesëm ose afër maturimit dhe me normë interesi të ndryshueshme, e cila ri çmohet brenda ciklit një vjeçar.

Detyrime ndaj klientëve

Vlera e drejtë e detyrimeve ndaj klientëve është vlerësuar duke përdorur teknikën e skontimit të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturime dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur përafrohet me vlerën nominale të borxhit. Borxhi i varur përdoret si e dhënë e nivelit 3 në hierarkinë e vlerës së drejtë.

Pozicionet jashtë bilancit

Vlera e drejtë e vlerësuar e pozicioneve jashtë bilancit bazohet në çmimet e tregut për instrumente të ngjashme ose në modele të skontuara të flukseve monetare, siç shpjegohet më sipër, të cilat përfshijnë elementin e rrezikut të kredisë nëpërmjet faktorit të skontimit.

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të instrumenteve financiare të regjistruara me vlerën e drejtë sipas nivelit të vlerës së drejtë hierarkie:

Aktive financiare				**31 dhjetor 2024**
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	11,991,173	16,923,976	-	**28,915,149**
Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë	**11,991,173**	**16,923,976**	**-**	**28,915,149**

Aktive financiare				**31 dhjetor 2023**
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	8,171,253	19,542,023	-	**27,713,277**
Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë	**8,171,253**	**19,542,023**	**-**	**27,713,277**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Për qëllime të matjes, SNRF 9 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja", klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: a) instrumentet e borxhit me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGj dhe (b) aktivet financiare me kosto të amortizuar (KA).

Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, të gjitha instrumentet financiare maten me koston e amortizuar, me përjashtim të investimeve në letra me vlerë të cilat maten me vlerën e drejtë.

	31 dhjetor 2024			31 dhjetor 2023		
	Vlera kontabël	**Kosto Amortizuar**	**VDATGj**	**Vlera kontabël**	**Kosto Amortizuar**	**VDATGj**
Aktivet						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,983,272	5,983,272	-	20,547,198	20,547,198	-
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	13,948,090	13,948,090	-	14,213,819	14,213,819	-
Hua ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,637,649	1,637,649	-	894,030	894,030	-
Aktive e tjera	1,405,014	1,405,014	-	1,685,703	1,685,703	-
Instrumentet e borxhit në VDATGj	28,915,149	-	28,915,149	27,713,277	-	27,713,277
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	15,577,410	15,577,410	-	10,484,224	10,484,224	-
Hua dhe paradhënie për klientët	107,145,830	107,145,830	-	93,413,612	93, 413,612	-
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,763,203	1,763,203	-	1,540,095	1,540,095	-
Total i aktiveve	**176,375,617**	**147,460,468**	**28,915,149**	**170,491,958**	**142,778,681**	**27,713,277**
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	3,845,818	3,845,818	-	2,166,715	2,166,715	-
Detyrime ndaj klientëve	147,333,496	147,333,496	-	148,343,661	148,343,661	-
Detyrime të tjera	2,487,046	2,487,046	-	2,819,846	2,819,846	-
Borxh i varur	1,066,195	1,066,195		775,526	775,526	
Totali i detyrimeve	**154,732,555**	**154,732,555**	**-**	**154,105,748**	**154,105,748**	**-**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte ose indirekte që vjen nga një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, si dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziqet e kreditit, të tregut dhe të likuiditetit, si ato që rrjedhin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standardet përgjithësisht të pranuara të sjelljes së korporatës. Rreziqet operacionale lindin nga të gjitha operacionet e Bankës dhe përballen nga të gjitha entitetet.
Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me efektivitetin e përgjithshëm të kostos dhe të shmangë procedurat e kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.
Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar drejtimit të lartë brenda çdo njësie biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve;
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe të tjera ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale me të cilat përballen, dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe masat e propozuara korrigjuese;
- zhvillimi i planeve të emergjencës;
- trajnim dhe zhvillim profesional;
- standardet etike dhe të biznesit; dhe
- zbutja e rrezikut, duke përfshirë sigurimin kur kjo është efektive

Pajtueshmëria me standardet e Bankës mbështetet nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga struktura specifike të rrezikut operacional si dhe nga Auditimi i Brendshëm.

(y) Rreziku i pajtueshmërisë

Rreziku i pajtueshmërisë përfshin rrezikun e pajtueshmërisë rregullatore dhe ligjore. Ai nënkupton rreziku që Banka përballet me humbje financiar ose dëmtim reputacional përmes vendosjes së gjobave ose penaliteteve si rezultat i mosrespektimit të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve në fuqi dhe praktikave të mira të tregut (përfshirë standardet etike). Funksioni i pajtueshmërisë së Bankës kërkon në mënyrë proaktive të përmirësojë menaxhimin e rrezikut të përputhshmërisë dhe kuadrin mbështetës të kontrollit. Banka operon në një treg ku ka një nivel të konsiderueshëm të aktivitetit të ndryshimeve rregullatore, prandaj, rreziku i pajtueshmërisë është një fushë kyçe e fokusit për menaxhmentin e lartë dhe ekzekutiv. Funksioni i pajtueshmërisë monitoron këtë rrezik duke iu referuar metrikës përkatëse për Bankën, rishikimit të raporteve dhe vlerësimeve të incidentit, vlerësimeve të rrezikut dhe kontrollit që kanë të bëjnë me linjat e para dhe të dyta të funksioneve të mbrojtjes, rezultatet e vlerësimeve rregullatore, ndjekja e risive që vijnë nga procesi i mbikëqyrjes ligjore dhe rishikimi i rezultateve të auditimit të brendshëm dhe raporteve të auditimit të jashtëm. Përmirësimi i kontrolleve kryhet në kohën e duhur.

(h) Administrimi i kapitalit

Objektivat kryesore të politikës së menaxhimit të kapitalit të Bankës janë të sigurojë që Banka të jetë në përputhje me kërkesat e imponuara nga jashtë për kapital dhe ruan vlerësime të forta krediti dhe raporte të shëndetshme kapitali për të mbështetur biznesin e saj dhe për të maksimizuar vlerën e aksioneve. Banka menaxhon strukturën e saj të kapitalit dhe bën rregullime në përputhje me ndryshimet në kushtet ekonomike dhe karakteristikat e rrezikut të aktiviteteve të saj. Për të ruajtur ose rregulluar strukturën e kapitalit, Banka mund të rregullojë shumën e pagesës së dividendit për aksionarët, t'u kthejë kapitalin aksionarëve ose të emetojë letra me vlerë të kapitalit.

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(h) Administrimi i kapitalit (vazhdim)

Kapitali Rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, ndër masat e tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori, Banka e Shqipërisë ("BSH"), e cila në fund përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për të mbështetur biznesin e saj. Rregullorja "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", dhe ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë".

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitali

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ("RMK") është raporti i kapitalit rregullator ndaj totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%.

Ekspozimet e Ponderuara sipas rrezikut (EPR)

Aktivet e ponderuara me rrezik llogariten si një shumë e sa vijon:

• Ekspozimet e ponderuara me rrezik të aktiveve brenda dhe jashtë bilancit të cilat ponderohen sipas qasjes së standardizuar të rregullores së BSH-së për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit". Sipas kësaj metode të gjitha ekspozimet aktuale dhe të mundshme grupohen në kategori të caktuara ekspozimi dhe brenda secilës prej tyre në grupe më të vogla sipas rrezikut që lidhet me to.

• Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e tregut
• Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun operacional, duke përdorur metodën e treguesit bazë

Shtesat makro prudenciale të kapitalit në vitin 2024 ishte në nivelin 2.5% (2023: 2%). Shtresa të për bankat me rëndësi sistemike është 0.5%. Sipas rregullores së Bankës, raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%. Banka është në përputhje me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kapitali i nivelit te parë	24,449,985	21,639,357
Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë	1,063,946	774,945
Kapitali rregullator	**25,513,931**	**22,414,374**
Aktivet e ponderuara me rrezik	**121,016,263**	**114,642,330**
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	21.08%	19.57%
Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit të kërkuar	12.00%	12.00%

Më 31 dhjetor 2024, borxhi i varur i emetuar në vitin 2024 në vlerën 3.38 mil euro është përfshirë në llogaritjen e kapitalit rregullator Nivelit të Dytë.

Banka i bëri një kërkesë zyrtare bankës qendrore për përfshirjen e borxhit të varur në kapitalin e nivelit II më 10 dhjetor 2024, që është para përfundimit të periudhës raportuese. Banka konsideroi se ekzistonin prova të përmbushjes së kushteve të miratimit rregullator ekzistonin në fund të periudhës raportuese dhe ajo kishte bazë të fortë për të besuar se miratimi ishte praktikisht i sigurt. Miratimi u mor në 22 janar 2025, i cili, edhe pse pas periudhës raportuese, dha konfirmim të mëtejshëm se kushtet për përfshirjen ishin përmbushur që nga data e raportimit.

Gjysma e dytë e fitimit të vitit aktual përfshihet si element i kapitalit të Nivelit të Parë pasi pasqyrat financiare të rishikuara janë certifikuar dhe raportuar tek rregullatori dhe pasi janë zbritur çdo dividend i ndërmjetëm (i pjesshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin. Pas përfshirjes së fitimit të vitit aktual, Drejtimi vlerëson raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 23.55% më 31 dhjetor 2024 (2023: 20.64%).

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Rreziqet e lidhura me klimën

Banka dhe klientët e saj mund të përballen me rreziqe të konsiderueshme të lidhura me klimën në të ardhmen. Këto rreziqe përfshijnë kërcënimin për humbje financiare dhe pasoja jo-financiare negative që lidhen me reagimet politike, ekonomike dhe mjedisore ndaj ndryshimeve klimatike.

Këto rreziqe po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje nga autoritetet rregullatorë, politika dhe shoqëria, si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ndërsa disa rreziqe fizike mund të jenë të parashikueshme, ekziston pasiguri e konsiderueshme në lidhje me shkallën dhe kohën e shfaqjes së tyre.

Sa i përket rreziqeve të tranzicionit, mbeten ende pasiguri lidhur me ndikimet e ndryshimeve të pritshme rregullatorë dhe të politikave, ndryshimeve në kërkesën e konsumatorëve dhe zinxhirët e furnizimit. OTP Bank Albania ushtron një shkallë kontrolli mbi këto rreziqe. Gjatë proceseve të dhënies dhe monitorimit të kredisë, kategoria e rrezikut të klientit përcaktohet bazuar në sektorin e tyre të operimit (*Kodi NACE*) dhe pas kësaj Banka ka krijuar një strategji të qartë që synon uljen e financimit në sektorë specifikë (rrezik i lartë ESG), siç përcaktohet në planin e saj të de-karbonizimit.

Ndërsa Shqipëria nuk ka legjislacion në fuqi për rrezikun që lidhet me klimën, Banka, me mbështetjen e OTP Nyrt, është e angazhuar në një projekt të vazhdueshëm për të adresuar dhe zvogëluar të gjitha rreziqet e shoqëruara.

Banka ka zhvilluar strategjinë Mjedisore, Sociale dhe Qeverisje (MSQ) në vitin 2022, pas së cilës roli i Komitetit Drejtues u mor përsipër nga Drejtori Kryesor i Riskut të Bankës, si personi përgjegjës së bashku me një person të deleguar nga Divizioni i Riskut për ESG. Detyrat që lidhen me riskun ESG në OBA drejtohen nga Selia Qendrore e OTP dhe kryhen rregullisht si pjesë e detyrave të biznesit nga përfaqësuesit e Bankës.

Korniza e menaxhimit të riskut ESG e vitit 2022 u rishikua dhe u miratua në janar 2024, duke synuar një kornizë unike brenda OTP Albania për përcaktimin dhe administrimin e aktiviteteve që lidhen me rreziqet MSQ, në proceset e dhënies dhe monitorimit të kredisë për klientët jo-pakicë dhe transaksionet e qirasë financiare (*leasing*), për të siguruar që aktivitete të tilla bazohen në të njëjtat parime.

Pavarësisht progresit të arritur, Banka njeh nevojën për përpjekje të mëtejshme në mënyrë që të integrojë plotësisht rrezikun klimatik në vlerësimet dhe protokollet e saj të menaxhimit të rrezikut.

otpbank

RAPORTI VJETOR 2024

info@otpbank.al
www.otpbank.al